

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT**

RIKUALIFIKIMI URBAN I UNAZES SE RE BERAT

SPECIFIKIMET TEKNIKE

FAZA : PROJEKT ZBATIMI

GUSHT 2020



Lista e stafit te angazhuar

Emri
Seed Consulting



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Dritan Hoxha'.

PERMBAJTJA:

1 TE PERGJITHSHME	7
1.1 Zevendesimet	7
1.2 Dokumentat dhe vizatimet	8
1.3 Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme.....	8
1.4 Hyrja ne sheshin e ndertimit	8
1.5 Punime prishje, spostime (elektrike, telefonie, ujesjellesi).....	8
1.6 Furnizimi me uje	8
1.7 Furnizimi me energji elektrike.....	9
1.8 Piketimi i punimeve	9
1.9 Fotografite e sheshit te ndertimit	9
1.10 Bashkepunimi ne zone	9
1.11 Mbrojtja e punes dhe e publikut.....	10
1.12 Mbrojtja e ambjentit.....	10
1.13 Transporti dhe magazinimi i materialeve	10
1.14 Sheshi per magazinim	10
1.15 Vizatimet sipas faktit (siç jane zbatuar)	11
1.16 Pastrimi perfundimtar i zones	11
1.17 Provat dhe testet laboratorike	11
1.17.1 Tipi dhe Zbatimi i Provave	11
1.17.2 Standartet per Kryerjen e Provave.....	12
1.17.3 Testet paraprake	12
1.17.4 Teste Kontrolli Gjate Ndertimit	12
1.17.5 Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave	15
1.17.6 Kostot e Provave dhe Marrjeve te Kampioneve	16
1.17.7 Pajisjet per Kryerjen e Provave	16
1.17.8 Rezultatet e Proves.....	16
1.17.9 Nderprerja e Punimeve.....	16
1.17.10 Provat e Kryera nga Sipermarresi.....	16
2 GERMIMET	17
2.1 Qellimi.....	17
2.2 Percaktimet	17
2.2.1 Dherat.....	17
2.2.2 Materialet Kryesore	17
2.2.3 Materiale te pershtatshme	17
2.2.4 Cilesia e Materialeve.....	17
2.2.5 Tipet e Germimeve.....	20
2.2.6 Metoda te per gjithshme te zatimit te punimeve te germimit.....	21
2.3 Germimi ne rruge	21
2.4 Trajtimi/Ngjeshja e Zonave te Germuara.....	21
2.5 Pastrimi i sheshit	22
2.6 Germimi per Strukturat	22
2.7 Germimi i kanaleve per tubacionet	22
2.8 Ujerat e shiut – gjate punimeve te germimit.....	23
2.9 Perdorimi i materialeve te germimit	23
2.10 Rimbushja e Themelive	23
2.11 Perforcimi i ndertesave	23
2.12 Perforcimi dhe veshja e germimeve	24
2.13 Mirembajtja e germimeve.....	24
2.14 Largimi i ujerave nga punimet e germimit	24
2.15 Perforcimi dhe mbulimi ne vend.....	24
2.16 Mbrojtja e sherbimeve ekzistuese	25
2.17 Heqja e materialeve te teperta nga germimi	25
2.18 Pershkrimi i çmimit njesi per germimet	25

2.19	<i>Matjet.....</i>	26
3	PUNIME MBUSHJE.....	27
3.1	<i>Te per gjithshme.....</i>	27
3.2	<i>Ndertimi i mbushjeve.....</i>	28
3.3	<i>Mbushja dhe mbulimi.....</i>	28
3.3.1	<i>Pergatitja e shtratit.....</i>	28
3.4	<i>Materiali.....</i>	29
3.5	<i>Shtrimi dhe Nivelimi.....</i>	30
3.6	<i>Mirembajtja e drenazheve.....</i>	31
3.7	<i>Ngjeshja</i>	31
3.8	<i>Cilesia e Punimeve.....</i>	32
3.8.1	<i>Shkalla e Ngjeshjes</i>	32
3.8.2	<i>Aftesia Mbajtese.....</i>	32
3.8.3	<i>Kontrolli i Cilesise</i>	34
3.9	<i>Matja dhe Pranimi i Punimeve.....</i>	36
3.9.1	<i>Matja e punimeve.....</i>	36
3.10	<i>Çmimi njesi per mbushje, mbulim me zhavorr dhe ngjeshje</i>	36
4	BETONET.....	36
4.1	<i>Te per gjithshme.....</i>	36
4.2	<i>Kontrolli i cilesise</i>	37
4.3	<i>Puna per gatitore dhe inspektimi.....</i>	37
4.4	<i>Materialet</i>	38
4.4.1	<i>Çimento</i>	38
4.4.2	<i>Inertet.....</i>	38
4.5	<i>Kerkesat per perzjerjen e betonit</i>	41
4.5.1	<i>Fortesia.....</i>	41
4.5.2	<i>Klasat e rezistences ne shtypje</i>	41
4.5.3	<i>Raporti uje-çimento</i>	42
4.5.4	<i>Qendrueshmeria</i>	42
4.6	<i>Matja e materialeve</i>	43
4.7	<i>Metodat e perzjerjes.....</i>	43
4.8	<i>Provat e fortisise gjate punes.....</i>	43
4.9	<i>Transportimi i betonit.....</i>	44
4.10	<i>Hedhja dhe ngjeshja e betonit</i>	44
4.11	<i>Betonim ne kohe te nxhete</i>	45
4.12	<i>Kujdesi per betonin</i>	45
4.13	<i>Forcimi i betonit</i>	46
4.14	<i>Celiku i armimit.....</i>	46
4.15	<i>Ndertimi dhe cilesia e armatures</i>	47
4.16	<i>Heqja e armatures</i>	48
4.17	<i>Betoni i parapergatitur</i>	49
4.18	<i>Mbulimi i çmimit njesi per betonet.....</i>	49
5	NDERTIMI I PILOTAVE.....	51
5.1	<i>Te per gjithshme.....</i>	51
5.2	<i>Piketimi i Pilotave</i>	51
5.3	<i>Tolerancat</i>	51
5.4	<i>Personeli per gjegjes</i>	52
5.5	<i>Makinerte dhe pajisjet per ndertimin e pilotave</i>	52
5.6	<i>Sekuensa e instalimit te pilotave</i>	53
5.7	<i>Qellimi i punimeve</i>	54
5.8	<i>Materialet</i>	54
5.9	<i>Te dhenat e tabanit</i>	54
5.10	<i>Vizita ne kantier.....</i>	55
5.11	<i>Rjetet inxhinierike egsistuese nentokesore dhe ruajtja e pronave fqinje</i>	55
5.12	<i>Shpimet.....</i>	55

5.13	<i>Perzierja dhe vendosja e mbushjes.....</i>	57
5.14	<i>Renjet (humbjet) e materialit mbushes</i>	57
5.15	<i>Standartet.....</i>	57
5.16	<i>Testimet Standarde te ngarkesave.....</i>	57
5.17	<i>Raporti i testimeve.....</i>	58
5.18	<i>Pilotat e demtuara ose te zhvendosura nga aksi.....</i>	58
5.19	<i>Korrigjimi i sforuar i pa lejuar</i>	59
5.20	<i>Pagesa e shpimit te pilotes</i>	59
5.21	<i>Pagesa per ton e armimit te pilotes</i>	59
5.22	<i>Registri i te dhenave per pilotat</i>	59
5.23	<i>Projekti sipas faktik.....</i>	60
6	CELIKU PER ARMIM.....	60
6.1	<i>Pershkrimi</i>	60
6.2	<i>Listat e porosise.....</i>	61
6.3	<i>Identifikimi</i>	61
6.4	<i>Perkulja</i>	61
6.5	<i>Mbrojtja e materialit</i>	61
6.6	<i>Çeliku perfocues i veshur me epoks</i>	61
6.7	<i>Vendosja dhe fiksimi.....</i>	62
6.8	<i>Lidhjet</i>	62
6.9	<i>Pranimi.....</i>	63
6.10	<i>Pagesa</i>	63
7	MURET ME DHE TE ARMUAR (TERRAMESH).....	64
7.1	<i>Pershkrimi</i>	64
7.2	<i>Materialet</i>	64
7.3	<i>Kriteret e Ndertimit</i>	65
7.4	<i>Fillimi I Ndertimit te murit</i>	65
7.5	<i>Mbushja</i>	66
7.6	<i>Pranimi.....</i>	66
7.7	<i>Matja</i>	66
7.8	<i>Pagesa.....</i>	67
8	RRJETAT GJEOSINTETIKE (GJEGRIDET) DHE GJEOTEKSTIL	67
8.1	<i>Pershkrimi</i>	67
8.2	<i>Kriteret e Ndertimit</i>	67
8.3	<i>Aplikimi i Gjeotekstilit dhe Gjeogridit per Ndarje dhe Stabilizim</i>	68
8.4	<i>Aplikimi i Gjeotekstilit ne Filtrime</i>	69
8.5	<i>Aplikimi i Ggeomembranes</i>	69
8.6	<i>Pranimi.....</i>	69
8.7	<i>Matja</i>	70
8.8	<i>Pagesa.....</i>	70
9	MURE ME BLLOQE BETONI DHE MURET ME GURE.....	70
9.1	<i>Te per gjithshme:.....</i>	70
9.2	<i>Vendosja e blloqeve prej betoni</i>	71
9.3	<i>Muret me Gure</i>	71
10	DRENAZHET.....	72
10.1	<i>Qellimi</i>	72
10.2	<i>Tombinot Drejt kendore</i>	72
10.3	<i>Tombinot Rrethore.....</i>	72
10.4	<i>Ndertimi.....</i>	73
11	PUNIMET E KANALIZIMEVE TE UJERAVE TE BARDHA.....	75
11.1	<i>Te Pergjithshme</i>	75
11.2	<i>Materiali</i>	75
11.3	<i>Shtrimi ne kanal i tubacioneve</i>	75
11.4	<i>Mjetet shtruuese te tubacionit dhe perdonimi i sakte i tyre</i>	77
11.5	<i>Instruksionet e montimit</i>	77

11.6	Testi Hidraulik.....	77
11.7	.Mbjtja, ruajtja dhe tranposrtimi i tubave ne kantier	77
11.8	Germimi dhe mbushja e kanaleve	78
11.9	Ndertimi i pusetave.....	78
11.10	Zgarat ujembledhese	79
11.11	Derdhjet e ujerave	79
11.12	Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet	79
11.13	Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat	79
12	PUNIMET PER RRJETIN E FURNIZIMIT ME UJE	80
12.1	Te per gjithshme.....	80
12.2	Shtrimi ne kanal.....	80
12.3	Mjete preres	81
12.4	Instruksionet e montimit.....	81
12.5	Mbjtja dhe transportimi i tubave ne zone	82
12.6	Germimi dhe mbushja.....	83
12.7	Ndertimi i pusetave.....	83
12.8	Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per ujesjellesin	83
12.9	Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat	84
12.10	Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat	84
12.10.1	Prodhimi.....	84
12.10.2	Kontrolli I Cilesise Se Prodhimit	85
12.10.3	Normalisht, Keto Procedura Kontrolli Perfshijne:.....	85
12.10.4	Saldimet E Tubave Te Politetilenit.....	85
12.10.5	Llojet E Bashkimeve.....	86
12.10.6	Trajinim Per Bashkimin Me Fuzion	86
12.10.7	Pajisjet Dhe Makinerite E Fuzionit	86
12.10.8	Bashkimi Me Fuzion	87
12.10.9	Fuzioni Me Shkrirje.....	87
12.10.10	Elektrofuzioni	87
13	PUNIMET E SHTRESAVE	89
13.1	Nenshtresa me materiale granulare	89
13.1.1	Qellimi.....	89
13.1.2	Çakelli mbeturina	89
13.1.3	Ndertimi.....	90
13.1.4	Tolerancat ne Ndertim	90
13.1.5	Kryerja E Provave	91
13.2	Shtresa baze me gure te thyer (çakell makinerie)	91
13.2.1	Qellimi dhe definicioni.....	92
13.2.2	Materialet.....	92
13.2.3	Ndertimi.....	93
13.2.4	Tolerancat ne Ndertim	94
13.2.5	Kryerja e Provave Materiale	94
13.3	Shtresa Mbi Baze Me Stabilizant (Gure Te Thyer Me Makineri Dhe I Fraksionuar).....	95
13.3.1	Materialet.....	95
13.3.2	Sperkatja Me Uje.....	97
13.3.3	Toleranca Ne Ndertim	97
13.3.4	Kryerja e provave te materialeve.....	98
13.3.5	Inspektimi rutine dhe kryerja e provave te materialeve	99
13.4	Shtresa asfaltobetoni.....	99
13.4.1	Qellimi.....	99
13.4.2	Termat	99
13.4.3	Materialet	99
13.4.4	Klasifikimi i asfaltobetonit	101
13.4.5	Percaktimi i perberjes te asfaltobetonit.....	102
13.4.6	Kerkesat teknike qe duhet te plotesoje asfaltobetonii sipas STASH 660-87.....	103

13.4.7	Kerkesat teknike ndaj materialeve perberes te asfaltobetonit.....	104
13.4.8	Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit.....	105
13.4.9	Shtrimi dhe ngjeshja e asfaltobetonit	107
13.4.10	Kontrolli mbi cilesine e asfaltobetonit te shtruar	109
13.5	Shtresa e reres	110
14	KANALIZIMI I UJERAVE TE BARDHA	112
14.1	Te per gjithshme	112
14.2	Shtrimi ne kanal.....	112
14.3	Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdonimi i sakte i tyre	113
14.4	Instruksionet e montimit	113
14.5	Testi Paraprak.....	114
14.6	Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone	114
14.7	Germimi dhe mbushja ne shkemb	115
14.8	Ndertimi i pusetave.....	115
14.9	Derdhjet e ujerave te bardha	116
14.10	Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet	116
14.11	Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat	116
15	VESHJET MBROJTESE (RIP RAP)	117
15.1	Te Pergjithshme	117
15.2	Pershkrimi.....	117
15.3	Materialet Baze	117
15.3.1	Germimet per Veshjet Mbrojtese	117
15.3.2	Veshjet Mbrojtese te Palidhura	117
15.3.3	Veshjet Mbrojtese te Vendosura me Dore	118
15.3.4	Cilesia e Materialit	118
15.4	Metoda e Zbatimit	118
15.4.1	Te Pergjithshme	118
15.4.2	Sigurimi i Materialit.....	118
15.4.3	Depozitimi i Materialeve	118
15.4.4	Pergatitja e Bazes.....	119
15.4.5	Ndertimi.....	119
15.5	Projektimi i Filtrit	119
15.6	Filtrat Kokrrizore	120
15.7	Cilesia e Zbatimit	120
15.8	Kontrolli i Cilesise se Zbatimit.....	120
15.8.1	Testet e Kontrollit.....	121
15.9	Matja dhe Marja ne Dorezim e Punimeve.....	121
15.9.1	Matja e Punimeve	121
15.9.2	Marja ne Dorezim e Punimeve	121
16	PUNIMET ELEKTRIKE	122
16.1	Qellimi	122
16.2	Standartet dhe Normat Europiane:.....	122
16.3	Miratimet	122
16.4	Produktet.....	123
16.5	Zbatimi	124
16.6	Testet:.....	125
16.7	Shperndarja e brendshme dhe instalimi i fuqise	126
16.7.1	Te per gjithshme	126
16.7.2	Produktet	126
16.8	Ndricimi i Jashtem.....	127
16.8.1	Te per gjithshme	127
16.8.2	Produktet	128
16.8.3	Zbatimi.....	129
16.9	Produktet e Ndricimit.....	130
16.9.1	Zbatimi.....	131

17	SINJALISTIKA RRUGORE DHE ELEMENTET E SIGURISE SE TRAFIKUT.....	132
17.1	<i>Sinjalizimi vertikal</i>	133
17.1.1	<i>Te per gjithshme</i>	133
17.1.2	<i>Rregullimi</i>	133
17.1.3	<i>Vendosja</i>	133
17.1.4	<i>Guardrails (barrierat metalike)</i>	134
17.1.5	<i>Dukshmeria e sinjaleve</i>	135
17.1.6	<i>Publiciteti</i>	136
17.1.7	<i>Permasat e tabelave sinjalizuese</i>	136
17.1.8	<i>Shikuesheria e qarte e tabelave</i>	137
17.2	<i>Sinjalet e rrezikut</i>	137
17.2.1	<i>Te per gjithshme</i>	137
17.2.2	<i>Vendosja</i>	137
17.2.3	<i>Kombinime</i>	137
17.3	<i>Sinjalet pershkruese</i>	137
17.3.1	<i>Te per gjithshme</i>	137
17.3.2	<i>Vendosja</i>	138
17.4	<i>Sinjalet e ndalimit</i>	138
17.4.1	<i>Te per gjithshme</i>	138
17.5	<i>Sinjalet e detyrimit</i>	139
17.5.1	<i>Te per gjithshme</i>	139
17.6	<i>Sinjalet treguese</i>	139
17.6.1	<i>Te per gjithshme</i>	139
17.6.2	<i>Vendosja</i>	139
17.6.3	<i>Simbolet</i>	140
17.7	<i>Sinjalizimi horizontal</i>	140
17.7.1	<i>Te per gjithshme</i>	140
17.7.2	<i>Bojerat e vijezeit reflektare</i>	141
17.7.3	<i>Karakteristikat fiziko-kimike</i>	141
17.7.4	<i>Boje reflektuese Termoplastike me Sprucim</i>	143
17.7.5	<i>Ndarja e sinjaleve horizontale</i>	143
17.7.6	<i>Materialet</i>	144
17.7.7	<i>Kalimet per kembesoret ose per bicikletat</i>	144
18	SPECIFIKIME TEKNIKE PER PUNIME GJELBERIMI.....	145
18.1	<i>PRERJE SISTEMIM PEMESH</i>	145
18.2	<i>F.V FIDANE DEKORATIV</i>	145

1 TE PERGJITHSHME

1.1 Zevendesimet

Zevendesimi i materialete te specifikuara ne Dokumentin e Kontrates do te behet vetem me aprovinim e Mbikeqyresit te Punimeve nese materiali i propozuar per tu zevendesuar eshte i njejtë ose me i mire se materialet e specifikuara; ose nese materialet e specifikuara nuk mund te sillen ne sheshin e ndertimit ne kohe per te perfunduar punimet e Kontrates per shkak te kushteve jashte kontrollit te Sipermarresit. Qe kjo te merret ne konsiderate, kerkesa per zevendesim do te shoqerohet me nje dokument deshmi te cilesise, ne formen e kuotimit te certifikuar dhe te dates se garancise te dorezimit nga furnizuesit e te dy materialete, si te materialit te specifikuar ashtu edhe te atij qe propozohet te ndryshohet.

1.2 Dokumentat dhe vizatimet

Sipermarresi do te verifikoje te gjitha dimensionet, sasite dhe detajet te treguara ne Vizatimet, Grafiket, ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje perqjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtesoje Sipermarresin nga perqjegjesia per pune te pakenaqeshme. Sipermarresi do te marre persiper te gjithe perqjegjesine ne blerjen e llogaritjeve te madhesive, llojeve dhe sasive te materialeve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plete do te jepet nga Punedhenesi nese gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

1.3 Kostot e Sipermarresit per mobilizim dhe punime te perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Sipermarresit nuk do t'i behet asnje pagese mbi çmimet njesi te kuotuara per kostot e mobilizimit, d.m.th. per sigurimin e transportit, dritten, energjine, veglat dhe pajisjet, ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit, rrugeve te hyrjes, te komoditeteve sanitare, heqjen e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materiale, ose per kujdesin mjekesor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjeter, lethesi, gjera, ose materiale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

1.4 Hyrja ne sheshin e ndertimit

Sipermarresi duhet te organizoje punen per ndertimin, mirembajtjen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose çdo rruge hyrje qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve. Çvendosja do te perfshije pershtatjen e zones me çdo rruge hyrje dhe se paku me shkalle sigurie, qendrushmerie dhe te kullimit te ujrate siperfaqesore te njejte me ate qe ekzistonte perpara se sipermarresi te hynte ne shesh.

1.5 Punime prishje, spostime (elektrike, telefonie, ujesjellesi)

Perpara se te fillojne te gjitha punimet e prishjeve te merren masat e nevojshme per çdo bashkepunim me institucionet perkatese. Asnje nderhyrje ne rrjetet, (telefonie, elektrike, ujesjellesi, kanalizimet, vadirje) ekzistuese nuk do kryhet pa marre lejet ne institucionet perkatese dhe çdo punim do kryhet nen mbikqyrjen e autoritetve perqjegjese.

1.6 Furnizimi me uje

Uji, qe nevojitet per zbatimin e punimeve, do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne pikeni me te afert te mundeshme. Sipermarresi do te shtrije rrjetin e vet te perkohshem te tubacioneve. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te paguhen nga Sipermarresi. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Sipermarresi duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

1.7 Furnizimi me energji elektrike

Sipermarresi do te beje perpjekjet, dhe me shpenzimet e tij per furnizimin me energji elektrike ne kantjer, si me kontraktim me OSSHE-ne , kur lidhjet me rrjetin kryesor lokal jane te mundura, ose duke parashikuar gjeneratorin e vet per te permbushur kerkesat.

1.8 Piketimi i punimeve

Sipermarresi, me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave siç kerkohet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit, dhe do te jete perjegjesi i vetem per perpikmerine.I gjithe procesi duhet te jete nen mbikqyrjen e plote te supervizorit.

Sipermarresi do te jete perjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene, dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga perjegjesia e tij nese nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt. Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi, dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates, per asnje lloj kompensimi per korrigimet e gabimeve ose te mangesive. Sipermarresi do te furnizoje dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistanca nepermjet nje stafi te kualifikuar siç mund te kerkohet nga Punedhenesi per kontrollin e modinave dhe piketave.

Sipermarresi do te ruaje te gjitha pikat e akseve, modinat, shenjat e kuotave, te bera ose te vendosura gjate punes, te mbuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes se bere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura, modinave dhe piketave.

Perpara çdo aktiviteti ndertimor, Sipermarresi do te kete linjat e furnizimit me uje dhe energji elektrike te vendosura ne terren, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar, gati per fillimin e punimeve. Çdo pune e bere jashte akseve, kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Sipermarresi do te mbuloje me shpenzimet e tij germimet shtese gjithmone nen drejtimin e Mbikqyresit te Punimeve.

1.9 Fotografite e sheshit te ndertimit

Sipermarresi duhet te beje fotografi me ngjyra sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve ne vendet e punes per te demostruar kushtet e sheshit perpara fillimit, progresin gjate punes se ndertimit dhe mbas perfundimit te punimeve. Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohen nen koston administartive te Sipermarresit.

1.10 Bashkepunimi ne zone

Ndertimi do te behet ne zona te kufizuara. Sipermarresi duhet te kete veçanerisht kujdes ne:

- nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qe jane ne zone, gjate periudhes se ndertimit.

b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna

E gjithe puna, do te behet ne nje menyre te tille, qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithe pajisjeve te mundeshme per ndonje Kontraktor tjeter dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te çdo punonjesi qe mund te punesohet ne zbatim dhe, ose punimet ne zone ose prane saj, per çdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose çdo gje tjeter.

Ne preqatjen e programit te tij te punes, Sipermarresi gjate gjithe kohes do te beje llogari te plote dhe do te kooperoje me programin e punes se Kontraktoreve te tjere, ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe me publikun.

1.11 Mbrojtja e punes dhe e publikut

Sipermarresi do te marre masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesar dhe te jetes publike, si edhe te pasurive ne dhe rreth sheshit te ndertimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, kodeve te ndertesave dhe te ndertimit do te respektohen. Makinerite, pajisjet dhe çdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje me masat paraprake te sigurimit.

Gjate zbatimit te punimeve Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate nates pengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Sipermarresi duhet te siguroje pengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimet mund te shkaktojne çregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

1.12 Mbrojtja e ambjentit

Sipermarresi, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithe veprimet e mundeshme per te siguruar qe ambjenti lokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja per shkak te punimeve te kryera. Mosplotesimi i kesaj klauzole, ne baze te evidentimit nga Mbikeqyresi i Punimeve, mund te çoje ne nderprerjen e kontrates.

1.13 Transporti dhe magazinimi i materialeve

Transporti i çdo materiali nga Sipermarresi, do te behet me makina te pershtateshme, te cilat kur ngarkohen nuk shkaktojne derdhje dhe e gjithe ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson kete kerkesa ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do te hiqet nga kantjeri.

Te gjitha materialet qe sillen nga Sipermarresi, duhet te stivohen ose te magazinohen ne menyre te pershtateshme per t'i mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe ne dispozicion, per tu kontrolluar nga Mbikqyresi i Punimeve ne çdo kohe.

1.14 Sheshi per magazinim

Sipermarresi duhet te beje me shpenzimet e tij, marrjen me qira ose blerjen e nje terreni te mjaftueshem per ngritjen e magazinave me shpenzimet e tij.

1.15 Vizatimet sipas faktit (siç jane zbatuar)

Sipermarresi duhet te perqatise vizatimet per te gjitha punimet “siç jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates.

Gjate zbatimit te punimeve ne kantier, Sipermarresi do te ruaje te gjithe informacionin e nevojsphem per perqatitjen e “Vizatimeve siç eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne çdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit. Keto vizatime do te azhornohen ne menyre te vazhdueshme dhe do t'i dorezohen Mbikeqyresit te Punimeve çdo muaj per aprovim, pasi Punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali mujor do te dorezohet ne kopje leter.

Vizatimet e riproduara do te perfshijne pozicionin dhe shtrirjen e te gjithe konstruksioneve mbajtese te lena gjate germimeve dhe vendosjen ekzakte te te gjitha sherbimeve qe jane ndeshur gjate ndertimit. Sipermarresi gjithashtu duhet te perqatise seksionet e profilit gjatesor te rishikuar, pajisur me shenimet qe tregojne shtresat e tokes qe hasen gjate te gjitha punimeve te germimit.

Si perfundim, kopjet e riproduara te Vizatimeve, “siç eshte zbatuar” do t'i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve per aprovim. Vizatimet, “siç eshte zbatuar”, te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit.

Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “siç eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kostoja e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Sipermarresit.

1.16 Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi te gjitha impiantet ndertimore, materialet qe kane tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndertimet e perkoheshme te çdo lloji dhe te lere sheshin e lire dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jetep miratimi nga Mbikeqyresi i Punimeve.

1.17 Provat dhe testet laboratorike

Ky seksion perfaqeson procedurat e kryerjes se provave per materialjet, me qellim qe te siguroje cilesine dhe qendrueshmerine ne perputhje me kerkesat e Specifikimeve.

1.17.1 Tipi dhe Zbatimi i Provave

Do te kryhen provat e meposhtme:

- Permbajtja e Ujit
- Densiteti Specifik
- Indeksi i Plasticitetit
- Densiteti ne gjendje te thatë (Metoda e Zevendesimit me Rere)
- Shperndarja Sipas Madhesise se Grimcave (Sitja)

- Proktori i Modifikuar dhe Normal
- CBR (California Bearing Ratio)
- Provat e Bitumit
- Provat e Betonit (Thermimi i Kampioneve)

1.17.2 Standartet per Kryerjen e Provave

Te gjitha provat do te behen ne perputhje me metodat standarte shqiptare ose me te tjera nderkombetare te aprovuara. Disa prej ketyre standardeve jane te listuara ne varesi te testit ne tabelen e meposhteme:Tabela 1.

1.17.3 Testet paraprake

Perpara nisjes se punimeve qe perfshijne perdorimin e materialeve ne sasi me te madhe se:

- 1.000 m³ per inertet dhe perzierje asfalti.
- 500 m³ per perzierje betoni.
- 50 ton per çimento dhe gelqere.

Supervizori, pas ekzaminimit te çertifikatave te cilesise te nxjerra nga Kontraktori, do te kerkoje teste te metejshme laboratorike te cilat do te kryhen me shpenzimet e Kontraktorit.

Ne rast se rezultatet e ketyre testeve do te ndryshojne nga ato te çertifikatave, do te merren masa per ndryshimet e nevojshme ne cilesi dhe ne sasi per komponente te veçante, dhe nxjerra e nje çertifikate te cilesise.

1.17.4 Teste Kontrolli Gjate Ndertimit.

Kontraktori eshte i detyruar te paraqese gjithe kohes dhe periodikisht, per furnizimin me materiale te perorimit te vazhdueshem, teste dhe analiza te materialeve qe do te perdoren, duke mbuluar te gjitha kostot e mbledhjes dhe dergimit te kampioneve ne laboratorin e kantierit ose laboratore te tjera te autorizuara. Kampionet do te grumbullohen ne marreveshje nga te dyja palet.

Do te konsiderohen si te vlefshme nga te dy palet vetem rezultatet e nxjerra nga laboratoret e siper permendur. Te gjitha referencat ne lidhje me specifikimet e tanishme do te behen ekskluzivisht vetem per rezultatet e lartpermendura.

Tabelat 1 dhe 2 tregojne frekuencen e sugjeruar te teesteve kontroll mbi materialet dhe punimet. Vetem Supervizori mund te ndryshoje, me urdher me shkrim, frekuencen dhe llojin e testeve gjate kryerjes se punimeve, sipas nevojave te punimeve.

Testi	Standartet e Referuara	Frekuencat (*)
Mbushjet		
Analiza Granulometrike	CNR 23-1971	2000 m ³
Indeksii Plasticitetit	AASHTO T 89 dhe 90	2000 m ³
Proktor CBR		2000 m ³
Lidhjet Densitet-Lageshti	CBR 69-1978	2000 m ³
Baza dhe Nen-baza me Material te Thyer		
Masa e Materialit me te Holle se 0.075 mm	CNR 75-1980	1000 m ³
Analiza Granulometrike	AASHTO T 27	1000 m ³
Proktor CBR		1000 m ³
Ekuivalenti i Reres	CBR 27-1972	500 m ³
Testi i Ferkimit Los Angelos	AASHTO T 96	5000 m ³
Lidhja Densitet-Lageshti	CBR 69-1978	2000 m ³
Perzierjet e Asfaltit dhe Betonit.		
Analiza Granulometrike	AASHTO T 27	500 m ³
Analiza Granulometrike e Filerit.	AASHTO T 37	500 m ³
Ekuivalenti i Reres	CRN 27-1972	500 m ³
Testi i Ferkimit Los Angelos	AASHTO T 96	2500 m ³
Testi Marshall	CNR 30-1973	Prodhim i Perditshem
Veshja dhe Zhveshja e Perzierjeve Bituminoze	CNR 138-1987	Prodhim i Perditshem
Penetracioni dhe Pikezbutja e Bitumit	AASHTO T 49	Qdo Dalje Nga Impianti

Table 1 - Frekuencat e sugjeruara per testimin e materialeve

Frekuencat e testimit mund te modifikohen nga Supervizori me nje kosto ekstra.

Punimi	Testi	Standarti Referues	Frekuenca (*)	Kerkesat Minimale
Shtresat Mbushese dhe Bazamenti	Densiteti i Dherave ne Vend	CNR 22-1972	1000 m ³	90 % mod. AASHTO i Densitetit $\geq 20 \text{ N/mm}^2$
	Ngarkesa Pllake	CNR 46-1972		
Nen-Shtresa	Densiteti i Dherave ne Vend	CNR 22-1972	500 m ³	95 % mod. AASHTO Densitet
	Modulimi i deformimit	CNR 46-1972	1000 m ³	$\geq 50 \text{ Nmm}^2$
Nen-Baza	Densiteti i Dherave ne Vend	CNR 22-1972	500 m ³	95 % mod. AASHTO Densitet
	Modulimi i Deformimit	CNR 46-1972	1000 m ³	$\geq 80 \text{ Nmm}^2$
Baza	Densiteti i Dherave ne Vend	CNR 22-1972	500 m ³	98 % mod. AASHTO Densitet
	Modulimi i Deformimit	CNR 46-1972	500 m ³	$\geq 150 \text{ N/mm}^2$
Baza Asfalt	Percaktimi i Permbajtjes Bituminoze	CNR 38-1973	1000 m ³	$\geq 3.5 \text{ wt i agg}$
Shtresa Binder	Si me Siper	Si me Siper	1000 m ³	$\geq 4.0 \text{ wt i agg}$
Shtresa Asfaltobeton	Si me Siper	Si me Siper	1000 m ³	$\geq 4.5 \text{ wt i agg}$
Baza Asfalt	Densiteti ne Vend	CNR 40-1973	500 m ³	$\geq 97 \%$
Shtresa Binder	Si me Siper	Si me Siper	500 m ³	$\geq 98 \%$
Shtresa Asfaltobeton	Si me Siper	Si me Siper	500 m ³	$\geq 98 \%$
Beton per Tip	Kompresim karakteristik Fortesi RCK	UNI 6132-72	100 m ³ ose çdo Strukture	Çdo Tip i Specifikuar
	Test Slump	UNI 7163-79	Specifikime	Specifikime
Beton Arme	Rrjedhshmeria e Perzierjeve	Marsh Koni	Specifikime	Specifikime

Table 2 - Frekuencat e Sugjeruara Per Testimin e Kontrollit Te Punimeve

1.17.5 Marrja e Kampioneve edhe Numri i Provave

Metoda e marries se kampioneve do te jete siç eshte specifikuar ne metodat e aplikueshme te marries se kampioneve dhe te kryerjes se provave, ose siç udhezohet nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Marrja e ndonje kampioni shtese mund te udhezohet nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Ene te tilla si çanta, kova e te tjera, do te jepen nga Sipermarresi. Marrja e kampioneve do te kryhet nga Sipermarresi ne vendet dhe periudhat qe udhezon Mbikeqyresit e Punimeve. Marrja, transportimi e sjellja e tyre ne laborator do te behet nga Sipermarresi.

1.17.6 Kostot e Provave dhe Marrjeve te Kampioneve

Te gjitha shpenzimet e Kontraktorit ne lidhje me kryerjen e provave, per ato tipe qe ai do te kryeje (perfshire edhe raportimin) do te perfshihen ne perqindjet e tij. Te gjitha shpenzimet e Kontraktonit ne lidhje me marrjen e kampioneve dhe ndihmen ne vendet e marrjes per ate tip provash te ndermarra nga Inxhinieri do te perfshihen ne perqindjen e tij.

1.17.7 Pajisjet per Kryerjen e Provave

Pajisjet per provat e meposhtme do te jepen nga Kontraktoret:

- permabjta e ujit
- densiteti specifik
- densiteti ne gjendje te thatë (metoda e zevendesimit me rere)

1.17.8 Rezultatet e Proves

Rezultatet e proves se Laboratorit do t'i jepen Inxhinierit ne zyren e tij nga Kontraktori, pa asnje pagese.

Rezultatet e proves te kryera nga Kontraktor do t'i jepen Inxhinierit per aprovim sa me shpejt te jetë e mundur.

1.17.9 Nderprerja e Punimeve

Nderprerja e punimeve per arsyte marrjes se kampioneve do te perfshihet ne grafikun e punimeve te Sipermarresit. Nuk do te pranohen vetem kur te kryhen ne një laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tillë pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

1.17.10 Provat e Kryera nga Sipermarresi

Per arsyte kahasimi, Sipermarresi eshte i lirë te kryeje vete ndonje prej provave. Rezultatet e provave te tillë do te pranohen vetem kur te kryhen ne një laborator te aprovuar me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Te gjitha shpenzimet e provave te tillë pavaresisht se nga vijne rezultatet do te mbulohen nga Sipermarresi.

2 GERMIMET

2.1 Qellimi

Ky seksion permban percaktimet e pergjithshme dhe kerkesat per punimet e germimeve ne toke (ne vellim dhe/ose me shtresa) dhe germimet per struktura ne kanale, perfshire germim nen uje. Me tej ajo mbulon te gjitha punimet qe lidhen me konstruksionin e prerjeve, largimin e materialeve te papershtatshme ne hedhurina, dhe rifiniturat e shpatit te prerjes.

2.2 Percaktimet

Percaktimet e meposhtme duhet te aplikohen:

2.2.1 Dherat

Germimi ne dhera duhet te aplikohet ne te gjitha materialet qe mund te germohen si me krahe, (perfshi me kazma) ashtu dhe me makineri.

2.2.2 Materialet Kryesore

Dherat dhe materialet shkembore, te cilet jane nxjerre prej germimeve te kryera neper karrierat e materialit apo guroret, do te konsiderohen si materiale baze per zbatimin e punimeve te ndertimit.

2.2.3 Materiale te pershtatshme

Materialet e pershtatshme do te perfshijne te gjitha materialet qe vijnë nga prerjet e rruges ose kavot te cilat kur jane kompakte brenda nje shkalle prej 2% te Permbajtjes se Perzierjes Optimale, deri ne 95% te MDD ka nje minimum prej 25% CBR, plasticiteti qe nuk e kalon 10, nje maksimum madhesie te kokrizave 100 mm, nje maksimum ky prej 35% duke kaluar neper nje site 200-she dhe qe deklarohet nga Supervizori si i pranueshem dhe si i perzgjedhur per mbushes ne tabanin e rruges. Mbushesi ne tabanin e rruges, i perzgjedhur do te klasifikohet si material i perzgjedhur per qellime matjesh, ne qofte se germohet nga nje zone ndryshe nga ajo ku eshte marre mbushesi parandhes (nen te).

2.2.4 Cilesia e Materialeve

Klasifikimi

Te gjitha llojet e dherave dhe materialeve shkembore qe perzgjidhen per punimet e ndertimit jane te klasifikuara sipas kategorive te meposhtme:

- dhera vegjetale kategoria 1
- dhera te butekategoria 2
- dhera kohezive dhe jo kohezivekategoria 3
- shkemb i bute kategoria 4
- shkemb i fortékategoria 5

Klasifikimi i dherave dhe materialit shkembor ne disa kategori bazohet ne cilesite e tyre te ndryshme qe ndikojne ne llojet e veçanta te punimeve te ndertimit. Ndersa makinerite moderne qe perdoren sot ne ndertim kane ndikimin e tyre persa i perket punimeve te germimit, transportimit dhe vendosjes se materialit (ne veper).

Tabela e meposhteme paraqet kategorite e dherave dhe materialit shkembor si dhe pershkruan metodat e germimit apo te perfshimit te materialeve te tille, duke dhene nje vleresim mbi shkallen e pershtatshmerise se perdonimit te tyre si dhe te karakteristikave qe ato kane.

Ne rast se gjate nje germimi shtresat e dherave dhe/ose shkembinjve jane te nderthurura ne ate menyre saqe klasifikimi i materialit behet i veshtire apo madje i pamundur, atehere do te duhet qe te percaktohet nje kategori e mesme e ketij materiali.

Mbi bazen e kerkesave te parashtruara ne kete seksion duhet te behet klasifikimi i te gjitha materialeve te perfshuara nga skarifikimet, germimet masive, germimet per themelet, germimet per kanalet e sherbimit, germimet per gropat e konstruksioneve te ndertesave, germimet e kanaleve per bonifikimin e tokes dhe sistemimin e lumenjve, germimet per kanalet anesore te rruges dhe atyre te drenazhimit vertikal te ujrate siperfaqesore, si dhe per vendosjen e pllakave ne siperfaqet e caktuara apo per gjate skarpatave per mbrojtjen e ketyre te fundit nga erozioni.

Kategorja	Emërtimi	Përshkrimi i materialit	Gradimi i materialit	Metoda gërmimit	Vlerësimi i fushës së përdorimit
1	Dhera vegetal	Gjëndet në sipërfaqe të tokës: Humus dhe torfë të përziera me materiale zhavoresh natyrore, ranore, lymore e argjilore. ($R_c = 20\text{ kPa}$)	-	Bulldozer, Eskavator	Të përshtatshëm vetëm si shtresë rrashuese për hedhjen e torfës; të dobët, të pa qëndrueshëm dhe jo rezistent karshi erozionit
2	Dhera të butë	Dhera me konsistencë të rrjedhshme (d.m.th. që marrin lehtësisht formën) deri në viskoze ($I_c \leq 0.5$); mund të përbajë material organik (depozitimet kënetore, materiale të shkrifta) $R_c = 20-40\text{ kPa}$	$> 15\text{ m.-% } \Phi < 0.063\text{ mm}$	Eskavator, Bulldozer	Nuk përdoren në gjendje natyrore
3	Dhera kohezivë dhe jo kohezivë	Dhera që gjënden poshtë shtresës vegjetale dhe kanë Konsistencë me rrjedhshmëri mesatare deri në të ngurtë. $R_c = 40-75\text{kPa}$ (dhera të zakonshëm, materiale të shkrifta) ose në gjendje të kompaktuar (rëra, zhavorre, copa inertësh)	$> 15\text{ m.-% } \Phi < 0.063\text{ mm}$ $< 15\text{ m.-% } \Phi > 0.063\text{ mm}$ $< 30\text{ m.-% } \Phi > 63\text{ mm}$	Bulldozer, Eskavator, Bulldozer me zinxhirë (në raste të veçanta)	Aplikohen për mbushje në gjendje natyrore në kushte të përshtatshme natyrore; stabiliteti dhe aftësia mbajtëse varen nga ndikimet e jashtme
4	Shkëmb i butë	Mergele, flishe, shtresa shkëmbinjsh metamorfikë, tufë vulkanike, konglomerate, brekçe si dhe dolomite, gurë gëlqerorë dhe ranorë të thërmuar ose të shkrifët. $R_c = 300\text{kPa}$	$> 30\text{ m.-% } \Phi > 63\text{ mm}$ $\Phi < 300\text{ mm}$	Bulldozer me zinxhirë, dragë Bluarje e materialit, Shpërthim i tij (në raste të veçanta)	Materiale të qëndrueshëm dhe aftësi mbajtëse të mirë; Kur janë me gradim të përshtatshëm përdoren dhe si material për mbushje dhe shresat e sipërme
5	Shkëmb i fortë (me origjinë sedimentare)	Gurë gëlqerorë, dolomite kompakte ose materiale me mbi 50 m.% biloqe $\Phi > 600\text{ mm}$ që duhet të shpërthehen ($R_c > 300\text{kPa}$)	Shkëmb i fortë, $\Phi > 600\text{ mm}$	Shpërthim i materialit, Bluarje e tij (në raste të veçanta)	Materiale me aftësi mbajtëse shumë të mirë, me gradimin dhe qëndrueshmërinë e duhur dhe që, si të tillë, janë të përshtatshëm për mbushje dhe/ose përpunim

Table 3 – Kategorizimi i materialit qe do te germohet

2.2.5 Tipet e Germimeve

Germimet perfshijne:

- Heqjen e shtreses vegetale deri ne trashesine e kerkuar (jo meteperi se 40 cm ne thellesi), duke perfshire edhe largimin dhe/ose transportin e saj ne nje zone te caktuar per depozitim;
- Germim masiv ne te gjitha kategorite e dherave dheshkembinje, ashtu siç parashikohet ne projekt, duke perfshire grumbullimin (krijimi i nje pirgu dhei) dhe/ose largimin, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve te germuara per mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushje (per themelet, etj.), dhe perdonimin si agregat per shtresat e konstruksioneve te barrierave mbrojtese, dhe/ose per depozitim, ne perputhje me menyren e perdonimit te ketij materiali gjate zbatimit te punimeve. Ne kete proces pune duhet te perfshihen edhe germimet e nevojshme per formimin e kaskadave apo shkallezimeve (p.sh. tek useket, etj.), germimet per pjeset ne germim te rruges, germimet e ndryshme neper guroret e materialeve si dhe punime te tjera te ngjashme qe kryhen per devijimet e rrugeve, mbrojtjet nga lumenjte, si dhe te gjitha germimet masive per ndertimin e strukturave;

te gjitha germimet e kerkuara per themelet e strukturave dheato te sherbimit apo per lloje te tjera te ngjashme (siç jane tobinot, pusetat, drenazhet), ne te gjitha kategorite e materialeve dhe ne çfaredo lloj thellesie:

- 1 m gjeresi, dhe
- 1–2 m gjatesi

Kjo pune duhet te perfshije gjithashtu edhe te gjitha veprimet qe nevojten per materialet e teperta te germuara, te cilat duhet te germohen deri ne nje kuote te caktuar, si dhe:

te gjitha germimet ne thellesi per gropat apo themelet estrukturave qe jane me gjeresi me teper se 2.0 m, per te gjitha kategorite e materialeve dhe deri ne çfaredo lloj thellesie, duke perfshire dhe largimin e materialit te tepert per

ne vendin e caktuar te depozitimit ose ne ato pjese te rruges ku materiali do te perdoret per mbushjen e trupit te saj, ri-mbushje, dhe si agregat per shtresat e konstruksioneve te barrierave mbrojtese. Kjo pune duhet te perfshije edhe germimin e materialit te tepert deri ne nje kuote te caktuar;

- te gjitha germimet per bonifikimin e tokes dhe per mbrojtjen ngalumenje dhe punime te tjera te ngjashme ne te gjitha kategorite e dherave dhe shkembinje dhe ne thellesi e gjeresi te ndryshme. Ne listen e ketyre punimeve duhet te perfshihen gjithashtu edhe thellimet dhe zgjerimet e kanaleve ekzistuese;
- te gjitha germimet per kanalet anesore dhe drenazhiminvertikal te ujrave qe shtrihen per gjate struktures se rruges, nenshtresat e rrugeve ekzistuese, ku perfshihet largimi anesor i materialeve dhe/ose transporti i tyre deri ne vendin e caktuar te depozitimit;
- te gjitha germimet per shtresat dhe muret mbajtese, kuperfshihen dhe veshjet me gure, etj. te siperfaqeve te caktuara ne projekt per mbrojtjen nga erozioni apo infiltrimet e ujrave, duke perfshire edhe largimin anesor te materialeve dhe/ose transportin e tyre deri ne vendin e caktuar te depozitimit.

2.2.6 Metoda te pergjithshme te zatimit te punimeve te germimit

Germimet duhet te kryhen sipas profileve terthore e gjatesore te rruges, kuotave te nevojshme, pjerresive, dhe thellesive te percaktuara ne projekt zbatimin. Duhet te merren gjithashtu ne konsiderate dhe cilesite e kategorive te veçanta te materialit, si dhe vjetite e materialit te germuar, per te perm bushur kerkesat e nje per dorimi te veçante te tyre. Heqja e shtreses vegetale duhet te kryhet deri ne thellisine e pershtatshme per te gjitha rastet kur sipas projektit kerkohet germim i metejshem dhe per gatitje e nenshtreses. Dherat vegetale duhen larguar ne perputhje me keto kushte teknike dhe ashtu siç parashikohet ne projekt. Materiali i germuar duhet te depozitohet per gjate rruges por, per te shmanjur pengimin e punimeve, duhet te depozitohet jashte zones apo siperfaqes se nenshtreses. Hedhja dhe perpunimi i materialit ne vend-depozitim duhet te kryhet me kujdes per te ruajtur cilesine e dheut vegetale, i cili do te perdoret me vone per gjelberimin e faqeve te pjerreta te skrapatave te rruges dhe te siperfaqeve te tjera te gjelbera, si dhe per te shmanjur perzierjen e ketyre materialeve me material tjeter jo pjellor.

Ne faqen e jashtme te pjeses se prapme te pirojeve te dherave vegetale te depozituar prane rruges, duhet te ndertohen drenazhime te kontrolluara qe nuk lejojne akumulimin ose perthithjen e ujrale nga keto dhera si dhe nga tokat natyrore te paprekura. Kur gjate punimeve ndeshet ne material me aftesi te vogel mbajtese, atehere i tere ky material duhet te mbartet ne vend-depozitime te veçanta jashte zones se ndertimit (p.sh. ne zona qe

ndodhen jashte siperfaqes se trupit te rruges). Keto vend-depozitime duhet te per gatiten paralelisht dhe ne menyre proporcionale me progresin e punimeve. çfaredo lloj materiali tjeter qe nuk eshte i pershtatshem per ndertimin e struktura se rruges duhet te largohet. Kontraktori duhet te per gatise vend-depozitimin per materiale te tilla ne vendin e caktuar nga Inxhinieri Mbikqyres.

Perveçse kur eshte percaktuar ndryshe, materiali i tepert duhet te perdoret se pari per zgjerimin e trupit te rruges, per te siguruar me teper hapesire per parkime dhe pika shikimi panoramike. Keto vende duhet te perzgjidhen nga Mbikqyresi I Punimeve.

2.3 Germimi ne rruge

- Germimi ne rruge duhet te kryhet ne perputhje me nivelet dhe vijen e prerjeve siç tregohet ne Vizatime. Çdo thellesi me te madhe te germuar nen nivelin e formacionit, brenda tolerances se lejuar, duhet te behet mire me mbushje me materiale te pranueshme me karakteristika te ngjashme nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- Kujdes i veçante duhet te ushtrohet kur germohen prerje per te mos hequr material pertej vijes se specifikuar te prerjes dhe me pas duke shkaktuar rrezikshmeri per qendrueshmerine strukturore te pjerresise ose duke shkaktuar erozion ose disintegrin e pjeseve te ngjeshura.
- Permasat e prerjeve duhet te jene ne perputhje me detajet e sesione terthore tip siç tregohen ne Vizatime.

2.4 Trajtimi/Ngjeshja e Zonave te Germuara

- Zonat dhe pjerresite e prerjeve duhet te jene konform me Vizatimet dhe duhet te rregullohen sipas nje vije te paster te standartit, per nje tip te dhene materiali.

- Te gjitha zonat horizontale te germuara, duhet te ngjeshen me një minimum dendesie të thate prej 95% per dhera te shkrifet dhe 90% per dhera te lidhur.

2.5 Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjithe keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per Punedhenesin. Te gjitha pemet dhe shkurret qe jane pecaktuar nga Punedhenesi qe do te ngelen do te mbrohen dhe ruhen ne menyen e aprovuar.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identikuara per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikeqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themelive te ndertimeve qe mund te ndeshen.

Sipermarresi do te marre te gjitha masat e nevojshme per mbrojtjen e vijave ekzistuese te ujit, rrerhimeve dhe sherbimeve qe do te mbeten ne sheshin e ndertimit. Kosto e pastrimit te kantierit eshte e detryueshme te paguhet brenda çmimit njesi per punimet e germimit .

2.6 Germimi per Strukturat

Germimi per strukturat duhet te jete ne perputhje me Vizatimet. Anet duhen mbeshtetur ne menyre te pershtatshme gjate gjithe kohes. Nje alternative eshte qe ato mund te ngjeshen ne menyre te pershtatshme.

Germimet duhet te mbahen te pastra nga uji. Tabani i te gjithe germimeve duhet te nivelohet me kujdes. Çdo pjese me material te bute ose mbeturina shkembi ne taban duhet te hiqet dhe kaviteti qe rezulton te mbushet me beton.

2.7 Germimi i kanaleve per tubacionet

Kanalet do te germohen ne dimensionet dhe nivelin e treguar ne vizatime dhe /ose ne perputhje me instrukzionet me shkrim te Mbikeqyresit te Punimeve. Zeri i treguar ne tabelen e Volumeve (Preventiv) lidhur me germimet ,siç eshte largimi i materialit te germuar, etj. do te perfshije çdo lloj kategorie dhei, nese nuk do te jete specifikuar ndryshe. Germimi me kraheeste gjithashtu i nevojshem ne afersi te intersektimeve te infrastrukturave te tjera per te parandaluar demtimin e tyre. Me perjashtim te vendeve te permendura me siper , mund te perdoren makinerite.

Nese nuk urdherohet apo lejohet ndryshe nga Mbikeqyresi i Punimeve nuk duhet te hapen me shume se 30 metra kanal perpara perfundimit te shtrirjes se tubacionit ne kete pjese kanali. Gjereria dhe thellesia e kanaleve te tubacioneve do te jete siç eshte percaktuar ne vizatimet e kontrates, ose siç do te udhezohet nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Thellimet per pjeset lidhese do te germohen me dore mbasi fundi i kanalit te jete niveluar. Perveçse kur kerkohet ndryshe, kanalet per tubacionet do te germohen nen nivelin e pjeses se poshtme te

tubacionit si tregohet ne vizatime, per te bere te mundur realizimin e shtratit te tubacioneve me material te granular.

2.8 Ujerat e shiut – gjate punimeve te germimit

Punimet e germimit duhet te organizohen ne menyre te tille qe te shmangin çdo lloj pengese serioze te punimeve per shkak te ujrate te shiut apo çdo burimi tjeter ujrash. Kjo gje vlen ne veçanti per rastin e germimit te dherave. Kujdes i posaçem duhet t'i kushtohet largimit te ujrate prej terrenit te germuar (permes rruges me te shkurter), si dhe te germohet vetem ajo sasi dheu e cila mund te transportohet me anen e makinerive ne dispozicion, ose qe mund te perdoret menjehere brenda nje strukture te caktuar. Pasojat e mundshme duhet te mbarten nga vete Kontraktori ne rast te mos respektimit te ketyre udhezimeve, i cili nuk ka te drejte te kerkoje asnje lloj mbulimi te shpenzimeve dhe as te synoje te krye ndryshime te procedurave te punimeve, te cilat ne çdo rast do te ishin ne dem te Punedhenesit.

Si rregull, germimi i dherave me aftesi te vogel mbajtese nuk duhet te lihet i hapur per nje periudhe te gjate kohe; per kete arsye eshte e nevojshme qe punimet e germimit te jene te koordinuara me procesin e ri-mbushjes me material. Ujrat e shiut duhet te hiqet me pompe gjate gjithe kohes se punimeve te germimit derisa kuota e mbushjes te kete kaluar kuoten e ujrate nentokesore. çmimin per çfaredo demi qe mund te shfaqet nese nuk kryhet pompimi duhet t'a mbuloje Kontraktori. Demet e pjesshme te siperfaqeve te pjerreta duhet te pastrohen dhe te mbushen me material te pershatatshem dhe shpenzimet per to do t'i mbuloje Kontraktori. Per shkak te cilesive specifike te dherave per mbushje, gjate punimeve te ndertimit materiali i gerrmuar nuk duhet te depozitohet ne vendin e gerrmimit por duhet menjehere te ngarkohet dhe transportohet me automjete. Nese gjate punimeve te germimit te dherave me aftesi te vogel mbajtese preket nje burim uji ose ndonje kanal per bonifikimin e tokes, atehere duhet te ndertojet nje tombino e perkohshme me prerjen e kerkuar terthore. Nese eshte e mundur, duhet shfrytezuar çdo mundesi per devijimin e rrjedhjes se nje perroi ne ate te nje perroi tjeter.

2.9 Perdorimi i materialeve te germimit

Te gjitha materialet e pershatashme dhe te aprovuara te germimit duhet, persa kohe qe ato jane praktike, te perdoren ne ndertim per mbushje dhe punime rruge.

2.10 Rimbushja e Themeleve

Te gjitha mbushjet per kete qellim duhet te behen me materiale te pershatashme dhe te ngjeshen, vetem nese tregohet ndryshe ne Vizatime ose urdherohet nga Mbikqyresit te Punimeve.

2.11 Perforcimi i ndertesave

Si pjese e punes ne zerat e germimit Sipermarresi, me shpenzimet e veta, do te perforcoje te gjithe ndertimet, muret si edhe strukturat e tjera qendrueshmeria e te cilave duhet te garantoje mosrrezikimin gjate zbatimit te punimeve dhe do te jete teresisht perqejgjes per te gjithe demtimet e personave ose te pasurive qe do te rezultojne nga aksidentet e ndonje prej ketyre ndertimeve, mureve ose strukturave te tjera.

Ne qofte ndonje nga keto pasuri, struktura, instalime ose sherbime do te rrezikohen ose demtohen si rezultat i veprimeve te Sipermarresit, ai menjehere duhet te raportoje per keto rreziqe ose demtime Menaxherin e Projektit si dhe autoritetet qe kane lidhje me te dhe menjehere te marre masa per ndreqjen, gjithmone sipas pelqimit te Mbikeqyresit te Punimeve ose te autoriteteve perkatese.

2.12 Perforcimi dhe veshja e germimeve

Nese germimi i zakonshem nuk eshte i mundur apo i keshillueshem, gjate germimeve duhet te vendosen struktura mbajtese per te parandaluar demtimet dhe vonesat ne pune si edhe per te krijuar kushte te sigurta pune. Sipermarresi do te furnizoje dhe vendose te gjitha strukturat mbajtese, mbulese, trare dhe mjete te ngjashme te nevojshme per sigurimin e punes, te publikut ne per gjithesи dhe te pasurive qe jane prane. Strukturat mbrojtse do te hiqen sipas avancimit te punes dhe ne menyre te tille qe te parandalojne demtimin e punes se perfunduar si edhe te strukturave e pasurive qe jane prane. Sapo keto te hiqen te gjitha boshlleqet qe mbeten nga heqja e ketyre strukturave duhet te mbushen me kujdes dhe me material te zgjedhur dhe te ngjeshur. Sipermarresi do te jete krejesht per gjegjes per sigurimin e punes ne vazhdim, te punes se perfunduar, te punetoreve, te publikut dhe te pasurive qe jane prane. Kostoja e perforcimit dhe veshjes se germimeve eshte perfshire ne çmimin njesi per germimet.

2.13 Mirembajtja e germimeve

Te gjitha germimet do te mirembahen siç duhet, nderkohe qe ato jane te hapura dhe te ekspozuara, si gjate dites ashtu edhe gjate nates. Pengesa te mjaftueshme, drita paralajmeruese, shenja, si edhe mjete te ngjashme do te sigurohen nga Sipermarresi. Sipermarresi do te jete per gjegjes per ndonje demtim personi ose pronesie per shkak te neglizhences se tij.

2.14 Largimi i ujerave nga punimet e germimit

Si pjese e punes ne zerat e germimit dhe jo me kosto plus per Punedhenesin, Sipermarresi do te ndertoje te gjitha drenazhimet dhe do te realizoje kullimin me kanale kulluese, me pompim ose me kova si edhe te gjithe punet e tjera te nevojshme per te mbajtur pjesen e germuar te paster nga ujerat e zeba dhe nga ujera te jashme gjate avancimit te punes dhe deri sa puna e perfunduar te jete e siguruar nga demtimet. Sipermarresi duhet te siguroje te gjitha pajisjet e pompimit per punimet e tharjes se ujit si edhe personelin operativ, energjine e te tjera, dhe te gjitha keto pa kosto shtese per Punedhenesin. I gjithe uji i pompuar ose i drenazhuar nga vepra duhet te hiqet ne nje menyre te aprovueshme prej Mbikqyresit te Punimeve. Duhet te merren masa paraprake te nevojshme kunder permbytjeve.

2.15 Perforcimi dhe mbulimi ne vend

Punedhenesi mund te urdheroje me shkrim qe ndonje ose te gjitha perforcimet dhe strukturat mbajtese te lihen ne vend me qellim te masave paraprake per mbrojtjen nga demtimet te strukturave, te pronesive te tjera ose personave, nese keto struktura mbajtese jane shenuar ne vizatime ose te vendosura sipas udhezimeve, ose nga ndonje arsyet tjeter. Nese lihen ne vend keto struktura mbrojtse do te priten ne lartesinee sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Strukturat mbajtese qe mbeten ne vend do te shtrengohen mire dhe do te paguhen sipas vlerave qe do te bihet dakort reciprokisht ndermjet

Sipermarresit dhe Punedhenesit ose sipas çmimit ne Oferte n.q.s eshte dhene, ose nga një urdher ndryshimi me shkrim.

2.16 Mbrojtja e sherbimeve ekzistuese

Sipermarresi do te kete kujdes te veçante per sherbimet ekzistuese qe jane nen siperfaqe te cilat mund te ndeshen gjate zbatimit te punimeve dhe qe kerkojne kujdes te veçante per mbrojtjen e tyre , si tubat e kanalizimeve, tubat kryesore te ujesjellesit, kabllot elektrike kabllot e telefonit si dhe bazamentet e strukturave qe jane prane. Sipermarresi do te jete perqiegjes per demtimin e ndonje prej sherbimeve si dhe duhet t' i riparoje me shpenzimet e tij, nese keto sherbime jane ose jo te paraqitura ne projekt. Nese autoritetet perkatese pranojn te rregullojne vete ose nepermjet nje Nensipermarresi te emeruar nga ai vete, demet e shkaktuara ne keto sherbime, Sipermarresi do te rimbursoje te gjithe koston e nevojshme per kete riparim, dhe nese ai nuk ben një gje te tille, keto kosto mund t' i zbriten nga çdo pagese qe Punedhenesi ka per ti bere ose do ti beje Sipermarresit ne vazhdim te punimeve.

2.17 Heqja e materialeve te teperta nga germimi

I gjithe materiali i tepert i germuar nga Sipermarresi do te largohet ne vendet e aprovuara ose te caktuara nga Bashkia. Kur eshte e nevojshme te transportohet material mbi rrugjet ose vende te shtruara Sipermarresi duhet ta siguroje kete material nga derdhja ne rruge ose ato vende te shtruara.

2.18 Pershkrimi i çmimit njesi per germimet

Çmimi njesi i zerave te punes per germimet do te perfshijne, por nuk do te kufizohen per germime ne te gjithe gjeresine dhe thellesine, me çdo mjet qe te jete i nevojshem, duke perfshire germime me dore, nen apo mbi nivelin e ujraleve nentoksore, ose nivelin e ujraleve siperfaqsore, perfshire perzierje dheu te çdo lloji, mbeshteteset, perforcimin ne te gjitha thellesite dhe gjeresite, me çdo lloj mjeti qe te jete nevoja, perfshire edhe germimet me dore, dhe do te perfshije largimin e ujraleve nentokesor dhe siperfaqesor ne çdo sasi dhe nga çdo thellesi, me cdo mjet te nevojshem, do te perfshije nivelimin,

sheshimin, ngjeshjen e formacioneve, proven dhe per çdo pune shtese per mbrojtjen e formacioneve perpara çdo inspektimi, siç specifikohet, largimin dhe grumbullimin e pemave te larguara, rilevimi topografik i kerkuar, vendosja e piketave te perhershme, dhe te atyre te perkoheshme, realizimi i matjeve, sigurimi i instrumentave per tu perdorur nga Mbikeqyresi i Punimeve, furnizimi dhe transporti i fuqise punetore, mbajtja e vendit te punes paster dhe ne kushte higjeno-sanitare, dhe çdo nevoje aksidentale e nevojshme per realizimin e Punimeve brenda periudhes se Kontrates dhe pelqimit te Mbikeqyresit te Punimeve.

Aty ku materiali i germuar eshte perdorur per mbushje; depozitimi duke perfshire dhe transportin ne dhe nga depozitimi, ngarkimin, shkarkimin, transportin me dore, jane perfshire ne çmimin njesi per germimet.

Kostoja e transportimit te materialit te tepert te germuar deri ne vendin e hedhjes, te aprovuar nga Mbikqyresi i Punimeve, nuk perfshihet ne çmimin njesi te germimit. Kosto e transportimit te materialit te tepert ne vendin e hedhjes mbulohet nen çmimin njesi te transportit te materialeve.

Perveç transportimit te materialit te tepert te gjitha llojet e transportit perfshire edhe transportin e materialeve per perforsim, mbulim, perqatitjen e shtratit, etj perfshihen ne çmimin njesi te germimit.

Nese nuk eshte pohuar ndryshe, te gjitha aktivitetet e tjera te pershkruara me siper do te konsiderohen te perfshira ne çmimin njesi te germimit.

2.19 Matjet

Te gjitha zera e germimeve do te maten ne volum. Matja e volumit te germimeve do te bazohet ne dimensionet e marra nga vizatimet, ne te cilat percaktohen permasat e germimeve.

Çdo germim pertej limiteve te percaktuara ne keto vizatime, nuk do te paguhet, nese nuk percaktohet me pare me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Megjithate, nese germimi eshte me pak se volumi i llogaritur nga vizatimet, do te paguhet volumi faktik i germimeve sipas matjeve faktike.

3 PUNIME MBUSHJE

3.1 Te pergjithshme

Punimet mbushese do te realizohen ne perputhje me permasat dhe nivelet qe tregohen ne vizatime dhe/ose siç percaktohen ndryshe me shkrim nga Mbikeqyresi i Punimeve. Punimet do te realizohen ne nivelin qe te kenaqin kerkesat e Mbikeqyresit te Punimeve.

Materialet qe do te perdoren per punimet mbushese do te jene te lira nga gure dhe pjesa te forta me te medha se 75 mm ne çdo permase, dhe gjithashtu te paster nga perberesa druri apo mbeturina te çdo lloji. Materiali mbushes do te ngjeshet sipas menyres se aprovuar.

Kanalet dhe shpatet, transete dhe mbushjet e rrugeve do te gjeshen gjithashtu. Nese nuk specifikohet ndryshe apo kerkohet ndryshe nga Mbikeqyresi i Punimeve, materiali mbushes dhe mbulues do te merret nga punimet e germimeve. Nese Mbikqyresi i Punimeve percakton se materiali nuk eshte i cilesise se duhur atehere, do te perdoret material i zgjedhur i sjelle nga nje zone tjeter. Materiali i zgjedhur do te jete homogjen dhe do ti kushtohet rendesi pastrimit nga llumrat, boshlqeget dhe çdo parregullsi tjeter.

Mbushjet dhe mbulimet do te jene ne shtresezime te vashdueshme dhe gati horizontale per te arritur trashesine e treguar ne vizatime ose siç mund te kushtezohet nga Mbikeqyresi i Punimeve. Mbulimi, ne punimet e mbushjes dhe mbulimit, me materiali siperfaqes , nuk eshte i lejueshem. Shtresa e siperme e fundit , e mbushjes dhe e mbulimit duhet te mbahet ne gjendje sa me te sheshte te jete e mundur. Ne vendet ku kerkohet mbushje ose mbulim shtese, lartesia e treguar ne vizatime per mbushje dhe mbulim do te rritet ne perputhje me udhezimet e dhena.

Ne keto punime do te perfshihet sa vijon:

- shperndarja me makineri e materialit per mbushje;
- shperndarja me makineri dhe/ose me dore e materialit per mbushje ne germimet per themele, kanalet e sherbimit, germimet per gropat e ndertesave, kanalet per sistemimin e lumenjve dhe bonifikimin e tokes, kanalet anesore dhe ato vertikale te rrugeve per drenazhimin e ujrave;
- shperndarja me makineri dhe/ose me dore e shtreses mbrojtse te aggregatit te thyer ne pjeset e pasme te strukturave si dhe pjeset e kalimit nga germimet ne nje masiv shkembor drejt zonave ne mbushje te trupit te rruges;
- shperndarja me makineri dhe/ose me dore e materialit ne shtratin e rruges sipas specifikimeve te projektit dhe/ose sipas udhezimeve te Inxhinierit Mbikqyres, si dhe ketyre kushteve teknike;
- sperkatja me uje, perzierja, rrafshimi, dhe ngjeshja e materialeve per formimin e trupit te rruges, materialit per mbushje themelesh, te shtresave mbrojtse prej materiali te thyer, ne perputhje me menyren e dhene dhe sipas cilesise se percaktuar ne projekt dhe keto kushte teknike;

- shperndarja me makineri e materialit, qe do te perdoret per parangarkimin dhe mbingarkimin e zonave te percaktuara ne projekt, ne perputhje me keto kushte teknike;
- ndertimi i shtratit te rruges ne madhesine dhe cilesine e percaktuar ne projekt dhe ne keto kushte teknike;
- ndertimi i konstruksioneve prej dherash te ngjeshur (te perzier) ne zonat e percaktuara ne projekt dhe ne perputhje me keto kushte teknike, duke perfshire transportin dhe vendosjen ne veper te dherave kohezive.

3.2 Ndertimi i mbushjeve

Tabani i dheut i shtresave rrugore eshte pjese e trupit te dheut ku shperndahen nderjet e shkaktuara nga ngarkesat e levizshme te automjeteve dhe e vete konstruksionit. Ky taban mund te jete ne mbushje ose ne germim. Si ne njerin rast edhe ne tjetrin eshte e nevojshme qe te sigurohet nje taban, qe te jete ne gjendje te transmetoje me poshte, ne trupin e dheut ngarkesat qe vijnë nga shtresat rrugore, pa pesuar deformime mbetese.

Mbushja gjithandej duhet te kete nje densitet qe i referuar standartit AASHTO te modifikuar, te jete max. ne te thate jo me pak se 90%, per shtresat e poshtme te ngjeshura dhe 95%, per shtresen e siperme 30cm (subgrade).

Çdo shtrese duhet te ngjishet me lageshtine optimale duke shtuar ose thare shtresen sipas rastit dhe kerkeses se llojit te materialit qe do te perdoret ne mbushje te rruges.

Çdo shtrese e re ne mbushje duhet te miratohet nga Mbikeqyresit e Punimeve, pasi te jete siguruar se shtresa paraardhese nuk ka deformacione ose probleme me burime uji apo lageshtire te tepert.

Zgjedhja e pajisjeve te ngjeshjes eshte e lire te behet nga Sipermarresi, mjafton qe pajisjet ngjeshese te sigurojne energjine e nevojshme dhe te arrijne densitetet e kerkuara ne ngjeshje per shtresen ne ndertim.

3.3 Mbushja dhe mbulimi

3.3.1 Pergatitja e shtratit

Jetegjatesia e tubacioneve Polietilenit te shtruara ne toke varet shume nga cilesia e shtratit.

Materiali dhe ngjeshmeria e duhur e shtratit menjanon difektet qe mund te shkaktohen nga deformimet e padeshiruara dhe mbingarkimet vendore.

A ka nevoje per shrat te veçante gjykohet sipas llojit te tokes. Shtrati nuk eshte i nevojshem, kur toka eshte e forte, me strukture kokrrizore, dhe $D_{max} < 20$ mm. Por edhe ne keto raste fundi (tabani) duhet ngjeshur. Ne te gjitha rastet e tjera dhe shtrat, me trashesi minimale 10 cm, ne shkemb dhe ne toke me gure 15 cm.

Ne toke te disfavorshme, si toke me shume permbajtje organike, dhe qe shembet lehte, shtresa nen nivelin e ujit freatik, nen shtrat duhet projektuar edhe si shtrese mbeshtetese. Materiali dhe ndertimi i saj percaktohen veçmas per çdo rast nga projektuesi.

Per shtratin mund te perdoret dhe i shkrifet dhe i ngjeshur ose dhe pak i lidhur, pa shuka. Diametrat maksimale te grimcave:

- ne rastin e tubave PVC dhe Polietilenit normal, me faqe te rrafshet: $D_{max} < 20\text{ mm}$
- ne rastin e tubave te lemuar : $D_{max} < 5\text{ mm}$

Ky material shtrati duhet vendsosur ne tere zonen e tubit, deri 30 cm mbi buzen e siperme te ketij (shih projektin). Ne tere zonen e tubit hedhja dhe ngjeshja duhet te behen ne shtresa jo me te trasha se 15 cm.

Per tubat me diameter te vogel trashesia e shtreses se poshtme nuk mund te jete me shume se $D/2$.

Mbushja me hedhje te dheut me makineri eshterreptesist e ndaluar. Hedhja e dheut, levizja dhe ngjeshja e tij do te behen vetem me dore. Per ngjeshje rekomandohen tokmake me buze te rrumbullakuara.

Ne terren te pjerret duhen ndertuar dhembe betoni kunder shkarjes. Madhesine dhe dendesine e dhembeve e gjykon projektuesi.

Per orientim: Kur pjerresia eshte mbi 10% dhe kur zona mbi tub mban uje, kur pusetat jane me larg se 80m nga njera-tjetra, propozohen dhembe çdo rreth 50m.

3.4 Materiali

Pershtatshmeria e perdonimit te materialeve shkembore duhet te percaktohet permes kryerjes se testeve paraprake te mostrave karakteristike te marra nga karrierat. Per keto materialet duhet te verifikohen cilesite e meposhtme:

- granulometria;
- permbajtja e lageshtise optimale dhe dendesia maksimale sipas testit te modifikuar te Proktor-it;
- permbajtja e lendeve organike.

Koeficienti i mosvazhdueshmerise se granulimit te materialeve te gurte $U = d_{60}/d_{10}$ qe perdoren per mbushje, shtresa te siperme dhe shtresa per nivelim, duhet te jete se paku 6.

Nese materiali shkembor per mbushje,shtresa te siperme vendoset deri ne thellesine e depertimit te ngricave hm, atehere ky material duhet te jete rezistent ndaj ngricave. Nese materiali i gurte per mbushje, shtresa te siperme vendoset deri ne thellesine kritike te depertimit te ngricave hmin (te percaktuar gjate procesit te dimensionimit te trasese se shtresave), ai mund te permboje:

kur $U \geq 15$:

- ne vendin e depozitimit te materialit, jo me teper se 5 m.-% e kokrrizave me te medha se 0.0063 mm;
- per materialin e vendosur ne veper, jo me teper se 8 m.-% e kokrrizave me te medha se 0.0063 mm;

kur $U \leq 6$:

- jo me teper se 15 m.-% e kokrrizave me te medha se 0.0063 mm.

Vlerat mesatare duhet te caktohen me interpolim linear. Ne zonat qe ndodhen midis thellesise se depertimit te ngricave hm dhe thellesine kritike te depertimit te ngricave hmin, perziera e perbere kryesish nga kokrriza te gurta duhet te permaje ≤ 15 m.-% kokrriza me jo me teper se 0.02 mm. Vlerat mesatare te matura (te ngjeshjes) dhe vlerat individuale kufitare te saj perfaqesojne 100% te vleres se çmimit njesi te ofruar.

Vlerat e poshtme kufitare te aftesise mbajtese, si dhe vlerat e tyre individuale qe shkojne drejt minimumit (per jo me shume se 5% e numrit te per gjithshem te matjeve), perfaqesojne 100% te vleres per çmimin njesi te ofruar.

Diametri i kokrrizes me te madhe te materialit te gurte qe do te perdoret per mbushjen e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer dhe bazamentin e rruges nuk duhet t'i tejkaloje 2/3 e trashesise se shtreses (pra, trashesia e shtreses duhet te jete deri ne 1.5 here sa diametri i kokrrizes me te madhe), por nuk duhet te jete me e madhe se 300 mm (10% e peshes se materialit mund te permaje kokrriza me diameter 300 deri 400 mm), perveç rasteve kur kerkohet ndryshe ne projekt. Ndryshime nga specifikimet e dhena me siper mund te lejohen vetem nese cilesite e kerkuara te nje shtrese tregohen gjate vendosjes. Per rastin e materialeve te gurte me kokrriza me diameter me te madh se 60 mm, me anen e testeve paraprake duhet te percaktohen keto parametra:

- dendesia e nje shtrese materiali me nje trashesi te caktuar (metoda alternative e testimit), e cila me vone mund te perdoret si element baze per vleresimin e matjeve te metejshme te shkalles se ngjeshjes se materialit te vendosur ne siperfaqen e nje shtrese;
- permajtja e lageshtise optimale ne material.

Ne rastin e kushteve klimatike jo te favorshme (kur niveli i ujerave nentokesore ose levizja kapilare e ujerave arrin deri ne kuoten e ngrirjes) materiali shkembor qe do perdoret per mbushjen e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer si dhe ndertimin e bazamentit te rruges mund te vendoset deri ne kuoten e ngrirjes, por me kusht qe te permaje:

- nese $U \geq 15$, 5% m/m e kokrrizave nuk duhet te jene me te medha se 0.06 mm;
- nese $U \geq 8$, 15% m/m e kokrrizave nuk duhet te jene me te medha se 0.06 mm.

Nese materialet shkembor qe do perdoren per mbushjen e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave prej materiali te thyer si dhe ndertimin e bazamentit te rruges nuk jane rezistente ndaj kushteve te caktuara klimatike, atehere ato duhet te mbrohen karshi tyre ne menyren e duhur menjehere pas vendosjes se tyre ne veper

3.5 Shtimi dhe Nivelimi

Çdo shtrese e veçante e materialit qe perdoret per mbushjen e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer, ndertimin e bazamentit te rruges dhe ndertimin e shtresave prej dherash te ngjeshur duhet te shtrohet dhe nivelojet) ne drejtimin gjatesor me nje pjerresi, e cila nuk eshte me e madhe se pjerresia gjatesore e rruges sipas projektit. Çdo shtrese e veçante e materialit ne drejtimin terthor te rruges duhet te shperndahet ne menyre te tille qe te sigurohet pjerresia terthore e saj me nje ose dy pjerresi, e cila ne rastin e dherave duhet te jete nga 3—5%. Per rastet e materialeve shkembore, hirat dhe dherat e stabilizuar kimikisht pjerresia terthore duhet te jete e njeje me pjerresine e projektuar te shtreses se siperme te rruges.

Per rastet kur, per shkak te kushteve te terrenit, siperfaqja e perfunduar e tabanit te perbere prej dherash e materialesh shkembor nuk arrin pjerresine terthore minimale (2—3%) qe nevojitet per largimin e duhur te ujравe, atehere kjo pjerresi terthore duhet te arrihet permes shtresave te paraardhese te materialit te vendosura per mbushjet e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer, ndertimin e bazamentit te rruges dhe ndertimin e shtresave prej dherash te ngjeshur. Çdo shtrese individuale e materialit duhet te shperndahet menjehere ne ate gjeresi e cila, pas kryerjes se procesit te nivelimit te per gjithshem dhe ngjeshjes se shtreses, do te siguronte cilesine e kerkuar te saj deri ne skajin e mbushjes (d.m.th. deri tek pika e siperme e

skarpates se rruges). Trashesia e çdo shtrese te veçante te materialit te shperndare e te niveluar duhet t'i per gjigjet maksimumit te thellesise se ngjeshjes qe mund te arrihet me makinerite dhe cilesine e materialit te perdonur. Kjo gje duhet te verifikohet me anen e kryerjes se mbushjeve prove.

Materiali nuk duhet te shperndahet dhe/ose te vendoset ne terren te ngrire, si dhe nuk duhet te lejohet vendosja e materialit te ngrire per mbushjet e trupit te rruges, themeleve, ndertimin e shtresave mbrojtse prej materiali te thyer, ndertimin e shtratit te rruges dhe ndertimin e shtresave prej dherash te ngjeshur. Shkalla e pjerresise mund te rritet duke marre parasysh faktin se me stabilizimin kimik te dherave do te rritet kendi i brendshem i ferkimit te perzierjes.

3.6 Mirembajtja e drenazheve

Mbulimi do te behet ne menyre te tille qe te mos mbetet apo te akumulohet uje ne pjeset e pambushura ose kanalet pjeserisht te mbushura. Materialet e depozituara ne kanalet e rrugeve ose ne rruge te tjera ujore qe nderpriten nga linja e kanaleve do te largohen menjehere pas perfundimit te procesit te mbulimit duke kthyer formen dhe permasat e kanaleve ne gjendjen e meparshme. Drenazhimet siperfaqsore nuk do te nderpriten per kohe te gjate nese nuk do te jete e nevojshme.

3.7 Ngjeshja

Sipermarresi do te jete perjegjes per qendrueshmerine e mbushjeve, mbulimeve dhe shtratit te tubave brenda periudhes se korigjimit te difekteve, qeeshte percaktuar ne Kushtet e Kontrates. Pasi te jene shtruar dhe niveluar siç duhet, materialet natyrore dhe ato (materiale natyrore) qe jane te permiresuar dhe/ose stabilizuar kimikisht me anen e lidhesve, duhet te ngjeshen deri ne trashesine e caktuar (ne te gjithe gjeresine e shtreses) duke perdonur makineri rrullimi me cilindra ose me goma. Ne parim, ecuria e procesit te ngjeshjes duhet te filloje nga skaji i jashtem i siperfaqes qe ngjeshet ne drejtim te qendres se saj. Vendet ku nuk mund te hyjne keto makineri duhet gjithashtu te ngjeshen sipas projektit duke perdonur per kete mjete e metoda te tjera per ngjeshje te cilat duhet te miratohen paraprakisht nga Inxhinieri Mbikqyres, i cili duhet gjithashtu te percaktoje edhe kushtet per te cilat mund te perdoren keto mjetet.

Para fillimit te zbatimit duhet te testohet pershtatshmeria per perdonim e makinerive dhe procedurave te tilla teknologjike per ngjeshje. Para fillimit te punimeve te ngjeshjes, çdo shtrese e materialit dhe/ose e perzierjeve te stabilizuara te tij duhet te permbaje ate sasi uji e cila mundeson ngjeshjen e materialeve deri ne shkallen e kerkuar nga projekti.

Nese eshte e nevojshme, Inxhinieri Mbikqyres mund te vendose procedura plotesuese qe do te siguronin perberjen e duhur te lageshtise se materialit si dhe menyren e duhur te vendosjes se tij. Nese punimet e ngjeshjes dhe testimini i cilesise se tyre nuk do te vijojne menjehere me kryerjen e punimeve te ngjashme per shtresat ne vazhdim por veçse pas nje periudhe me te gjate kohe dhe per kushte te ndryshme klimaterike, atehere para rifillimit te punimeve duhet te verifikohet edhe njehere shkalla e ngjeshjes se shtreses. Punimet mund te rifillojnë vetem pasi eshte siguruar cilesia e kerkuar.

Nese punimet nderpriten per faj te Kontraktorit, atehere kostot per perseritjen e matjeve dhe kryerjen e çfaredo lloj permiresimi qe mund te jete i nevojshem do te mbulohen nga Kontraktori. Perndryshe, te gjitha shpenzimet duhet te mbulohen nga Punedhenesi. Ngjeshja e perzierjeve te stabilizuara duhet te perfundoje brenda periudhes kohore qe parashikohet nga procesi teknologjik.

Pas perfundimit te punimeve te shperndarjes se materialit, shtresat e materialeve koheziv te konstruksioneve prej dherash te ngjeshur duhet te kompaktohet neper te gjithe gjeresine e profilit te projektuar me anen e makinerive per rrulim me cilindra me kunja ose me goma. Pas ngjeshjes se duhur te nje shtrese, duhet te hiqet prej saj materiali i tepert (10 cm), dhe siperfaqja e nen-shtreses duhet te ngjeshet perseri me anen e makinerive per rrulim me cilindra (te lemuar). Kontraktori mund t'i

propozoje Punedhenesit ndryshimin e procedurave teknologjike. Ne kete rast, Kontraktori duhet te deshmoje me anen e rezultateve te testeve te meparshme (shpenzimet e te cilave duhet te mbulohen nga Kontraktori) se ndryshimet e propozuara prej tij jane te barazvlefshme me metoden e parashikuar ne projekt per kryerjen e ketyre punimeve.

3.8 Cilesia e Punimeve

3.8.1 Shkalla e Ngjeshjes

Shkalla e ngjeshjes te seciles shtrese qe do te perdoret per mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushje, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer, ndertimin e shtratit te rruges dhe ndertimin e shtresave prej dherash te ngjeshur duhet te demonstrohet nga Kontraktori me anen e rezultateve te testeve rutine. Shkalla e percaktuar e ngjeshjes per materialet qe kane perdorimet e mesiperme eshte dhene ne Tabelen 4.2. Vlerat e shkallev te ngjeshjes te treguara ne kete tabele paraqesin vlera mesatare. Vlera e poshtme kufitare e shkalles se ngjeshjes nuk duhet te jete me e vogel se 3% e vleres korresponduese mesatare.

Ne konstruksionet prej dherash te ngjeshur, dherat kohezive te tyre duhet te kompaktohen ne 100% te vleres, sipas dendesise se percaktuar me anen e testit standart te Proktor-it. Vlera e poshtme kufitare nuk duhet te jete me e vogel se 2% e vleres mesatare te percaktuar. Vlera e poshtme kufitare e shkalles se ngjeshjes per materialet qe perdoren per mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushje, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer, ndertimin e shtratit te rruges dhe ndertimin e shtresave prej dherash te ngjeshur, duhet te arrihet ne çdo pike matjeje. Shtresat e materialit, te cilat nuk do te kene shkallen e duhur te ngjeshjes, duhet te ngjeshen ne perputhje me kerkesat e ketyre kushteve teknike pa pretenduar ndonje pagese shtese.

3.8.2 Aftesia Mbajtese

Aftesia mbajtese e materialeve te vendosura per mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushje, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer dhe ndertimin e shtratit te rruges - nese nuk behet matja e shkalles se ngjeshjes - do te deshmohet me anen e rezultateve te testeve rutine mbi aftesine mbajtese. Sidoqofte, Kontraktori duhet te deshmoje ne çdo rast aftesine mbajtese te siperfaqes se shtratit te rruges me anen e rezultateve te testeve rutine te aftesise mbajtese.

Aftesia mbajtese, d.m.th. modulet e deformimit Ev1 and Ev2, duhet ne parim te maten ne kuoten e formimit te shtrees se tabanit, por jo me poshte se 0.5 m nga kuota e siperfaqes se siperme te trupit te rrugess.

Vlerat e poshtme kufitare te modulit te deformimit Ev2 jane dhene ne Tabelen 4.2 per vendndodhjet e kerkuara te matjeve individuale. Vlerat me te vogla te vlerave te poshtme kufitare (deri ne 5% te numrit te pergjithshem te matjeve) nuk mund te jene me poshte se 20% e ketyre vlerave kufitare. Raporti midis moduleve te deformimit Ev2 : Ev1 nuk duhet te tejkaloje vleren 2.2. Nese vlerat e matura te modulit te deformimit Ev1 arrijne mbi 50% te vleres se caktuar te Ev2, atehere raporti i specifik ndermjet tyre nuk do te jete vendimtar per percaktimin e aftesise mbajtese per shtresen e vendosur te materialit. Per shtresat e materialit shkembor qe do te perdoren per mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushje, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer dhe ndertimin e shtratit te rruges, rapporti i lejuar i moduleve te deformimit Ev2 : Ev1 eshte 3.0. Nga testet e aftesise mbajtese se nje shtrese mund te percaktohet gjithashtu nese shtresa e materialeve prej kokrrizash me dimensione me te medha se 60 mm eshte vendosur siç duhet apo jo.

Pershkrimi i punimeve	Shkalla e kerkuar e ngjeshjes sipas dendetise se materialit		Aftesia mbajtese e kerkuar Ev2 MN/m ²
	PSP %	PMP %	
Mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushjet dhe shtresat mbrojtese prej materiali te thyer me teper se 2 m nen kuoten e siperfaqes se shtratit te rruges, te perbera nga:			
- dhera;	92	—	> 45
- dhera te permiresuar;	92	—	
- materialet e stabilizuar kimikisht;	92	—	
- material shkembor.	—	92	80
Mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushjet dhe piketat jo me lart se 0.5 m nga kuota e siperme e trupit te rruges, te perbere nga:			
- dhera;	95	—	> 45
- dhera te permiresuar;	95	—	
- materialet e stabilizuar kimikisht;	95	—	
- material shkembor.	—	92	80
Mbushjet e trupit te rruges, ri-mbushjet dhe piketat ne kuoten e siperme te trupit te rruges, te perbere nga:			
- dhera;	98	—	> 45
- dhera te permiresuar;	98	—	
- materialet e stabilizuar kimikisht;	98	—	
- material shkembor.	—	92	80

Table 4 - Shkallet e ngjeshjes dhe aftesia mbajtese

PSP – Procedura Standarde e Proktor-it

PMP – Procedura e Modifikuar e Proktor-it

Me anen e matjeve kahasuese te modulit te deformimit te shtreses, te realizuar sipas menyres se pershkruar me siper, mund te behet vleresimi i aftesise se saj mbajtese.

Ne parim, aftesia mbajtese e siperfaqes se nje shtrese, te perbere prej materiali natyror te stabilizuar kimikisht dhe nga hiret, mund te verifikohet 7 dite pas ngjeshjes se perzierjes se ketyre materialeve. Zevendesimi i matjes se shkalles se ngjeshjes, qe sherben si kriter per marrjen ne dorezim te punimeve, me matjen e aftesise mbajtese te siperfaqes se shtreses se materialit te vendosur per mbushjen e trupit te rruges, ri-mbushje, ndertimin e shtresave mbrojtese prej materiali te thyer dhe ndertimin e shtratit te rruges,

duhet te miratohet paraprakisht nga Inxhinieri Mbikqyres i cili mund te percaktoje kushte plotesuese sipas te cilave do te duhet te behet vleresimi i rezultateve te matjeve te aftesise mbajtse.

3.8.3 Kontrolli i Cilesise

Para fillimit të punimeve për vendosjen e materialit duhet të sigurohet që vetitë karakteristike të materialeve, të përcaktuara me anën e testeve paraprake, përputhen me vetitë e mostrave të testuara në fillim të proçesit të punimeve.

Para fillimit të punimeve për vendosjes e materialit, Kontraktori duhet të paraqesë raporte të vlefshme mbi testimet e kryera në lidhje me cilësinë e materialeve lidhës që do të përdoren për përmirësimin dhe/ose stabilizimin kimik të materialeve natyrore. Për këtë arsy, Kontraktori mund të përdorë një lloj të veçantë binderi vetëm nëse përdorimi i tij është miratuar më parë nga Inxhinieri Mbikqyrës.

-Testet paraprake teknologjike

Në fillim të punimeve duhet të verifikohen përmes testeve paraprake teknologjike (të cilat duhet të kryhen në një vend të përshtatshëm për testim dhe në përputhje me udhëzimet e Inxhinierit Mbikqyrës të dhënat e mëposhtme:

- përshtatshmëria për përdorim e materialeve duke përdorur të paktën 2–3 mostra për testim;
- përshtatshmëria për përdorim e materialeve lidhëse duke përdorur 1–2 mostra për testim;
- sasia e materialit lidhës të shtruar duke përdorur 2–3 mostra për testim;
- cilësitë e materialit natyrore të përmirësuar duke përdorur të paktëndy mostra për testim;
- shkalla e ngjeshjes së një shtrese duke bërë të paktën 15 matje të dendësisë dhe përbajtjes së lagështisë së materialeve përmes testeve.
- aftësia mbajtëse e një shtrese të vendosur duke kryer të paktën tre matje të modulit të deformimit;
- cilësitë e përzierjes së stabilizuar, të përbërë prej materialesh natyrore të stabilizuara kimikisht (sipas sektionit 4.4.3), duke përdorur 1–2 mostra për testim;
- rrufshtësia e sipërfaqes së një shtrese (sipas sektionit 4.4.4) duke kryer 3–5 matje.

Para fillimit të punimeve duhet të përcaktohet procedura teknologjike për çdo material karakteristik, lloji i makinerive ngjeshëse dhe thellësia efektive e ngjeshjes së tyre. Për këtë arsy, thellësia efektive e ngjeshjes duhet të matet pas çdo kalimi të mjetit ngjeshës në jo më pak se katër pikë të sektionit të matur, në sipërfaqe si dhe në çdo 10 cm thellësi të këtij sektioni. Njëkohësisht, duhet të matet dendësia dhe përbajtja e lagështisë së materialit të vendosur në jo më pak se 10 pikë të sipërfaqes së shtresës

- Llojet dhe numri minimal i testeve rutinë

Në bazë të rezultateve të testeve paraprake teknologjike, Inxhinieri Mbikqyrës përcakton llojet dhe numrin e testeve rutinë që duhet të kryhen gjatë proçesit të vendosjes së materialit për mbushjet e trupit të rrugës, ri-mbushje, ndërtimin e shtresave mbrojtëse prej materiali të thyer, ndërtimin e shtratit të rrugës dhe ndërtimin e konstruksioneve prej dherash të ngjeshur.

Llojet dhe numri minimal i testeve rutinë që duhet të kryhen nga Kontraktori në lidhje me materialet dhe materialet lidhëse të përdorur për mbushjet e trupit të rrugës, ri-mbushje, ndërtimin e shtresave mbrojtëse prej materiali të thyer dhe ndërtimin e shtratit të rrugës, duhet të jetë si vijon:

Testimi i materialeve:

- analizat e granulometrisë (vetëm për materialet e gurtë) çdo 1000 m³
- përbajtja e lagështisë (vetëm për dherat) çdo 1000 m³
- përbajtja e lëndëve organike çdo 4 000 m³
- kufijtë e plasticitetit (të dherave) çdo 4 000 m³
- përbajtja optimale e lagështisë dhe dëndësia max çdo 4 000 m³
- testimi i lidhëve të sjellur në kantier çdo 500 ton

Llojet dhe numri minimal i testeve rutinë që duhet të kryhen nga Kontraktori në lidhje me materialet që do të përdoren për ndërtimin e konstruksioneve prej dherash të ngjeshur duhet të përfshijë:

- analizat granulometrike të dherave kohezivë çdo 400 m²
- testet e përshkueshmërisë nga uji çdo 400 m²

Llojet dhe numri minimal i testeve rutinë që duhet të kryhen nga Kontraktori gjatë punimeve për mbushjet e trupit të rrugës, ri-mbushje, ndërtimin e shtresave mbrojtëse prej materiali të thyer dhe ndërtimin e shtratit të rrugës duhet të jetë si vijon:

matja e përbajtjes së lagështisë dhe dendësisë në terren çdo 20 m (200 m³);

- matja e aftësisë mbajtëse (moduli i deformimit) çdo 40 m
- matja e dëndësisë së materialit guror të trashë (sipas metodës së zëvendësimit ose sipas metodës së krahasimit të uljeve) çdo 4 000 m³
- testimi i përzierjeve të stabilizuara:
- sasia e lidhësit të hedhur çdo 100 m
- përbajtja e lagështisë optimale dhe dendësia e përzierjeve çdo 200 m
- rezistenca në shtypje (dy mostra për testim) çdo 100 m
- rezistenca ndaj kushteve të motit (dy mostra për testim) çdo 200 m
- sasia e materialit të spërkatur si shtresë mbrojtëse çdo 200 m
- matja e rrafshësisë së shtresave çdo 100 m
- matja e rrafshësisë së sipërfaqes së shtratit të rrugës çdo 20 m
- matja e kuotës të sipërfaqes së shtratit të rrugës çdo 20 m

Lloji dhe numri minimal i testeve rutinë për ndërtimin e konstruksioneve prej dherash të ngjeshur duhet të jetë si më poshtë:

- testet e përcaktimit të dendësisë çdo 100 m²
- matja e rrafshësisë çdo 20 m
- matja e pjerrësisë tërthore çdo 20 m

Inxhinieri Mbikqyrës mund të ndryshojë llojet dhe numrin minimal të testeve rutinë në rast se do të paraqiten ndryshime të konsiderueshme ndërmjet rezultateve të tyre dhe rezultateve të testeve paraprake. Gjithashtu, Inxhinieri Mbikqyrës mund të pakësojë llojet dhe numrin minimal të testeve rutinë në rast se këto rezultate do të përpunohen njëra me tjetër. Cilësia e shtresës së vendosur të

materialit mund të përcaktohet edhe me anë të metodave të tjera, nëse kjo gjë miratohet më parë nga Inxhinieri Mbikqyrës. Në këtë rast, në miratimin e Inxhinierit Mbikqyrës duhet të përcaktohen edhe kriteret për vlerësimin e cilësisë së vendosjes, metodën si dhe llojet e numrin e testeve.

3.9 Matja dhe Pranimi i Punimeve

3.9.1 Matja e punimeve

Punimet e kryera duhet të maten sipas seksionit 4.1 të këtyre kushteve teknike si dhe sipas dispozitave të mëposhtme:

- volumet e materialeve të vendosura për mbushjet e trupit të rrugës, ri-mbushje, ndërtimin e shtresave mbrojtëse prej materiali të thyer, ndërtimin e shtratit të rrugës dhe ndërtimin e konstruksioneve prej dherash të njësuar duhet të llogariten në m^3 ;
- volumet e materialeve të nën-shtresës së rrugës duhet të llogariten në m^2 ;
- të gjitha volumet duhet të maten në atë mënyrë që të tregojë sasitë dhe llojet faktike të punimeve të kryera sipas specifikimeve të projektit (teknik).

Kontraktori duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur që vërteton të gjithë volumet e lidhësve, hireve dhe emulsionit (që do të përdoren për spërkatje) të sjellë në kantier për stabilizimin kimik të materialeve natyrore.

3.10 Çmimi njesi per mbushje, mbulim me zhavorr dhe ngjeshje

Çmimi njesi per mbushjen, mbulimin me zhavorr mbulon: materialin mbushes, ngarkimin, shkarkimin, transportin, ngritjen, transportin me dore, ngjeshjen ne shtresa, lagien kur eshte e nevojshme, provat, te gjitha llojet e materialeve, makinerive, fuqise punetore dhe çdo aktivitet tjeter pershkruar ketu me siper te cilat jane te domosdoshme per ekzekutimin e punimeve.

Matjet: Matjet e volumit te mbushjeve dhe mbulimeve do te bazohen ne permasat e nxjerra nga vizatimet qe lidhen me kete proces.

Çdo ndryshim i volumit te mbushjeve dhe mbulimeve, pertej limiteve te treguara ne keto vizatime nuk do te paguhen, perveçse kur percaktohet ndryshe paraprakisht me shkrim nga mbikeqyresi i punimeve.

4 BETONET

4.1 Te pergjithshme

Puna e mbuluar nga ky seksion i specifikimeve konsiston ne furnizimin e gjithe kantierit, punen, pajisjet, veglat dhe materialet, dhe kryerjen e te gjitha punimeve, ne lidhje me hedhjen, kujdesin, perfundimin e punes se betonit dhe hekurin e armimit ne perputhje rigorozë me kete kapitull te specifikimeve dhe projekt zbatimin. Ne fillim te Kontrates Sipermarresi duhet te paraqese per miratim tek Mbikeqyresi i Punimeve nje njoftim per metodat duke detaujar, ne lidhje me kerkesat e ketyre

Specifikimeve, propozimet e tij per organizimin e aktiviteteve te betonimit ne shesh (terren). Njoftimi i metodave do te perfshije çeshtjet e meposhtme:

- Njesia e prodhimit e propozuar
- Vendosja dhe shtrirja e paisjeve te prodhimit te betonit
- Metodat e propozuara per organizimin e paisjeve te prodhimit te betonit
- Procedurat e kontrollit te cilesise se betonit dhe materialeve te betonit
- Transporti dhe hedhja e betonit
- Detaje te punes se berjes se kallepeve duke perfshire kohen e heqjes se kallepeve dhe procedurat per mbeshtetjen e perkohshme te trareve dhe te soletave.

****Kerkesat per cilesine dhe specifikimet per materialet qe do te perdoren per prodhimin e betoneve do te jene ne perputhe me EN206-1****

****Kerkesat per rezistencen e betonit te ngurtesuar do te jene ne perputhje me EN 1992-1-1****

4.2 Kontrolli i cilesise

Sipermarresi do te punesoje inxhinier te kualifikuar, te specializuar dhe me eksperience, i cili do te jetë perjegjes per kontrollin e cilesise te te gjithe betonit. Materialet dhe mjeshteria e perdonur ne punimet e betonit duhet te jetë e një cilesie sa me te larte qe te jetë e mundur, prandaj vetem personel me eksperience dhe aftesi te plete ne kete kategori punimesh do te punesohet per punen qe perfshin ky seksion specifikimesh.

4.3 Puna pergatitore dhe inspektimi

Perpara se te jetë kryer ndonje proces i pergatitjes se llaçit ose betonit, zona brenda armaturave (ose siperfaqe te tjera sipas zbatimit) duhet te jetë pastruar shume mire me uje ose me ajer te komprimuar. Çfaredo qe ka te beje me kete proces duhet te pergatitet siç eshte specifikuar.

Asnje proces betonimi nuk duhet te kryhet derisa Mbikeqyresi i Punimeve te kete inspektuar dhe aprovar (nese eshte e mundur) germimin, masat e marra per mbrojtjen nga kushtet atmosferike, masat per shperndarjen e ujit per freskim dhe staxhionim, armaturat, ndalimin e ujit, fugat ndertimore dhe fiksimin e fundeve dhe masa te tjera, armimin dhe çeshtje te tjera qe duhet te fiksohen, si dhe te gjitha materialet e tjera per betonimin dhe masa te tjera ne per gjithese. Sipermarresi duhet t'i jape Mbikqyresit te Punimeve njoftime te arsyeshme per te bere te mundur qe ky inspektim te kryhet.

4.4 Materialet

4.4.1 Çimento

Çimento Portland e Zakonshme do te perdoret me BS 12 ose ASTM C-150 Tipi II-te ose Tipi V-te. Kjo do te perdoret aty ku betoni nuk eshte ne kontakt me ujera te zeza, tub gazi ose ujerat nentokesore.

Çimento Portland Sulfate e Rezistueshme do te perdoret me BS 4027. Kjo do te perdoret per strukturat e betoneve duke perfshire pusetat dhe te gjitha perkatesite e tjera ne kontakt me ujerat e zeza, tubin e gazit ose ujerat nentokesore. Çimento duhet te shperndahet ne paketa originale te shenuara te pa demtuara direkt nga fabrika dhe duhet te ruhet ne nje depo, dyshemeja e te cilit duhet te jete e ngritur te pakten 150mm nga toka. Nje sasi e mjaftueshme duhet mbajtur rezerve per te siguruar nje furnizim te vazhdueshem ne pune, ne menyre qe te sigurohet qe dergesat e ndryshme jane perdonur ne ate menyre siç jane shperndare. Çimentoja nuk duhet ruajtur ne kantier per me shume se tre muaj pa lejen e Mbikeqyresit te Punimeve. Çdo lloj tjetër çimento, perveç asaj qe eshte e parashikuar per perdonimin ne pune nuk duhet ruajtur ne depo te tilla. E gjithe çimentoja duhet mbajtur e ajrosur mire dhe çdo lloj cimento, e cila ka filluar te ngurtesohet, ose ndryshe e demtuar apo e keqesuar nuk duhet te perdoret. Fletet e analizave te fabrikave duhet te shoqerojne çdo dergese duke vertetuar qe çimentoja, e cila shperndahet ne shesh ka qene e testuar dhe i ka plotesuar kerkesat e permendura me lart. Me te mberritur, çertifikatat e provave te tilla duhen ti kalohen per t'i aprovuar. Mbikeqyresit te Punimeve. Çimentoja e perfituar nga pastrimi i thaseve te çimentos ose nga pastrimi i dyshemese nuk do te perdoret. Kur udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve, çimento e dyshimte duhet te ritestohet per humbjen e fortesise ne njegjeshje.

4.4.2 Inertet

- Te per gjithshme

Me perjashtim te asaj qe eshte modifikuar ketu, inertet (te imta dhe te trasha) per te gjitha tipet e betonit duhet te perdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose ne perputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Ato duhet te jene te forte dhe te qendrueshem dhe nuk duhet te permajne materiale te demshme qe veprojne kunder fortesise ose qendruesherise se betonit ose, ne rast te betonarmese mund te shkaterroje kete perfocim.

Materialet e perdonura si inerte duhet te perfsten nga burime te njoitura per te arriut rezultate te kenaqshme per klasa te ndryshme te betonit. Nuk do te lejohet perdonimi i inerteve nga burime, te cilat nuk jane te aprovuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

- Inertet e imta

Inertet e imta per kategorite e betonit A, B dhe C (respektivisht M100, M200, M2500) konform STASH 512-78, do te jene prej rere natyrale, gure te shoshitur, ose materiale te tjera inerte me te njejtat karakteristika apo kombinim te tyre. E gjitha kjo duhet te jete pastruar shume mire, pa masa te mpiksura, cifla te buta e te vecanta, vajra distilimi, alkale, lende organike, argjile dhe sasi te substancave te demtuese.

Permbajtja maksimale e lejueshme e lymit dhe substancave te tjera demtuese eshte 5%. Materialet e marra nga gure te papershtashem per inerte te trasha nuk duhet te perdoren si inerte te imta. Inertet e imta te marra nga guret e shoshitur duhet te jene te mprechte, kubike, te forte, te dendur dhe te durueshem

dhe duhet te grumbullohen ne nje platforme per te patur nje mbrojtje te mjaftueshme nga pluhurat dhe perzierjet e tjera.

Shkalla e shperndarjes per inertet e imeta te specifikuara si me lart, duhet te jene brenda kufijve te meposhtem, te percakuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Masa e Sites Perqindja qe kalon (peshe e thate)

10.00mm	100
5.00mm	89 ne 100
2.36mm	60 ne 100
1.18mm	30 ne 100
0.60mm (600 um)	15 ne 100
0.30mm (300 um)	5 ne 70
0.15mm (150 um)	0 ne 15

Inertet e imeta per kategorine D te betonit duhet te jene te nje cilesie te mire nga rera e brigjeve. Ajo duhet te jete pastruar nga materialet natyrale e klasifikuar nga me e holla deri tek me e trasha, pa copeza, nga argila, zgjyra, rera, plehra dhe cifla te tjera. Nuk duhet te permbaje me shume se 10% te materialit me te holle se 0.10mm (100um) te hapesires ne rrjete, jo me shume se 5% te pjeses se mbetur ne 2.36mm site; i gjithe materiali duhet te kaloje neper nje rrjete 10mm.

➤ Inertet e trasha

Inertet e trasha per kategorite e betonit A, B dhe C de te perbehen nga materiale guri te thyer apo te nxjerre, ose nje kombinim i tyre, me nje mase jo me shume se 20 mm, dhe do te jene te paster, te forte, te qendrueshem, kubik dhe te formuar mire, pa lende te buta apo te thermueshme, ose copeza te holla te stergjatura, alkale, lende organike ose masa apo substanca te tjera te demshme. Lendet demtuese ne inerte nuk duhet te kalojne me shume se 3 %. Klasifikimi per inertet e trasha te specifikuara sa me siper duhet te jete brenda kufijve te meposhtem:

Masa e sites Perqindja e kalimit (ne peshe te thate)

mm	100
mm	90 ne 100
mm	35 ne 70
mm	10 ne 40

mm

0 ne 5

Inertet e trasha per kategorine D te betonit duhet te jene tulla te thyera te produhuara prej tullave te cilesise se pare ose grumbulli i tyre, ose nga tulla te mbipjekura. Nuk do te thyhen per perdorim per inerte te imta as tullat e papjekura apo grumbulli i tyre dhe as ato qe jane bere porosi gjate procesit te pjekjes. Agregati me tulla te thyera nuk duhet te permabwe gjethje, kashte dhe, rere ose materiale te tjera te huaja dhe ose mbeturina te tjera. Inertet prej tullave te thyera duhet te jene te nje diametri 25-40 mm dhe nuk duhet te permabajne asgje qe te kaloje nepermjet sites 2.36 mm.

Raportet e inerteve te trasha dhe te imta

Raporti me i pershtatshem i volumit te inerteve te trasha ne volumin e inerteve te imta duhet te vendoset nga prova e ngjeshjes se kubikeve te betonit, por Mbikeqyresi i Punimeve mund te urdheroje qe keto raporte te ndryshojne lehtesisht sipas klasifikimit te inerteve ose sipas peshes nese do te jete e nevojshme, ne menyre qe te prodhohen klasifikimet e duhura per perzjerjet e inerteve te trasha dhe te holla.

Sipermarresi duhet te beje disa prova ne kubiket e marre si kampione dhe te shenoje inertet dhe fraksionimin e tyre, perzjerjen e betonit ne fillim te punes dhe kur ka ndonje ndryshim ne inertet e imta apo te trasha ose ne burimin e tyre te furnizimit. Keta kubike duhet te testohen ne laborator ne kushte te njejtë, perveç rasteve te ndryshimeve te vogla ne raportet perkatese te inerteve te imta dhe te trasha (lart apo poshte) nga raporti me i mire i arritur nga analizat e sites. Kubiket duhet te testohen nga 7 deri 28 dite.

Nga rezultatet e ketyre provave (testeve) Mbikeqyresi i Punimeve mund te vendose per raportet e trashesise se inerteve te imta qe duhet te perdoren per çdo perzjerje te mevoneshme gjate zhvillimit te punes ose deri sa te kete ndonje ndryshim ne inerte.

➤ Shperndarja

Ne kantier nuk do te sillen inerte per tu perdorur derisa Mbikeqyresi i Punimeve te kete aprovuar inertet per t'u perdorur dhe masat per larjen, etj.

Me tej nga Sipermarresi do te merren kampione ne çdo 75m³ nen mbikqyrjen e Mbikqyresit te Punimeve, per çdo tip inerti te shperndare ne kantier (terren) dhe te dorezuar perfaquesuesit te Mbikeqyresit te Punimeve per provat e kontolleve te zakonshme. Kostoja e te gjitha testeve do te mbulohet nga Sipermarresi.

➤ Ruajtja e materialit te betonit

Çimento dhe inertet duhet te mbrohen ne çdo kohe nga demtuesit dhe ndotjet. Sipermarresi duhet te siguroje nje kontenier apo ndertese per ruajtjen e çimentos ne shesh. Ndertesa ose kontenieri duhet te jete e thatë dhe me ventilim te pershtatshem. Nese do te perdoret me shume se nje lloj çimentoje ne punime, kontenieri apo ndertesa duhet te jete e ndare ne nendarje te pershtatshme sipas kerkesave te Mbikeqyresit te Punimeve si dhe duhet ushtruar kujdes i madh qe tipe te ndryshme çimentoje te mos jene ne kontakt me njera tjetren.

Thaset e çimentos nuk duhet te lihen direkt mbi dysheme, por mbi shtresa druri apo pjese te ngritur trotuari per te lejuar keshtu qarkullimin efektiv te ajrit rrith e qark thaseve.

Çimentoja nuk duhet te mbahet ne një magazine te perkohshme, perveç rasteve kur eshte e nevojshme per organizimin efektiv te perzjeres dhe vetem kur eshte marre aprovimi i meparshem i Mbikeqyresit te Punimeve.

Agregati duhet te ruhet ne kantier ne hambare ose platforma betoni te padepertueshme te pergatitura posaçerisht, ne menyre qe fraksione te ndryshme inertesh te mbafen te ndara per gjithe kohen ne menyre qe perzierja e tyre te ulet ne minimum.

Sipermarresit mund t'i kerkohet te kryeje ne kantier procese shtese dhe/ose larje efektive te inerteve atehere kur sipas Mbikeqyresit te Punimeve ky veprim eshte i nevojsphem per te siguruar qe te gjitha inertet plotesojne kerkesat e specifikimeve ne kohen kur materialet e betonit jane perzjere. Mbikeqyresi i Punimeve do te aprovoje metodat e perdorura per pergatitjen dhe larjen e inerteve.

➤ Uji per cimento

Uji i perdorur per beton duhet te jete i paster, i fresket dhe pa balte, papasteri organike vegetale dhe pa kripera dhe substanca te tjera qe nderhyjne ose demtojne forcen apo durueshmerine e betonit. Uji duhet te sigurohet mundesisht nga furnizime publike dhe mund te merret nga burime te tjera vetem nese aprovohet nga Mbikeqyresi i Punimeve. Nuk duhet te perdoret asnjehera uje nga germimet, kullimet siperfaqesore apo kanalet e vaditjes. Vetem uje i aprovuar nga ana cilesore duhet te perdoret per larjen e pastrimin e armaturave, kujdesin e betonit si dhe per qellime te ngjashme.

4.5 Kerkesat per perzjerjen e betonit

4.5.1 Fortesia

Klasifikimet i referohen raporteve te çimentos, inerteve te imta dhe inerteve te trasha. Kerkesat per perzjerjen e betonit duhet te konsistojne ne ndarjen propacionale dhe perzjerjen per fortisite e meposhtme kur behen testet e kubikeve;

4.5.2 Klasat e rezistences ne shtypje

Betoni i pershkruar ne Vizatime, ne Raport Strukturor dhe ne Preventiv eshte i emertuar sipas klasave te rezistences ne perputhje me EN 206-1. Per klasifikimin e betonit sipas klasave te rezistences perdoret rezistenca karakteristike ne shtypje e cilindrade me moshe 28 dite me diameter 150mm dhe lartesi 300mm ($f_{ck,cyl}$) ose kubeve me moshe 28 ditore me brinje 150mm ($f_{ck,cube}$). Per betonin me peshe normale, klasat standarde te rezistences jane paraqitur ne tabelen e meposhtme (tabela 7 e EN 206-1).

Klasa e rezistences ne shtypje	Rezistenca minimale karakteristike e cilindrit, $f_{ck,cyl}$, N/mm ²	Rezistenca minimale karakteristike e kubit, $f_{ck,cube}$, N/mm ²
C8/10	8	10
C12/15	12	15

C16/20	16	20
C20/25	20	25
C25/30	25	30
C30/37	30	37
C35/45	35	45

Table 5 - Fragment nga Tabela 7 e EN 206-1:

4.5.3 Raporti uje-çimento

Raporti uje-çimento eshte raport i peshes se çimentos ne te. Permbajtja e ujit duhet te jete efikase per te prodhuar nje perzjerje te punueshme te fortisise se specifikuar, por permbajtja totale e ujit duhet te percaktohet nga tabela e me poshtme:

Klasa e betonit	Max. i ujit te lire/raporti cimento
Klaza A&A (C12/15) (s) 1:1, 5:3	0.65
Klaza B&B (C16/20) (s) 1:2:4	0.6
Klaza C&C (C20/25) (s) 1:3:6	0.55
Klaza D&D (C25/30) (s) 1:6:12	0.5

Shenim. (s) = Çimento sulfate e rezistueshme

4.5.4 Qendrueshmeria

Raportet e perberesve duhet te jene te ndryshem per te siguruar qendrueshmerine e deshiruar te betonit kur provohet (testohet), ne pershatje me kerkesat e me poshtme ose sipas urdherave te Mbikqyresit te Punimeve.

Perdorimet e betonit	Min&Max (mm)
Seksonet normale te perfokuara	25 ne 75
te ngjeshura me vibrime, ngjeshja	
me dore e mases se betonit	
Seksione prej betonarmeje te renda	50 ne 100
Te ngjeshura me vibracion, beton i ngjeshur	
me dore ne pllaka te perfokuara normalisht,	

trare, kollona dhe mure.

Ne te gjitha rastet, raportet e aggregatit ne beton duhet te jene te tilla qe te prodhohen perzjerje te cilat do futen neper qoshe edhe cepa te formave si dhe perreth perforcimit pa lejuar ndarjen e materialeve.

4.6 Matja e materialeve

Inertet e imeta dhe te trasha do te peshohen ose te maten me kujdes ne pershtatje me kerkesat e Manaxheri te Projektit. Ato nuk do te maten ne asnjë rast me lopata apo karroca dore. Çimento do te matet me thase 50 kg dhe masa e perzjerjes do te jetë e tillë qe grumbulli i materialeve te pershtatet per një ose me shume thase.

4.7 Metodat e perzjerjes

Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa mekanike te miratuar qe me pare. Perzjeresi, hinka dhe pjesa perpunuese e tij duhet te jene te mbrojtura nga shiu dhe era.

Inertet dhe cimento duhet te perzjehen se bashku para se te shtohet uje derisa persjerja te fitoje ngjyren dhe fortessine e duhur. Duhet te largohen papastertirat dhe substancat e tjera te padashirueshme. Uji nuk duhet te shtohet nga zorra apo rezervuare ne menyre te pakujdeshshme. I gjithe betoni duhet te perzihet uniformisht ne fabrika moderne perzjerjeje per prodhimin maximal te betonit te nevojshem per plotesimin e punes brenda kohes se percaktuar pa zvogeluar kohen e nevojshme per perzjerje. Betoni duhet te perzjehet ne perzjeresa betoni per kohezgjatjen e kerkuar per shperndarjen uniforme te perberesve per te prodhuar nje mase homogjene me ngjyre dhe fortesi por jo me pak se 1-1/2 minute. Perzjeresi duhet te perdoret nga punetore te specializuar qe kane eksperience te meparshme ne drejtimin e perdonimin e perzjeresis te betonit. Me mbarimin e kohes se perzjerjes, perzjeresi dhe te gjitha mjetet e perdonura do te pastrohen mire perpara se betoni i mbetur ne to te kete kohe te forcohet. Ne asnjë menyre nuk duhet qe betoni te perzjehet me dore pa miratimin e Mbikeqyresit te Punimeve, miratim ky qe do te jepet vetem per sasi te vogla ne kushte te veçanta.

4.8 Provat e fortessise gjate punes.

Sipermarresi duhet te siguroje per qellimet e provave nje se 3 kubikesh per çdo strukturre betoni, perfshtire derdhje betoni nga 1-15 m³. Per derdhje betoni me shume se 15 m³. Sipermarresi duhet te siguroje te pakten nje set shtese 3 kubikesh per çdo 30 m³ shtese. Nese mesatarja e proves se fortessise se kampionit per çdo porcion te punes bie poshtë minimumt te lejueshem te fortessise se specifikuar, Mbikeqyresi i Punimeve do te udhezoje nje ndryshim ne raportet ose permajtjen e ujit ne beton, ose te dyja, ne menyre qe Punedhenesi te mos kete shtese kostoje. Sipermarresi duhet te percaktoje te gjitha kampionet qe kane te bejne me raportet e betonimit prej nga ku jane marre. Nese rezultatet e testeve te fortessise mbas kontrollit te specimentit tregojne se betoni i perfshuar nuk i ploteson kerkesat e specifikuara ose kur ka prova te tjera qe tregojne se cilesia e betonit eshte nen nivelin e kerkesave te specifiuara, betoni ne vendin, qe perfaqeson kampioni do te refuzohet nga Mbikqyresi i Punimeve dhe Sipermarresi do ta levize dhe ta rivendose masen e kthyer te betonit mbrapsh me shpenzimet e veta. Sipermarresi do te mbuloje shpenzimet e te gjitha provave qe do te behen ne nje laborator qeeshte aprovuar Punedhenesit.

4.9 Transportimi i betonit

Betoni duhet te levizet nga vendi i pergatitjes ne vendin e vendosjes perfundimtare sa me shpejt ne menyre qe te pengohet ndarja ose humbja e ndonje perberesi.

Kur te jete e mundshme, betoni do te derdhet nga perzjeresi direkt ne nje paisje qe do te beje transportimin ne destinacionin perfundimtar dhe betoni do te shkarkohet ne menyre aq te mbledhur sa te jete e mundur ne vendin perfundimtar per te shmangur shperndarjen ose derdhjen e tij.

Nese Sipermarresi propozon te perdore pompa per transportimin dhe vendosjen e betonit, ai duhet te paraqese detaje te plota per paisjet dhe tekniken e perdonimit qe ai propozon per te perdonur per t'u miratuar tek Mbikeqyresi i Punimeve.

Ne rastet kur betoni transportohet me rrashqitje apo me pompa, kantieri qe do te perdoret, duhet te projektohet per te siguruar rrjedhjen e vashdueshme dhe te panderprere ne rrepire apo gryke (hinke). Fundi i pjerresise ose i pompes se shperndarjes duhet te jete i mbushur me uje para dhe pas çdo periudhe pune dhe duhet te mbahet paster. Uji i perdonur per kete qellim, duhet te largohet (derdhet) nga çdo ambjent pune i perhershesh.

4.10 Hedhja dhe ngjeshja e betonit

Sipermarresi duhet te kete aprovin e Mbikeqyresit te Punimeve per masat e propozuara perpara se te filloje betonimin.

Te gjitha vendet e hedhjes dhe te ngjeshjes se betonit, duhet te mbahen ne mbikeqyrje te vazhdueshme nga pjesetaret perkates te ekipit te Sipermarresit.

Sipermarresi duhet te ndjeke nga afer ngjeshjen e betonit, si nje pune me rendesi te madhe, objekt i te cilit do te jete prodhimi i nje betoni te papershkueshem nga uji me nje densitet dhe fortesi maximale.

Pasi te jete perzjerje, betoni duhet te transportohet ne vendin e tij te punes sa me shpejt qe te jete e mundur, i ngjeshur mire ne vendin rreth perfocimit, i perzjere siç duhet me lopate me mjete te pershtatshme çeliku per kalupe duke siguruar nje siperfaqe te mire dhe beton te dendur, pa vrima, dhe i ngjeshur mire per te sjelle uje ne siperfaqe dhe per te ndaluar xhepat e ajrit. Armatura duhet te jete e hapur ne menyre te tille qe te lejoje daljen e bulezave te ajrit , dhe betoni duhet te vibrohet me çdo kusht me mekanizma vibrues per ta bere ate te dendur, aty ku eshte e nevojshme

Betoni duhet te hidhet sa eshte i fresket dhe para se te kete fituar qendrueshmerine fillestare, dhe ne çdo rast jo me vone se 30 minuta pas perzjerjes.

Metoda e transportimit te betonit nga perzjeresi ne vendin e tij te punes duhet te aprovohet nga Mbikeqyresi i Punimeve. Nuk do te lejohet asnje metode qe nxit ndarjen apo vecimin e pjeseve te trasha dhe te holla, apo qe lejojne derdhjen e betonit lirisht nga nje lartesi me e madhe se 1.5m.

Kur hedhja e betonit nderpritet, betoni nuk duhet ne asnje menyre te lejohet te formoje skaje apo ane, por duhet te ndaloitet dhe te forcohet mire ne nje ndalese te ndertuar posaçerisht dhe te formuar mire

per te krijuar nje bashkim konstruktiv efikas, qe eshte ne per gjithsi, ne qoshet e djathta drejt armatimit kryesor. Pozicioni dhe projekti i fugave te tilla, duhet te aprovojen nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Menjehere para se te hidhet betoni tjeter, siperfaqet e te gjitha fugave duhet te kontrollohen, te pastrohen me furce dhe te lahen me llaç te paster. Eshte e keshillueshme qe ashpersia e betonit te jete arritur kur ngjyra behet gri dhe te mos lihet derisa te forcohet.

Para se betoni te hidhet ne ose kundrejt nje germimi, ky germim duhet te jete i forcuar dhe pa uje te rrjedhshem apo te ndenjur, vaj dhe lende te demshme. Balta e qullet dhe materialet te tjera dhe ne rast germim guresh, copeza dhe thermija do te hiqen. Gropa duhet te jete e qullet por jo e lagur dhe duhet te ndermerren masa paraprake per te parandaluar ujerat nentokesore qe te demtojne betonin e pa hedhur ose te shkaktojne levizjen e betonit.

Aty ku eshte e nevojshme apo e kerkuar nga Mbikeqyresi i Punimeve, betoni duhet te vibrohet gjate hedhjes me vibratore te brendshem, te afte per te prodhuar vibrime jo me pak se 5000 cikle per minute. Sipermarresi duhet te tregoste kujdes per te shmangur kontaktin midis vibratoreve dhe perfocimit, dhe te evitoje vecimin e inerteve nga vibrimi i tepert. Vibratoret duhet te vendosen vertikalish ne beton 500 mm larg dhe te terhiqen gradualisht kur fluckat e ajrit nuk dalin me ne siperfaqe. N.q.s, ne vazhdim, shtypja eshte aplikuar jashtje armatures, duhet te kihet kujdes i madh qe te shmanget demtimi i betonarmese.

Kur betoni vendoset ne ndalesa horizontale ose te pjerreta te kalimit te ujit, kjo e fundit duhet te zhvendoset duke i lene vendin betonit qe duhet te ngjeshet ne nje nivel pak me te larte se fundi i ndaleses se ujit para se te leshohet uji per te siguruar ngjeshje te plote te betonit reth ndaleses se ujit.

4.11 Betonim ne kohe te nxekte

Sipermarresi duhet te tregoste kujdes gjate motit te nxekte per te parandaluar çarjen apo plasaritjen e betonit. Aty ku eshte e realizueshme. Sipermarresi duhet te marre masa qe betoni te hidhet ne mengjes ose naten vone.

Sipermarresi duhet te kete kujdes te vecante per kerkesat e specifiuara ketu per kujdesin. Kallepet duhet te mbulohen nga ekspozimi direkt ne diell si para vendosjes se betonit, ashtu edhe gjate hedhjes dhe vendosjes. Sipermarresi duhet te marre masa te pershatshme per te siguruar qe armimi dhe hedhja e mases per tu betonuar eshte mbajtur ne temperaturat me te uleta te zbatueshme.

4.12 Kujdesi per betonin

Vetem neqoftese eshte percaktuar apo urdheruar ndryshe nga Mbikeqyresi i Punimeve, te gjitha betonet do te ndiqen me kujdes si me poshte:

- Siperfaqe betoni horizontale: do te mbahet e laget vashdimisht per te pakten 7 dite pas hedhjes. Ato do te mbulohen me materiale uje mbajtes si thase kerpi, pelhure, rere e paster ose rrogos ose metoda te tjera te miratuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

- Siperfaqe vertikale: do te kujdesen fillimisht duke lene armaturat ne vend pa levizur, duke varur pelhure ose thase kerpi mbi siperfaqen e perfunduar dhe duke e mbajtur vazhdimesht te laget ose duke e mbuluar me plasmas.

4.13 Forcimi i betonit

Me perfundimin e germimit dhe aty ku tregohet ne vizatimet ose urdherohet nga Mbikqyresi i Punimeve, nje shtrese forcuese betoni e kategorise D jo me pak se 75 mm e trashe ose e thelle do te vendoset per te parandaluar shperberjen e mases dhe per te formuar nje siperfaqe te paster pune per strukturen.

4.14 Celiku i armimit

Shufrat e armimit duhet te kthehen sipas masave dhe dimensioneve te vizatimeve, dhe ne perputhje te plete me rregulloren, e rishikuar se fundi te ASTM, shenimi A-615 me titullin “Specifikimet per shufrat e hekurit per betonarme”. Ato duhet te perkulen ne perputhje me vizatimet e ASTM A-305, Celik 3 me sigma te rrjedhshmerise 250 kg/cm².

Hekuri i armimit duhet te jete pa njolla, ndryshk, mbeturina te mullijve, bojera, vajra, graso, dherave ngjitese ose ndonje material tjeter qe mund te demtoje lidhjen midis betonit dhe armimit ose qe mund te shkaktoje korrozion te armimit ose shperberje te betonit. Çimento per suva nuk duhet te lejohet. As madhesia dhe as gjatesia e shufrave nuk duhet te jene me pak se madhesia ose gjatesia e treguar ne vizatime.

Shufrat duhet te perkulen gjithmone ne te ftohte. Shufrat e perkulura jo siç duhet do te perdoren vetem nese mjetet e perdorura per drejtimin dhe riperkuljen te jene te tilla qe te mos demtoje materialin. Asnjë armim nuk do te perkulet ne pozita pune pa aprovimin e Mbikeqyresit te Punimeve, nese eshte ngulur ne betonin e forcuar. Rrezja e brendshme e perkuljeve nuk duhet te jete me e vogel se dyfishi i diametrit te shufrave per hekur te bute dhe trefishi i diametrit te shufres per hekur shume elastik.

Armimi duhet te behet me shume kujdes dhe te mbahet nga paisjet e miratuara ne pozicionin e paraqitur ne skica. Shufrat qe jane parashikuar te jene ne kontakt duhet te lidhen se bashku me siguri te larte ne te gjitha pikat e kryqezimit me tel te kalitur hekuri te bute me diameter No.16. Kordonat lidhes dhe te tjeret si keto duhet te lidhen fort me shufrat me te cilat jane parashikuar te jene ne kontakt dhe perveç kesaj duhet te lidhen ne menyre te sigurte me tel. Menjehere para betonimit, armimi duhet te kontrollohet per saktesi vendosjeje dhe pastertie dhe do te korigojhet nese eshte e nevojshme.

Spesoret duhet te jene prej llaçi me çimento dhe rere 1:2 ose materiale te tjera te miratuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Sipermarresi duhet te pershtase masa efektive per te siguruar qe perfocimi te qendroje i palevizur gjate forcimit te mases se hedhur dhe vendosjes se betonit.

Ne soletat e dhena me dy ose me shume shtresa perfocimi, shtresat paralele te hekurit duhet te mbeshteten ne pozicion me ndihmen e mbajteseve prej hekuri. Spesoret vendosen ne çdo mbajtese per te mbeshtetur shtresat e armimit nga forcimi ose armatura.

Perveç se kur tregohet ndryshe ne skica, gjatesia e nyjeve bashkuese duhet te jete jo me pak se 40 here e diametrit te shufres me diameter me te madh.

Armimet e ndertuara kur shtrohen perbri seksioneve te tjera te armimit ose kur xhuntohen, duhet te kene nje minimum xhuntimi prej 300mm per shufrat kryesore dhe 150 mm per shufrat e terthorta. Perdorimi i mbeturinave te prera nuk do te lejohet.

Perveç se kur eshte specifiuar apo treguar ndryshe ne skica, mbulimi i betonit ne perforcimin me te afert duke perjashtuar suvane ose punime te tjera dekorative dhe forcim betoni, do te jete si me poshte:

- Per pune te jashtme dhe per pune ne siperfaqe toke dhe ne struktura ujembajtese -50mm
- Per pune te brendeshme ne struktura joujembajtese:
- per trare dhe kolona-50mm ne hekurin kryesor dhe ne asnje vend me pak se 40mm ne shufren me afer murit te jashtem
- per forcimin e soletave-25mm per te gjitha shufrat ose diametri i shufres me te madhe, ciladoqofte me e madhja.

Prerja, perkulja dhe vendosja e armimit do te jete pjese e punes brenda çmimit njesi te vendosura ne Oferten e tenderit per armimin e hekurit te furnizuar dhe te vene ne pune.

Projektimi i armimit nga puna qe eshte duke u realizuar ose e realizuar tashme, nuk do te kthehet ne pozicionin e sakte vetem ne rast se eshte miratuar nga Mbikeqyresi i Punimeve dhe do te mbrohet nga deformimi ose demtime te tjera. Saldimi i shufrave te perfocuara me perjashtim te rasteve te shufrave te fabrikuara me saldim nuk do te lejohet. Shufrat e perfocuara te ekspozuara per shtesa te ardhshme, do te mbrohen nga korrozioni dhe rreziqe te tjera.

4.15 Ndertimi dhe cilesia e armatures

Armatura duhet te jete mjaft rigjide dhe e forte ne menyre qe t'i qendroje forces se betonit dhe te çdo ngarkese konstruktive dhe duhet te jete e formes se kerkuar. Njeri nga te dy materialet mund te perdoret, druri ose metali. Cilido material te jete perdorur, duhet te jete i mberthyer ne menyre gjatesore dhe terthore, i perfocuar dhe gjithashtu per te siguroje rigiditetin duhet te jete i papershkueshem nga uji ne te gjitha rastet e paparashikuara.

Armatura e mire duhet te perdoret per te prodhuar nje pune perfundimtare me cilesi te larte pavaresisht qe gjurmë e shenjave te kallepit te armimit mbi siperfaqen e betonit do te mbeten. Armatura duhet te jete nga veshje me derrase te thatë, ose armature me siperfaqe metalike te cilesise se larte duhet te perdoren. Armatura e cilesise se ulet mund te perdoret per siperfaqe qe duhet te suvatohen ose ato te groposura ne toke, dhe duhet te montohen nga derrasa ne forme pykash me qoshet e lemuara dhe te sigurta ose nga armatura çeliku te aprovuara.

Pjesa e brendshme e te gjithe armaturave (perjashto ato per punimet qe do te mbarohen me suvatim) duhet te lyhen me vaj liri, nafte bruto, ose sapun çdo here qe ato te fiksohen. Vaji duhet te aplikohet perpara se te jete vendosur perfocimi dhe nuk duhet lejuar qe lyerja te preke perfocimin. Vajosja etj, behen qe te parandaloje ngjitet e betonit tek armatura .

Armatura duhet te goditet pa tronditir, vibruar ose demtuar betonin. Armatura qe do te riperdoret duhet te riparohet dhe pastrohet perpara se te rivendoset. Siperfaqet e brendshme te gjithe armaturave duhet te pastrohen komplet perpara vendosjes se betonit.

Kur armatura eshte prej lende drusore, siperfaqja e brendshme duhet te laget pikerisht perpara se te hidhet betoni per te shmangur keshtu absorbimin e lageshtires nga betoni.

Megjithate per ndonje armature momentale ose te propozuar duhet te merret miratimi i Mbikeqyresit te Punimeve, dhe Sipermarresi duhet te mbaje pergjegjesi te plete per kapacitetin e tij dhe per perm bushjen e kesaj klauzole si dhe per ndonje konseguence te dukshme te nje pune te parakohshme ose te demshme.

Ai duhet te heqe dhe rivendose ndonje ngritje te manget ose derdhje te betonit per te cilen armatura ka defekte ne zbatim te kesaj klauzole, ne nje mase te tille siç ndoshta kerkohet nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Pasi te vendoset ne pozicion armatura duhet te mbrohet kundrejt te gjitha demtimeve dhe efekteve te motit dhe ndryshimeve te temperatures. Neqoftese kjo eshte gjetur si e pazbatueshme per vendosjen e menjehereshme te betonit, armatura duhet te inspektohet perpara se betoni te hidhet per t'u siguruar qe bashkimet jane te puthitura, qe forma eshte sipas modelit dhe qe te gjitha papastertite jane rihequr perfshire ndonje veprim te ujtit nga lageshtira e permendor me siper

Vetem lidhjet dhe shtrengimet etj. te aprovuara nga Mbikeqyresi i Punimeve duhet te perdoren. Terheqjet, konet, pajisjet larese ose te tjera mekanizma te cilat lene vrima ose depresione ne siperfaqen e betonit me diametra me te medha se 20 mm nuk do te lihen brenda formave.

4.16 Heqja e armatures

Armatura nuk duhet te levizet derisa betoni te arrije fortesine e duhur per te siguruar nje qendrueshmeri te struktura dhe per te mbajtur ngarkesen ne keputje dhe çdo ngarkese konstruktive qe mund te veproje ne te. Betoni duhet te jete mjaft i forte dhe te parandalohet demtimi i siperfaqeve nepermjet perdonjes me kujdes te veglave ne heqjen e formave.

Armatura duhet te hiqet vetem me lejen e Mbikqyresit te Punimeve dhe puna e dukshme pas marrjes te nje lejeje te tille duhet te kryhet nen supervizionin personal te nje tekniku ndertimi kompetent. Kujdes i madh duhet te ushtrohet gjate levizjes se armatureve per te shmangur tronditjet ose ne te kundert shtypjen ne beton.

Ne rastin kur Mbikeqyresi i Punimeve e konsideron qe Sipermarresi duhet te vonoje heqjen e armatures ose per shkak te kohes ose per ndonje arsyet tjeter ai mund te urdheroje Sipermarresin qe te vonoje te tilli levizje dhe Sipermarresi nuk duhet te ankohet per vonesa ne konseguence te kesaj.

Pavaresisht nga kjo, ndonje njoftim i lejuar ose aprovim i dhene nga Mbikeqyresi i Punimeve, Sipermarresi duhet te jete pergjegjes per ndonje demtim per punen dhe çdo demtim per rrjedhim shkaktuar nga levizja ose qe rezulton nga levizja e armatures.

Tabela me poshtme eshte dhene si nje guide per Sipermarresin dhe nuk ka rruge qe çliron Sipermarresin nga detyrimet ketu:

Tipi i Armatures	Betoni
Soleta dhe traret ne ane te mureve	1 Dite
dhe kollonat e pangarkuara	
Mbeshtetjet e soletave dhe trareve	7 Dite
te lena qellimisht ne vend	
Levizja e qellimshme e mbeshtetseve	14 Dite
te soletave dhe trareve	
(temperatura e ambientit duhet te jete 25 grade celsius)	

4.17 Betoni i parapergatitur

Perjashto rastin kur specifikohet ndryshe ketu njesite e betonit te parapergatitur duhet te derdhen ne tipin e aprovuar te çdo kallep me një numer individual ose shkronje per qellime identifikimi. Numri i shkronjes duhet te jete ose i stampuar ose e futur ne kallep ne menyre qe çdo njesi e betonuar ne një kallep te posaçem do te deshmoje identifikimin e kallepit. Ne vazhdim data e betonimit te produktit duhet gjithashtu te gervishtet ose lyhet me boje mbi modelin. Pozicioni i shenjes se identifikimit te kallepit dhe dates duhet te jene ne faqen e cila nuk do te ekspozohet ne punen e perfunduar dhe duhet te aprovohet nga Mbikeqyresi i Punimeve perpara se betonimi te filloje.

Betoni per njesine e parafabrikuar duhet te testohet siç specifikohet ketu dhe duhet te vendoset dhe kompaktohet nga menyrat e aprovuara nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Njesite e betonit te parafabrikuar nuk duhet te levizen ose transportohen nga vendi i betonimit derisa te kete kaluar një periudhe prej 28 ditesh nga data e betonimit. Klauzolat ketu referuar betonit, hekurit te armuar dhe armatures duhet zbatuar njesoj edhe per betonin e parapergatitur.

4.18 Mbulimi i çmimit njesi per betonet

Çmimi njesi per një meter kub beton i derdhur mbulon furnizimin e inerteve, çimentos dhe ujit dhe perzjerjen, hedhjen dhe ngjeshjen ne çdo seksion ose trashesi, kujdesin, provat dhe te gjitha aktivitetet e tjera qe përshtakuhen me siper te cilat jane domosdoshmerisht te nevojshme per ekzekutimin e punimeve.

Perveç sa me siper, formimi i bashkimeve siç tregohen ne vizatimet ose siç instruktohen nga M.P., mbushja e bashkimeve me material izolues, vedosja e armimit ku te jete e nevojshme, armaturat dhe fuqia punetore Jane perfshire ne çmimin njesi te betoneve.

Vetem kosto e transportimit te inerteve, çimentos hekurit nuk perfshihen ne çmimin njesi te betonit, por ne çmimin njesi te transportit.

Matjet: Matja e volumit te betonit te derdhur do te bazohet ne permasat e marra nga vizatimet qe lidhen me kete punim.

Çdo volum betoni pertej limiteve te treguara ne vizatime nuk do te paguhen nese M.P. nuk ka instrukuar ndryshe paraprakisht me shkrim.

Çmimet njesi per zera te ndryshem punimesh betoni jane si me poshte:

Betone Kat. A&A(s) (M100, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. B&B(s) (M200, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. C&C(s) (M250, konform STASH 5112-78)

Betone Kat. D&D(s) (M300, konform STASH 5112-78)

5 NDERTIMI I PILOTAVE

5.1 Te per gjithshme

Ne projekt eshte parashikuar ndertimi i pilotave si themel per te shpatullat e ures. Pilotat do te jene **pilota te derdhura b/a me diameter 1200 mm me gjatesi 15m.**

Ndertimi i pilotave do te behet me duke perdorur sonda per realizimin e shpimeve vertikale me diametra te ndryshem.

Kontraktori duhet te furnizoje, instaloje dhe te testoje pilotat e paraqitura ne vizatimet e projektit ose te specifikuara ne specifikimet teknike te pershkruara ne kapitujt vijues.

Kontraktori duhet te marre ne konsiderate te gjitha operacionet e nevojshme, duke perfshire prerjen e pllakave (soletave) te betontit, skelerine, armaturat, trajtimin e pajisjeve, mjetet, makinerite etj , te nevojshme per perfundimin dhe marrjen ne dorezim te punes se kryer.

Betoni qe do te perdoret per realizimin e pilotave do te jetë i trajtuar me aditive (pershpëjtues) per arritur 90% te rezistences (klases) min brenda 7 diteve nga dita e betonimit.

5.2 Piketimi i Pilotave

Kontraktorit do ti kerkohet qe te punesoje nje gjeodeti te licensuar i cili do beje piketimet dhe pozicionimin e pilotave siç percaktohet ne planin e vizatimit te masave inxhinierike te prorjet zbatimit. Kontraktori do te jetë per gjegjes per saktevine e vendndodhjes dhe pozicionimin e çdo plote. Çdo gabim ne piketim dhe çdo humbje qe shkon ne anen e investitorit do te llogariet mire nga kontraktori dhe duhet te marre pelqimin dhe miratimin e mbikeqyresit te punimeve.

Kontraktori do te zbatoje pozicionin e pilotave te piketuara nga topografi. Nese ndonje pilote do e zhvendoset ose piketohet gabim ne ndryshim nga plani i piketimit, duhet te zevendesojet dhe ripiketohet nga nje inxhinier gjeodet i licencuar me miratimin e mbikeqyresit te punimeve. Pas perfundimit te te gjitha punimeve te pilotave, kontraktori duhet te prodhojne vizatimet sipas zbatimit te faktit, duke treguar sakte pozicionimin e te gjitha piltoave te instaluara ne pozicionin e ri.

5.3 Tolerancat

Pozicionimi

Kokat e pilotave do te pozicionohen siç jepen ne vizatimet, brenda nje devijimi te lejuar maksimal prej 30mm ne cdo drejtim nga qendra e aksit te pilotes.

Vertikaliteti

Per pilotat me çpim dhe te betonuara me derdhje ne vend, devijimi maksimal i lejuar per nje pilote te perfunduar per vertikalitet ne çdo nivel eshte 1 ne 150. Kontraktori gjate zbatimit duhet te demonstroje me miratimin e Mbikeqyresit te punimeve qe vertikaliteti eshte brenda tolerances lejueshme.

Korrigjimet

Nese pilotat do te instalohet jashte ketyre tolerancave te lejuara qe ndikojne ne projektimin dhe qendrueshmerine e struktureve, kontraktori do te propozoje dhe te kryejne masa te menjehershme per korrigjimet e duhura me miratimin e mbikeqyresit te punimeve.

5.4 Personeli pergjegjes

Punimet per pilotat duhet te kryhen nga operatore dhe specialiste me kohe te plotë te stafit mbikeqyres i cili duhet te jetë me pervoje ne instalimin e llojit te propozuar te pilotave ne projekt.

Kontraktori do t'i dorezoje mbikeqyresit per miratim, deshmite dhe kualifikimet me shkrim per te treguar se personat pergjegjes qe do te te angazhuhen ne punimet me pilotat kane pervojen dhe kualifikimin e duhur per punime te tilla.

5.5 Makinerite dhe pajisjet per ndertimin e pilotave

Pajisjet dhe makinerite qe do perdoren duhet te kene te kapacitetin dhe te krijojnë mundesine per te siguruar nje pune te sigurte, te shpejte dhe me efikasitet per instalimin e pilotave per kerkesat e projektimit ne kantierin e projektit. Duhet te patur kujdes se duke qene ne zone qe ka ndodhur nje rreshqitje dhe pjerresia eshte e madhe dhe me kushte te veshtira terreni, te perdoren makineri standarde te sondimit ose makineri me permasa te reduktuara dhe te pershatshme per ndertimin me lehtesi dhe pa vibrime te medha per pilotat.

Gjate fazes se zbatimit duhet siguruar nje numer i mjaftueshme i pajisjeve dhe aksesoreve ne menyre qe te arrihen afatet e miratuara te kontrates sipas grafikut te punimeve te miratuar nga palet.

Nje shembull makinerie per kryerjen e shpimeve (jo e detyrueshme) :




Figura 1– Shembull sonde per realizimin e puseve

5.6 Sekuenca e instalimit te pilotave

Ndertimi i puseve te pilotave do te behet nje po nje jo. Per te siguruar qendrueshmerine e puseve me gene se shpimi do te jete ne prezence uji, do te behet shpimi me sonde duke perdonur bentonite. Me ngurtesimin e rreshtit te pare te pilotave, i cili per arsyte perdonimit te pershpjturesve (aditiveve) arrin 90% te rezistences ne 7 dite, do te filloje shpimi dhe betonimi i rreshtit te dyte te pilotave.

Mbikesqyresi i punimeve ka te drejten absolute qe ti njohe te drejten kontraktorit per te drejtuar punimet per instalimin e pilotave ne cdo sekunce kur mbikesqyresi i konsideron te nevojshme per perfundimin e kenaqshem te punimeve.

5.7 Qellimi i punimeve

Kontrata perfshin marrjen e masave per kryerjen e te gjithe punes, furnizimin e materialeve, mjeteteve, punitoreve etj te nevojshme per punen e me poshtme:

- a. Ndertimin e pilotave per te perballuar aftesine mbajtese te ngarkesave siç specifikohen ne projekt.
- b. Nderpreja e pilotave sipas niveleve dhe kuotave te caktuara dhe perqatitja e kokes se pilotes siç tregohet ne projekt
- c. Kryerja e testimeve standarde te ngarkesave te percaktuara.

5.8 Materialet

Armimi

Lloji i armimit qe do te perdoret, percaktimi i diametrave, klases, forcave dhe ngarkesave qe veprojne jepen ne vizatimet e projektit.

Mbushja me Beton

Perveç rasteve kur specifikohet ndryshe, mbushja me beton duhet te jete e tipit qe nuk tkurret.

Perzierje te tilla si rapporti i ujit çimentos, fortlesia minimale e çimentos dhe betonit ne 7 dhe 28 dite duhet te jene te jete e percaktuar dhe te tregohet ne vizatime. Klasa e betonit qe do perdoret do jete C 30/37.

Mbushja speciale me beton C30/37 do te testohet ne perputhje me standartin BS 1881 dhe BS 4550. Rrjedha maksimale do te jete e kufizuar deri ne 5%.

Nese perdoren perzjeres ose aditive, detajet e perzierge duhet te dorezohen mbikeqyresit te punimeve per miratim para fillimit te punimeve. Perdorimi i perzierge duhet te jete plotesisht ne perputhje me udhezimet e prodhuesit.

Nese provat kubikeve te mostrave te materialit mbushes (Grout) deshtojne ne permbushjen e kritereve te percaktuara ne specifikimet dhe vizatimet projektit, per pilotat e ndertuara, perdorimi i kesaj mbushje do te refuzohet dhe duhet zevendesuar. Kontraktori do te nndermarre persiper te gjithe punen e nevojshme shtese per korrigimin dhe kompensimin e punes nepermjet miratimit te Mbikeqyresit te punimeve.

5.9 Te dhenat e tabanit

Investigimi dhe studimi gjeologjik i tokes i kryer nga Projektuesi duhet te jete i perfshire ne dokumentacioni teknik te kontraktorit, vetem si informacion dhe udhezime te nevojshme per kontraktorin. Ai tregon natyren e perafert te shtresave, te njohura nga projektuesit gjate studimit per projektin. Gjithsesi, Kontraktori duhet te kryeje sondazhet e tij per te verifikuar te dhenat e studimit gjeologjik te projektit.

5.10 Vizita ne kantier

Per Kontraktorin eshte e rekomandueshme te vizitoje kantierin per tu njojur me kushtet faktike te terrenit perpara fillimit te punimeve ne menyre qe ne nje faze te mevonshme te zbatimit te kontrates te mos shfaqe pretendime per informacion te pamjaftueshem ne lidhje me kushtet e terrenit.

Sistemi apo sistemet e zbatuara nga kontraktori duhet te jene te njohura mire. Mjaftueshmeria e çdo sistemi dhe miratimi i tij do te jetë ne kompetencat e Mbikeqyresit te punimeve.

5.11 Rjetet inxhinierike egzistuese nentokesore dhe ruajtja e pronave fqinje

Kontraktori duhet te kujdeset per te garantuar sigurine e sherbimeve te rrjeteve egzistuese inxhinierike nentokesore dhe pronave fqinje gjate instalimit te pilotave.

Kontraktori do te jetë perjegjes per çdo ankimim dhe demshperblim te paleve te treta ne rast te demtimit te tyre ne fazen e procesit te kryerjes se punimve te pilotave.

5.12 Shpimet

Kontraktori duhet t'i paraqese mbikeqyresit te punimeve te gjitha detajet e pajisjeve te shpimit dhe proceduren e shpimit per miratim para fillimit te punimeve. Operacionet e shpimit do te kryhen ne perputhje me kerkesat perkatese si me poshte:

(a) Shpime prane pilotave te derdhura me pare ne periudhe te afert.

Per pilotat e reja nuk duhet bere shpim ne krah te pilotave te tjera te cilat jane derdhur kohet e fundit per nje periudhe jo me pak se 24 ore, ose te cilat permbajne mbushje akoma te njome , ne menyre qe te shmanget demtimi i ketyre pilotave gjate fazes se zbatimit.

(b) Stabiliteti i vrimave te shpimit

Do merret ne konsiderate fakti qe Kontraktori duhet te marre parasysh ne çmimin njesi te ofruar te pilotave per zbatim te gjitha masat e nevojshme, duke perfshire sigurimin e te gjitha materialeve te punes dhe pajisjeve qe nevojiten, ruajtjen e stabilitetit te aneve (faqeve) te pusit (vimes) se shpimit gjate fazes se instalimit te pilotave dhe perfundimit me sukses te tyre. Kontraktori duhet te paraqese metodat e tij te propozuara per miratim prane Mbikqyresit te punimve para fillimit te proceseve te shpimit.

Pavaresisht nga prania e ujerave nentokesore, anet (faqet) e te gjitha vrimave do te mbahen te paprekura, te padepertueshme, dhe nuk duhet lejuar renia e materialeve te rrjedheshme ne fund te pusit. Pajisjet e shpimit te Kontraktorit duhet te jene te pajisura me kemisha orinetuese prej çeliku ne menyre qe te ruaje anet apo faqet e puseve/vrimave gjate shpimit te tyre.

Nese faqet rezultojne te jene te pastabilizuara, duhet perorur kemisha e çelikut e perkohsheme qe do te zhytet dhe orinetohet deri ne nje shtrese te qendrueshme. Puset duhet te mbushen me lengun fluid te shpimit ne nje nivel te mjaftueshem sa per te garantuar stabilitetin e tyre.

Nese evidentohet prania e ujit nentokesor ne çdo vrime ne sasi te mjaftueshme sa te ndikoje ne procesin e shpimit apo germimin dhe heqjen e dheut nga puset, ose qe rezulton me renien e faqeve , atehere duhet perdorur kemishe çeliku ne madhesi dhe gjatesi te pershatashme ne raport me lengun stabilizues apo te alternativave te tjera te ngarkesave te mjaftueshme qe do te perdoren per te

mbeshtetur anet/faqet e pusit dhe qe do lejojne procesin e shpimit per te vazhduar normalisht dhe ne menyre te sigurte. Perzierja e fluidit te propozuar per shpim duhet ti dorezohet Mbikeqyresit per miratim paraprakisht perpara fillimit te procesit te punes.

Germimet nuk do te jete te ekspozuara ndaj kushteve atmosferike me shume se eshte e nevojshme dhe per kohen qe qendrojne te hapura duhet te mbulohen per gjithe periudhen kur nuk ka progres punimesh. Pilotat e germuara duhet te betonohet Brenda 24 oreve duke perjashtuar vetem rastet kur nuk ka dakortesi dhe nuk merret miratimi nga ana e Mbikeqyresit.

Ne rastet gjate shpimeve kur kemi humbje te shpejte te lengjeve te shpimit nga germimet e puseve dhe kur jane shkaktuar paqendrueshmerine ne faqet e tyre, germimet do te nderpriten dhe nderkohe duhet bere pa vonese mbushja e tyre ose te merren masa te tjera te pershatashme permiresuese te ndermarra nga kontraktori dhe te miratuara nga Mbikqyresi si psh instalimi i kemishave te çelikut te perkohshme para se te rifilloje shpimi ne ate pozicion ku eshte bere nderprerja e shpimit.

(c) Stabilitetit i puseve me ane te metodes se kemishave te perkohshme :

Kur kemi perdonim te nje kemishe te perkohshme qe eshte e nevojshme per te ruajtur stabilitetin e nje pusi, fundi kemishes duhet te mbahet nje thellesi minimumi prej 1 meter ose me shume nen shtresat e paqendrueshme per te parandaluar fluksin dhe presionin e dheut dhe formimin e kaviteteve (zgavrave) te terrenit perreth .

Kemisha e perkohshme do te jete e perbere prej pareteve (spesoreve) te holla prej çeliku te bute ne forme te nje kase cilindrike. Dimensionet dhe cilesia e kemishes duhet te jete e pershatashme per te perballuar pa deme apo shtremberim te gjitha fazat gjate punes, ndertimit dhe te perballoje ngarkesat e presionit te dheut te cilave do t'i nenshtrohet. Kemisha duhet te kete nje diameter te brendshem jo me pak se diametri i specifikuar i pilotes ne projekt. Ato duhet te jene pa shtremberime te medha thelbesore, duke ruajtur nje seksion terthor uniform gjate gjithe gjatesise se tyre te vazhdueshme dhe duhet te jete e pastruar nga mbetjet e mbushjeve (grout) brenda siperfaqes se saj qe mund te ndikojne dhe pengojne formimin e duhur te pilotave. Nyjet (bashkimet) e kemishes duhet te jene te papershkueshme nga uji.

Nese kemishat e perkohshme jane demtuar gjate instalimit ne menyre qe nuk nuk lejone formimin e duhur te nje pilote, kemisha duhet te terhiqet nga pusi para se te vendoset mbushja (grout), duhet te riparohet nese eshte e nevojshme, apo te ndermerren masa te tjera qe mund te miratohen nga mbikqyresi per te vazhduar ndertimin e metejshem te pilotes.

(d) Gjetja e formacionit shkembor

Gjetja e materialit shkembor do te thote, gjetja e tabanit shkembor te shendoshe .Gjetja e shkembit ndryshe nga dy zerat e paraqitura me poshte nuk do quhet si shpim ne shkemb por shpim ne formacion dheu.

- (i) Gjatesia e zgavres se shkembit
- (ii) Kulmi i zgavres

Gjetja e siperfaqeve te pjerreta ne shkemb, si pllaka gelqerore, kavitetev (zgavrave), dhe tokes nen gure, do te konsiderohen si shpime ne toke.

(e) Inspektimi i germimeve te pilotave

Kur eshte e mundur, te gjitha germimet e pilotave do te inspektohen per gjatesine e tyre te plota para mbushjes. Kontraktori duhet te siguroje te gjithe aparatin dhe pajisjet e nevojshem per inspektim. Gjate inspektimit çdo material i rrjedhshem ose i bute ne pusin e shpimit qe mund te ndikoje ne punen e shpimit te pilotes duhet te hiqet me miratimin e Mbikeqyresit te punimeve.

5.13 Perzierja dhe vendosja e mbushjes

Kontraktori duhet te paraqese per miratim detajet e metodes dhe pajisjeve qe do perdore per perzierjen e materialit mbushes te pilotave. Informacione te tjera te tilla si presioni i materialit mbushes, procedura e mbushjes, pajisjet e perdonura per mbushje do ti dergohen per miratim prane mbikqyresit.

Mbushja duhet te jete e perzier ne vend dhe do te jete pa ndares apo grumbullim mbeturinash dhe nuk duhet te rrjedhe. Mbushja duhet hedhur ne pozicionin e saj perfundimtar ne menyre te vazhdueshem sa me shpejt te jete e mundur dhe ne asnje rast me shume se gjysme ore pas perzierjes.

Pilota do te derdhet (mbushet) ne nje proces te vazhdueshem. Nese ka humbje te madhe te materialit mbushes, kontraktori mund te zgjedhe per te kryer para-mbushjen ne fazë sipas nevojes per te parandaluar humbjen e metejshme te materialit mbushes per ndertimin e pilotes. Perpara fillimit te punes duhet paraqitur per miratim prane mbikqyresit metodologjia e para-mbushjes perfshire detajet e pajisjeve, materialeve dhe procedurat qe do ndiqen. Nese pas procesit te para-mbushjes eshte e nevojshme dhe ri-shpimi i pusit, kjo kohe dhe kostet perkatese do ngarkohen per llogari te Kontraktorit.

5.14 Reniet (humbjet) e materialit mbushes

Humbjet nga rrjedhja e materialeve te dheut apo lluca e krijuar nga shpimi do te ndikojne drejtperdrjet si rrezik potencial per humbjen e materialit mbushes.

Ne varesi te seriozitetit te tij, kontraktori mund te vendose per te kryer nje test ne prani te ujtit per te vendosur dhe vleresuar nese duhet kryer apo jo metoda e para-mbushjes. Kostoja dhe koha e testit do te perballohen nga vete kontraktori. Para-mbushja dhe ri-shpimi do te kryhen, nese rezultatet e testit tregojne se rrjedhjet e tejkalojne vleren $5L / min$ ne nje presion te tepert prej 0.1 MPa , e matur per nje periudhe cikli kohor prej 10 minutash.

5.15 Standardet

Te gjitha materialet do te jene te cilesise me te larte dhe te paperdorura me pare. Ato do te respektojnë parashikimet e projektit dhe standardet e parashikuara ne te ose udhezimet nga mbikqyresi. E gjithe puna per pilotat do te zbatohet ne perputhje me vizatimet te pergaftitura nga kontraktori qe do paraqiten per miratim te mbikeqyresi i punimeve.

5.16 Testimet Standarde te ngarkesave

Nga ana e Mbikqyresit te punimve do te kryehen maksimumi dy testime stadarde te ngarkesave ne pilotat e caktuara prej tij per testim dhe testimet do jene ne perputhje me standarde BS 8004. Numri dhe vendndodhja e pilotave te testit do te jete ne zgjedhjen e Mbikeqyresit. Kontraktori duhet te paraqese nje propozim te detajuar te testeve ngarkeses te Mbikeqyresi dhe duhet te marre miratimin e tij me shkrim para kryerjes se tyre. Me perfundimin e testimeve, Kontraktori do t'i dorezoje mbikeqyresit resultatat perfshire grafiket qe tregojne ngarkesen dhe grafiket perkatese ne funksion te kohes dhe ngarkesave.

Procedura e testit do te jete siç eshte percaktuar ne Standard. Deshtimi i testimit standard te ngarkeses do te trajtohet siç eshte percaktuar ne Specifikime.

5.17 Raporti i testimeve

Raporti i testimeve duhet te kete permabajtjen e meposhtme:

- a. Percaktimi i te dhenave baze te pilotes, daten e perfundimit te saj , gjendja e motit, gjatesine e pilotes, madhesine e saj, vellimin e mbushjes se saj, koha e shpimit ne intervale jo me te medha se 4 metra dhe kohen e mbushjes se pilotes.
- b. Pershkrimin e aparateve te perdorura per testim, sistemin e ngarkimit dhe procedurat per nxjerrjen e rezultateve te matjeve.
- c. Te dhenat e terrenit
- d. Kurben (grafikun) ne raport me kohen
- e. Kurben (grafikun) ne raport me ngarkesen
- f. Shenime shpjeguese per ngjarje te pazakonta ose te dhena mbi levizjen e mundshme (devijimin) nga aksi te pilotave.
- g. Çertifikatat e kalibrimit te matesve qe vleresojne presionin.
- h. Formatin e raportit qe do te miratohet nga Mbikeqyresi i punimeve.

5.18 Pilotat e demtuara ose te zhvendosura nga aksi

Nese devijimet (zhvendosjet) nga aksi i pilotes tejkalojne tolerancen e dhene ne keto specifikime, atehere kontraktori duhet te paraqese nje propozim permiresimi apo korrigimi per miratim te Mbikeqyresi i punimeve.

Ne rast te kundert, pilota e demtuar do te zevendesohet nga pilota shtese sipas nevojes nepermjet kushteve dhe udhezimeve te percaktuara nga Mbikeqyresi pa asnje kosto per Autoritetin Kontraktues. Kostot e modifikimit te pilotave, kokes se tyre etj, nese ka, do te perballohen nga vete Kontraktori. E njejtë gje do te aplikohet gjithashtu per çdo pune per instalimin e pilotave e cila do jete e pa pranuar nga Mbikeqyresi ,ne rastet ku pilotat jane ndertuar dhe instaluar pa qene ne perputhje me specifikimet teknike.

Ne rastin kur nje pilote eshte demtuar gjate instalimit, testimit ose nga shkaqe te tjera, pilota e demtuar do te konsiderohet dhe trajtohet si nje pilote me defekte dhe duhet te zevendesohet nga pilota shtese te miratuara nga Mbikeqyresi me shpenzimet e Kontraktorit.

5.19 Korrigjimi i sforcuar i pa lejuar

Kur pilotat nuk jane pozicionuar brenda kufijve te percaktuar nuk do te lejohet asnjë metode e korrigjimit te detyrueshem (te sforcuar).

5.20 Pagesa e shpimit te pilotes

Zeri njesi per shpimin e pilotes, duhet te perfshi çmimin per ml te seksionit bosh te hapjes se pilotes ne perputhje me diamterin e percaktuar ne projekt, sipas thellisise dhe kuotes faktike te arritur gjate germimit te saj per fazen para mbushjes me beton. Kontraktori nuk do paguhet per rastet kur ben ri-shpim per shkak te gabimeve ose devijimeve gjate fazes se zbatimit te pilotave nga aksi i tyre i duhur. Kontraktori do te paguhet vetem per pilotat te cilat jane ne perputhje me specifikimet teknike, kerkesat e projektit dhe per rastet kur miratohen si te rregullta nga ana e Mbikqyresit te Punimeve.

5.21 Pagesa per ton e armimit te pilotes

Persa i perket arimit te pilotave dhe traut lidhes se tyre, pagesa do te behet per sasine per ton te hekurit te lidhur /te montuar sipas detajeve te dhena ne projekt ,te llogaritura sipas peshave specifike nominale ne raport me diametrat perkates.Kontraktorit nuk do ti paguhen sasi te vendosura me teper se ato te dhena ne projekt perveç rasteve perjashtuese te miratuara nga Mbikqyresi.

5.22 Regjistri i te dhenave per pilotat

Kontraktori ka per detyre te regjistroje/mbledhe te gjitha te dhenat qe kane te bejne me fazen e zabitimit te punimeve per montimin e pilotave.

Kontraktori duhet te paraqese per miratim prane Mbikeqyresit te punimeve dokumentacionin teknik ne dy kopje si me poshte vijon:

- a) Te dhenat e te gjitha pilotave te montuara gjate fazes se zbatimit te tyre.
- b) Pas perfundimit te mikroplitave, nje regjistrim te punes se kryer dhe vizatimet sipas faktit.

Formati i regjistrat do te miratohet nga Mbikeqyresi i punimeve.

Regjsitri i te dhenave duhet te permbaje te gjitha informacionet e kerkuara nga Mbikeqyresi i cili perfshin aplikimet si me poshte.

- numrin e references (rendor) dhe pozicionin e pilotes
- tipin dhe dimensionet
- daten e shpimit dhe natyren e shtresave ku sejciila pilote eshte montuar
- detaje te pajisjeve dhe makinerive te perdorura
- kuoten e tokes dhe kuoten e tabanit te germuar (projektit).
- penetrimin e per gjithshem (ml)
- gjatesine dhe pozicionin e zgavrave perçdo pilote
- penetrimin ne shkemb (ml)
- kohen e shpimit per intervale jo me pak se 5ml.

- detaje te te gjitha bashkimeve apo xhuntimeve ,vendodhjen ose pozicionimin e kemishave etj.
- detajet e betonimit /mbushjes se pilotave dhe kohes se betonimit te dhena mbi motin
- kuota perfundimtare e siperme e pilotes menjehere pas perfundimit. gabimet ne pozicionim ,pjerresite
- sasia e materialit mbushes dhe presioni i perdonur
- madhesia e gureve ne çdo pilote
- shpejtesia e detajuar shpimit (m / min)
- pershkrimi i materialit te shpuar

5.23 Projekti sipas faktik

Pas perfundimit te procesit te montimit te pilotave, Kontraktori duhet te paraqese projektin sipas zbatimit faktik "As Built". Ky projekt do te pergetitet nga nje projektues i licensuar. Projekti duhet te perfshijne te dhenat si ne vijim:

- a. madhesine dhe tipin e mikropliotave/pilotave
- b. eksentricitetin ne te dyja drejtimet.
- c. thellesine e penetrimit te çdo pilote ose paraqitja e kuotave te reduktuara faktike (nese ka patur gjate zbatimit) te fundit dhe kokes se pilotave

6 CELIKU PER ARMIM

6.1 Pershkrimi

Kjo pune konsiston ne pajisjen dhe vendosjen e çelikut perforcues (armues). Celiku i perdonur per te realizuar armimin e strukturave ne kete projekt eshte i tipit B500 C me specifikime sipas EN 1992-1-1.

6.2 Listat e porosise

Ne listat e porosise se çelikut perfocues, te perdoren te njejtat shenja te shufres perkatese per etiketimin siç tregohet ne planimetri. Te dorezohen listat e porosise dhe diagramet e perkuljes per miratim. Miratimi nuk lehteson kontraktuesin nga perjegjesia per saktesine e listave dhe diagrameve.

Te mos porositet materiali derisa e pranohen listat dhe diagramet. Te mos prodhohet perfocimi vertikal ne kolona, mure, skele dhe ne boshte derisa te vendosen lartesite e themelit ne terren.

6.3 Identifikimi

Te transportohet perfocimi i shufres ne pakot standarde, te etiketuara dhe te vulosura sipas Manualit *CRSI te Praktikes Standarde*.

6.4 Perkulja

Te prodhohen shufrat perfocuese sipas ACI SP 66. Te ftohet perkulja e shufrave perfocuese qe kerkojne perkuljen. Te kufizohet lartesia e per gjithshme ose te bjere toleranca e perkuljes se shufrave te kapriates se kuvertes ne + 0 mm ose - 6 mm. Te mos perkulen shufrat pjeserisht te ngulitura ne beton, perveç siç tregohet ne planimetri ose siç lejohet ndryshe.

Te sigurohen çengela standarde qe perputhen me ACI SP 66.

6.5 Mbrojtja e materialit

Te ruhet çeliku perfocues mbi toke ne platforma, karabina, ose ne mbeshtetje te tjera. Te mbrohet nga demtimet fizike, ndryshkja dhe perkeqesimi i siperfaqeve te tjera.

Te perdoret çeliku perfocuese vetem kur siperfaqja eshte e paster dhe dimensionet minimale, zona e seksionit kryq dhe vetite e terheqjes, perputhen me kerkesat fizike per madhesine dhe klasen e specifikuar te çelikut.

Te mos perdoret çeliku perfocues qe eshte plasaritur, laminuar ose eshte i mbuluar me papasterti, ndrysh, boje, graso, vaj ose materiale te tjera te demshme.

6.6 Çeliku perfocues i veshur me epoks

Te mbeshteten shufrat e veshura ne zonat e kontaktit te lidhura. Te mbushen grupet e lidhura. Te ngrihen me nje mbeshtetje te forte. Te parandalohet gerryerja shufer me shufer. Te mos leshohen ose terhiqen tufat.

Para vendosjes, te kontrollohen shufrat per demtim e veshjes. Te zevendesohen dhe te mos perdoren shufrat me nje siperfaqe totale te demtuar ne çdo gjatesi prej 12-inç (300 mm) qe tejkalon 5 % te siperfaqe se asaj gjatesie te shufres.

Te pastrohen veshjet e tjera te demtuara duke hequr ndotesit siperfaquesore dhe shtresen e demtuar. Te ashpersohet zona rreth demtimit dhe te hiqet ndryshku permes pastrimit me rryme ajri ose pastrimit me veglat me fuqi. Te perdoret nje material riparues i kualifikuar sipas AASHTO M 284 per riparimin

e defekteve ne veshje qe jane te dukshme me sy te lire. Te mbivendoset materiali riparues mbi veshjen origjinale per 50 mm ose siç rekomandohet nga prodhuesi. Te sigurohet nje trashesi minimale e nje shtrese te thateprej 200 mikrometer ne zonat e riparuara.

Te merren hapat e nevojsphem per te minimizuar demtimin e veshjes se shufrave te instaluara. Te pastrohet dhe te riparohet demtimi i veshjeve te verejtura pas instalimit siç eshte pershkruar me siper. Te trajtohen me perpikmeri shufrat sipas rekomandimeve te prodhuesit te rreshires dhe para se te ndodhe oksidimi i demshem.

Te vishen bashkimet mekanike pas montimit te bashkimit sipas AASHTO M 284 per riparimin e veshjeve me epoks te demtuara.

6.7 Vendosja dhe fiksimi

Te vendosen, fiksohen dhe te mbeshteten shufrat sipas Manualit te Praktikes Standarde te CRSI-se. Te vishen karrigjet, telat e lidhjes dhe pajisjet e tjera qe perdoren per te mbeshtetur, pozicionuar ose perforuar perfocimin e veshur me epoks me nje material joperçues.

Te perdoren blloque betoni te parapergatitur ose mbeshtetjet metalike. Te bashkangjiten mbeshtetjet e bllokut te betonit ne shufren e mbeshtur me tela te hedhur ne qender te secilit bllok. Te perdoren mbeshtetjet metalike te klases 1 (plastike e mbrojtur) ose klases 2, Lloji B (çeliku i pandryshkshem i mbrojtur) ne kontakt me siperfaqet e ekspozuara te betonit. Te perdoret çelik i pandryshkshem sipas ASTM A493, tip 430.

Te ndahen mbeshtetjet e shufrave te pllakes jo me shume se 1200 mm larg ne menyre trasversale ose gjatesore. Te mos perdoren mbeshtetjet e shufrave, drejtperedrejti ose terthorazi, per te mbeshtetur pistat per karrocat e betonit ose per ngarkesa te tjera te ndertimit. Te zevendesohen mbeshtetjet e demtuara.

Te vendosen shufrat brenda 38 milimetrate te vendit te projektit. Te mos grumbullohen variacione ndarjesh. Te mos lejohet qe mesatarja e çdo dy hapesirave njitir te kaloje hapesirene e kerkuar. Te vendosen çeliku perfocues ne pllakat e dyshemese brenda 6 milimetrate te vendit te projektit vertikal. Duke perdonur nje shablon, te kontrollohet mbulesa e paster mbi çelikun perfocues te dyshemese perpara se te vendoset betoni ne dyshem.

Te sigurohen 50 milimetra te mbuleses se paster per perfocim. Toleranca ne mbulimin minimal te betonit eshte minus 10 milimetra. Per siperfaqet e betonit te derdhura kundrejt tokes, te sigurohet nje minimum prej 75 mm te mbuleses se paster mbi perfocim.

Te mos vendoset beton ne asnje element deri sa te miratohet vendosja e çelikut perfocues.

6.8 Lidhjet

Te mos lejohen pa miratim lidhjet, perveç atyre te treguara ne projekt. Te sigurohet gjatesia e mbeshtetjes se treguar ne projekt. Te lidhen shufrat e perfocimit vetem kur tregohet ne projekt ose ne vizatimet e pranuara.

Te krijohen lidhjet e mbeshtetura duke vendosur shufrat perfocuese ne kontakt dhe te lidhen se bashku ne menyre qe tte ruhet rradhitja dhe pozicioni i shufrave.

Nese lejohet saldimi i çelikut perfocues, te perdoren saldatoret me çertifikime aktuale dhe te behen saldimet ne perputhje me Kodin Strukturor te Saldimit AWS - çeliku perfocues, D 1.4. Te mos saldohet çeliku perfocues nese perberja kimike e çelikut tejkalon perqindjet ne tabelen meposhte:

Chemical Composition	Percent
Carbon (C)	0.30
Manganese (MA)	1.50
Carbon Equivalent (C.E.)	0.55

Table 6 - Perberesit e çelikut per armim

Bashkuesit mekanike mund te perdoren ne vend te saldimit nese miratohet. Te perdoren bashkuesit me nje rezistence qe eshte te pakten 125 % e rezistences se kerkuar te krijuar te çelikut perfocues. Te mos tejkalojet shiriti total i shufres perfocuese prej 0.25 milimetra brenda mbeshtjelleses se bashkimit kur ngarkohet ne tension deri ne 207 megapaskal dhe çlirohet ne 20 megapaskal per madhesine e shufrave deri ne nr. 43, te matura plotesisht mes pikave te mases se mbeshtjelleses se bashkimit.

Nese struktura e telave te salduar transportohet ne rrotulla, te drejtohen ne tabake te sheshte perpara vendosjes. Te bashkohen tabaket e rrjetes ose perfocimi i qilimit me shufra duke e mbivendosur jo me pak se 1 gjeresi rrjete plus 50 mm. Te mberthehen mire ne fund dhe skajet.

6.9 Pranimi

Celiku perfocues dhe materiali epoks i veshjes do te vleresohej sipas nenseksioneve specifikimeve perkatese. Te sigurohet nje certifikate prodhimi me çdo dergese te çelikut perfocues. Vendosja e çelikut perfocues do te vleresohej sipas specifikimeve perkatese.

6.10 Pagesa

Sasite e pranuara do te paguhen me çmimin e kontrates per njesi matede per artikujt me pageset te listuara ne listen e ofertes. Pagesa do te jete kompensim i plete per punen e pershkruar ne kete Seksion.

7 MURET ME DHE TE ARMUAR (TERRAMESH)

7.1 Pershkrimi

Ky proces pune konsiston me ndertimin e mureve te dheut te stabilizuar mekanikisht (DHSE).

Filtrat me gjeotekstil te percaktohen sipas specifikimeve perkatese.

Gjeotekstili dhe gjeogridi i perforcimit te percaktohen sipas specifikimeve perkatese.

7.2 Materialet

Ne perputhje me Seksionet dhe Nenseksionet e meposhtme:

Betoni

Kap.4

Blloqe betoni	Kap.4 , Kap.9
Gjeotekstil	Kap8
Gjeotekstil dhe gjeogrid perfocues	Kap.8
Material mbushes granular	Kap.3
Material i paklasifikuar	Kap.3

7.3 Kriteret e Ndertimit

Te verifikohen kufijte e ndertimit te murit. Te dorezohen vizatimet e ndertimit sipas kerkesave te “vizatimet sipas faktit”, kap.1.15. Te nivelohet bazamenti ne nje gjeresi te barabarte me gjatesine e elementeve perfocues plus gjeresine shtese qe tregohet ne planimetri.

Kur te kerkohet, sipas percaktimit te Kontraktorit, te projektohen dhe ndertohen pajandrime, duke marre parasysh mirembajtjen dhe kerkesat te trafikut.

Per panele betoni dhe mure me blloqe, te sigurohet nje jastek nivelues i parapergatitur e i armuar ose i paarmuar e i derdhur ne vend.

7.4 Fillimi I Ndertimit te murit

Te fillohet ndertimi i murit sipas vizatimeve dhe rekomandimeve te prodhuesit. Te jetë ne kantier nje perfaqesues i prodhuesit te sistemeve te mureve, gjate fillimit te ngritisje se murit.

Tolerancat ne Ndertim

Lloji i Fakes Ballore	+/-Toleranca Vertikale ⁽¹⁾	+/- Toleranca Horizontale ⁽²⁾	+/- Kontrolli me Mastar ne Disa Pika Horizontalisht ⁽³⁾
Panele te parapergatitura betoni, blloqe betoni	15 mm	15 mm	15 mm
Tel i salduar, gabion	38 mm	38 mm	75 mm

Table 7 – Tolerancat ne Ndertim

- (1) Toleranca vertikale e murit ne krye, per çdo 3 meter lartesi muri. Per shembull per murin 20 meter te larte te shumezohet $6.5 \times$ vleren.
- (2) Toleranca horizontale e murit ne krye te tij per çdo 3 meter lartesi.
- (3) Shmangia maksimale horizontale e çdo pike ne mur nga nje mastar 3 metrosh, i vendosur horizontalisht ose vertikalish ne planin teorik te fases se projektuar.

(a) Faqe me tel. Te shtrohen tapetet mbeshtetes ne shtresa horizontale njekohesish me avancimin e shtresave. Te lidhen, shtrengohen dhe ankorohen elementet e perfocimit te dheut ne faqen e murit, perpara fillimit te mbushjes. Te mos vendosen elemente perfocues nen kuotat respective te bashkimit. Te terhiqet dhe ankorohet rrjeta e tendosur e perfocimit perpara se te vazhdohet me mbushjen. Te mos perdoret rrjete plastike ose material gjeosintetik per te mbajtur mbushjen ne faqe te murit.

7.5 Mbushja

Te kryhet mbushja e pjeses se stabilizuar me material granular te perzgjedhur sipas specifikimeve te mbushjes. Materiali te vendoset duke filluar nga faqa e pasme e murit e duke shkuar drejt fundit te perfocimit. Te sigurohet qe nuk ka boshlleqe nen perfocim. Te ngjishet çdo shtrese sipas kerkesave per ngjeshje te trekuar ne kap.4, por te perdoret nje kompaktor i lehte mekanik ose vibrues deri ne 900 milimeter nga faqa e murit. Faqet e dukshme te mbushjeve te konsolidohen duke i ngjeshur me shufer metalike ose me mjete te tjera per te perfuat nje faqe mbushjeje te ngjeshur. Kur kjo mase e stabilizuar do te suportoje themellet e urave ose ngarkesa te tjera strukturore, 1.5 metrat e fundit te ngjishen deri ne 100 perqind te densitetit maksimal. Te mos demtohen ose prishen elementet e fases se dukshme ose elementet perfocues. Te mos operohen makinerite direct mbi rrjeten perfocuese. Te korigohen elemntet e murit te demtuar, te dale jashte konturit apo te deformuar.

Mbrapa mases se stabilizuar te mbushet me material te mbushjes rrugore. Ne fund te çdo dite pune, materiali mbushes i shtreses se fundit t'i vendoset si prite fases se murit qe te largohen rrjedhjet e ujrave te siperfaqes mbi mur. Te mos lejohen rrjedhje te ujrave te siperfaqes te zones perreth te hyjne ne zonen e ndertimit te murit.

7.6 Pranimi

Te dorezohet çertifikata e prodhuesit me çdo ngarkese te paneleve te betonit.

Gjeotekstili filtrues dhe gjeotekstili e gjeogridi perfocues do te vleresohej sipas specifikimeve perkatese.

Germimi per strukturen, materiali i perzgjedhur mbushes dhe materiali i paklasifikuar do te vleresohej sipas specifikimeve perkatese.

7.7 Matja

Kur muret e dheut te stabilizuar mekanikisht te maten me meter kator, te matet faqa ballore, perveç themelit.

Kur mbushja me material te perzgjedhur te matet me meter kub, matja te kryhet ne perputhje me gjometrine e projektit.

Mbushja per themelin te metet sipas specifikimeve te mbushjeve te cituara mesiper.

7.8 Pagesa

Volumet e pranuara do te paguhen me çmimin e kontrates per njesi matjeje per zerat e listuara ne preventiv. Pagesa do te jete shlyerje e plete per punimet e pershkruara ne kete Seksion.

8 RRJETAT GJEOSINTETIKE (GJEGRIDET) DHE GJEOTEKSTIL

8.1 Pershkrimi

Ky proces pune konsiton ne me furnizimin dhe instalimin e gjeotekstilit ne ndarje, stabilizime dhe filtrime, gjeogridit ne stabilizime dhe gjemembranes si izolues i lageshtires.

8.2 Kriteret e Ndertimit

Te identifikohen, magazinohen dhe trajtohen gjeosintetiket sipas ASTM D4873 dhe rekomandimeve te prodhuesit. Gjeosintetiket te ngrihen dhe te mbrohen duke i mbuluar me nje mbulese kundra ujit, nese do te ruhen perjashta. Te reduktohet ekspozimi i gjeosintetikeve ne me pak se 10 dite, ndaj rrezatimit ultraviolet.

Per qepje te bera ne kantier, te jene ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit. Te merret aprovim per qepjen para instalimit. Te perdoret fill i perbere nga poliester ose polipropilen me fortesi te larte. Te mos perdoret fill nailoni. Te perdoret fill qe i reziston rrezatimit ultraviolet dhe me ngjyre qe te dalloje nga gjeotekstili.

Te dorezohet nje pershkrim i qepjes dhe nje moster e qepur e materialit, te pakten 14 dite perpara instalimit, kur bashkimet e gjeosintetikeve qepen si me poshte:

(a) Pershkrimi i montimit. Te perfshihet lloji i qepjes, tolerance e qepjes, lloji i nujes, numrin dhe llojin e fillit te qepjes, dendetine e nyjeve dhe madhesine e nyjeve.

(b) Shembuj qepjesh. Te behen disa shembuj te qepur duke perdorur te njejtat pajisje dhe procedura qe do te perdoren ne produktin final. Te dorezohen shembuj qe kane te pakten 1.8 m qepje dhe qe jane te pakten 1.5 m te gjere. Nese produkti final do te qepet drejt dhe kryq atehere edhe mostra te dorezohet e qepur ne te njejten menyre.

Te zevendesohet materiali gjeosintetik qe eshte grisur apo shpuar. Te hiqet pjesa e demtuar dhe te vendoset nje cope e te njejtit material gjeosintetik, qe te shkele 900 milimeter jashte zones se demtuar ose te qepet perreth zones se demtuar.

8.3 Aplikimi i Gjeotekstilit dhe Gjeogridit per Ndarje dhe Stabilizim

(a) Pergatitja e siperfaqes. Perpara se te vendoset gjeotekstili, gjeogridi, ose te dy, te pergatitet siperfaqa si me poshtë:

(1) Toke ekzistuese. Te prihen pemet dhe shkurret rrafsh me siperfaqen e tokes. Te mos hiqet dheu vegjetativ. Te pastrohet zona nga bimesia dhe pengesat. Te hiqen objektet e mprehta dhe guret e medhenj. Depresionet apo gropat te mbushen me material te pershtatshem per te krijuar nje siperfaqe te rrafshet.

(2) Kasoneta. Kasoneta te pergatitet sipas specifikimeve perkatese.

(b) Vendasja e gjeotekstilit ose gjeogridit. Te vendoset gjeogridi mbi gjeotekstil kur tregohen te dyja ne te njejten kuote ne vizatime. Te vendoset gjeosintetiku i rrafshet dhe pa rrudha ne shtresen e poshtme. Te shkoje sipas harqeve. Shkelja te behet ne drejtim te ndertimit. Te shkeler te pakten 600 milimeter ne fundet dhe ne anesoret e tabakeve qe bashkohen ose te qepen sipas rekomandimeve te prodhuesit. Te mos vendosen bashkime gjatesore aty ku do te shkelin gomat. Gjeosintetiku te mbahet ne vend me piketa, me kapese, ose me grumbuj materiali.

(c) Mbushja.

(1) Vendosja e shtreses se pare dhe ngjeshja. Materiali mbushes te shkarkohet mbi gjeotekstil ose gjeogrid duke filluar nga cep ii tij ose nga materiali qe eshte vendosur me pare. Te mos operohen makinerite direct mbi gjeosintetik. Materiali i shkarkuar te hapet duke mbajtur nja shtrese 300 milimeter mbi gjeosintetik. Te menjanohet ndalimi, nisja ose kthimi i menjehershems i makinerive te ndertimit. Shenjat e lena nga makinerite e ndertimit te mbushen me material shtese. Te mos gerryhet materiali per te niveluar shenjat e makinerive. Nese keto shenja jane me te thella se 75 milimeter, atehere te reduktohet madhesia e makinerise se ndertimit, te reduktohet pesha e mjetit ose te rritet trashesia e shtreses se pare, sipas udhezimit te Mbikqyresit.

Te mos perdoren makineri ngjeshjeje me gunga. Te ngjishet materiali me rrula me goma ose me rrula pa vibrim me cilinder te rrafshet.

(2) Vendosja dhe ngjeshja e shtreses pasardhese. Shtresat pasardhese te vendosen dhe ngjishes sipas kerkesave ne kapitullin e shtresave.

Mund te perdoren rrula vibrues derisa dyshemeja te mos kete probleme. Te riparohen zonat e demtuara e me pas te vazhdohet me rrul pa vibrim.

8.4 Aplikimi i Gjeotekstilit ne Filtrime

(a) Vendosja e gjeotekstilit. Per mbrojtje te skarpates apo nga valemzimet, dimension i gjate te vendoset ne lartesi te skarpates. Per mbrojtje nga erozioni, dimension ii gjate te vendoset parallel me aksin e kanalit.

Te shkelen ose qepen fundet e tabakeve qe bashkohen.

(1) Shkelja. Te shkeli tabaku i pjeses se siperme mbi ate te pjeses se poshtme. Per aplikime mbi uje shkelja te jete te pakten 300 milimeter. Per aplikime nen uje shkelja te jete te pakten 900 milimeter.

(2) Qepja. Gjeotektili te qepet sipas rekomandimeve te prodhuesit.

Kapset fundore te tabakeve ngjitur te largohen te pakten 1.5 m. Te perdoren kanale ose platforma ne krye dhe ne fund te skarpates per te mbajtur gjeotekstilin ne vend. Si zgjidhje alternative te perdoren kunja ankerimi, te pakten 450 milimeter te gjata dhe te larguara nga 900 milimeter, per te mbajtur tabaket e gjeotekstilit ne vend.

(b) Mbushja. Agregati, mbrojtja e skarpates ose riprapi te vendoset mbi gjeotekstil duke filluar nga fundi e duke ikur lart. Riprapi te vendoset mbi gjeotekstil nga një lartesi prej me pak se 300 milimeter. Guret e mbrojtjes se skarpates ose agregati mbushes te vendosen mbi gjeotekstil nga një lartesi prej me pak se 900 milimeter. Te mos lejohen gure me te rende se 45 kilogram qe te rrokullisen neper skarpate. Ne aplikimet nen uje, te vendoset gjeotekstili dhe materiali qe do ta mbuloje ne te njejten dite.

8.5 Aplikimi i Ggeomembranes

Te dorezohet një plan instalimi per ggeomembranen, te pakten 10 dite perpara instalimit te saj. Te perfshihet një vizatim i planimetrisë se panelit ku te tregohen vendndodhjet e qepjeve. Te perfshihet një detaj i qepjes dhe një pershkrim me shkrim i procedurës se qepjes.

(a) Pergatitja e siperfaqes. Te sigurohet një siperfaqe e rrafshet e rigjide per ggeomembranen, pa ndryshime te papritura, te mprehta ose thyerje ne nivelete. Te hiqen shkembinjte, guret, shkopinjte, objektet e mprehta dhe mbeturinat e çdo lloji qe dalin me shume sesa 13 milimeter mbi siperfaqen e pergatitur.

(b) Vendosja e ggeomembranes. Qepjet te orientohen paralel me linjen e skarpates. Te perdoren thase me rere ose grumbuj me material per te mbajtur ggeomembranen ne vend. Te mos futen makinerite direct mbi ggeomembrane.

(c) Mbushja. Te vendoset materiali mbushes brenda te njejit turn pune qe eshte vendosur ggeomembrana. Te shkarkohet materiali mbushes ne buze te materialit te shkarkuar me pare dhe te shtyhet ne vend. Te mos shtyhet material mbi ggeomembrane qe mund te çoje ne demtim apo rudhosje te saj.

8.6 Pranimi

Gjeosintetiket do te vleresohej sipas specifikimeve te mesiperme. Te dorezohet një certifikate prodhimi per gjeosintetiket.

Instalimi i gjeosintetikeve do te vleresohet sipas specifikimeve te mesiperme.

Bashkimet me qepje do te vleresohen sipas specifikimeve te materialit.

8.7 Matja

Kur gjeosintetiket te maten me meter katror, te maten ne planin paralel me faqen e skarpates.

Te mos matet materiali i shkeljes.

8.8 Pagesa

Volumet e pranuara do te paguhen me çmimin e kotrates per njesi matjeje per zerat e listuar ne preventiv. Pagesa do te jete shlyerje e plete per punimet e pershkruara ne kete seksion.

9 MURE ME BLLOQE BETONI DHE MURET ME GURE

9.1 Te pergjithshme:

1. Materialet dhe prodhimi i blloqeve te betonit:

Çimento, uje, rere dhe agregatet per prodhimin e betonit

Blloqet me brima jane te parapergatitura ose mund te pergatiten ne kantier. Blloqet nga nje prodhues I aprovuar duhet te shoqerohen me çertifikaten e prodhimit, e cila do t'i paraqitet Supervizorit.

Derdhja e blloqeve duhet bere ne kallepe ne permasat e kerkuara, si dhe te ngjeshet mire betoni me ane te vibratorit.

2. Perberja dhe perzierja:

Perberja e blloqeve çimento Portland e zakonshme dhe aggregatet e tjere me cilesi te aprovuar te imet dhe te ashper me maksimumin e kokrrizes 10 mm; perzierja per blloqet qe do te perdoren per mure duhet te jete 1: 2: 4, sasia e çimentos nuk duhet te jete me pak se 225 kg per nje meter kub te betonit.

3. Rezistenca e blloqeve duhet te jete:

per blloqe me boshlleqe $7 \text{ N} / \text{mm}^2$; per blloqe solide $10 \text{ N} / \text{mm}^2$; per blloqe me brima $5 \text{ N} / \text{mm}^2$.

4. Mbas derdhjes blloqet duhen mbajtur te lagura mire me uje per nje periudhe 10 ditore dhe nuk duhen perdonur para 30 diteve nga dita e prodhimit.

5. Llaçi per muret me blloqe betoni duhet te jete me perzierje 1 : 4 (1 pjese çimento e zakonshme Portland dhe 4 pjese rere e cila duhet te jete e lare. Llaçi, nese nuk perzihet me perzieres mekanik duhet te perzihet teresisht 2 here I thate dhe dy here pasi ti jete shtuar uji ne nje platforme te paster te

papershkrueshme nga uji. Llaçi i cil ka filluar ngrirjen ose ka qene perzier para me shume se 30 minutave nuk duhet te perdoret apo riperzihet.

9.2 Vendasja e blloqeve prej betoni

- a) I gjithe punimi me blloqe duhet bere ne permasat e treguara ne vizatime
- b) Muret duhen ngritur ne menyre te rregullt, pa lene asnje pjese me shume se 1 meter me ulet se pjesa tjeter, vetem nese eshte marre aprovimi per te bere një gje te tille nga Supervizori. Punimi qe eshte lene ne disnivele te ndryshme nuk do te pranohet. Ne raste te mureve me kavitete, te dy trashesite nuk duhet te jene me shume se afersisht 400 mm.
- c) Rradhet e blloqeve duhet te nivelohen siç duhet. Fugat vertikale duhet te shfaqen mire dhe kendet e dyerve, dritareve apo te qosheve te vihen ne plumbçe siç duhet.
- d) Te gjitha muret duhet te jene te lidhur (vendosur) ne perputhje me praktiken me kushtet teknike KTZ.
- e) Te gjitha blloqet e betonit duhet te zhyten ne uje, para se te perdoren ne mur dhe rreshti i siperim i blloqeve te vendosur ne mur duhet lagur, para se te rifilloje muri i ri mbi to. Faqet e mureve duhet te mbahen te paster dhe pa llaç apo pika te tij.
- f) Te gjitha blloqet duhen mbuluar mire me llaç perpara se te shtrihet rreshti pasardhes dhe te gjitha fugat duhet te jene te myllura dhe te qendrueshme ne te gjithe trashesine e murit te një rreshti.
- g) Muret qe do te suvatohen t'i kene fugat horizontale te pambushura ne një thellesi prej 15 mm.
- h) Punimi me blloqe duhet te lidhet tek kolona betonarme çdo dy rreshta me shufra te galvanizuara hekuri: 3 mm te trasha; 10 cm te futen ne kolone dhe 15cm te jene pergjate rreshtit.

9.3 Muret me Gure

Murature e ngritur deri ne lartesine 3 m, e formuar nga gur gelqeror me permasa me te medha se 20 cm me forme te pershatshme dhe llaç cimento M3, me permbajtje per m^3 : gure $1,05\ m^3$, llaç bastard $0,33\ m^3$, cimento 400, per çdo trashesi duke perfshire çdo detaj e kerkesë per dhembet e lidhjes, qoshet, hapjet ne parapetet e dritareve, skela e sherbimit ose skelerine si dhe çdo gje tjeter te nevojshme per mbarimin e muratureve dhe realizimin e saj. Ne çdo një meter lartesi muri me gur, duhet te realizohet një brez betoni me beton C12/15 me lartesi 10 - 15 cm.

10 DRENASHET

10.1 Qellimi

Ky seksion mbulon instalimet e nevojshme per te mbrojtur STRUKTURAT KRYESORE siç eshte trupi i rruges dhe strukturat qofte si instalime te reja ose si riparime te njesive ekzistuese.

Sekcioni përkruan gjithashtu klasat e materialeve dhe kryerjen si duhet te punimeve.

10.2 Tombinot Drejtkendore

Tombinot mund te jene te tipit drejtkendesh (box). Punimet qe kane te bejne me kete tip strukture jane specifikuar ne punimet e betonit dhe celikut per armim.

10.3 Tombinot Rrethore

Kjo lloj pune konsiston ne ndertimin dhe riparimin e tombinove dhe te tubave te kullimit te ujrave ne perputhje me gradat dhe dimensionet e tregura ne vizatimet ose te kerkuara nga Mbikeqyresit e Punimeve.

➤ Materiali, Tubat

Tubat duhet te jene sipas kerkesave te standardeve kombetare ose nese s'ka, ato te ASHTO M86 ose M200.

Çimentoja, rera dhe uji duhet te jene ne perputhje me kerkesat e specifikuara me siperMe perjashtim te rastit kur lejohet nga Mbikeqyresit e Punimeve, Sipermarresi nuk duhet te porosise apo te sjelle tubat per çdo lloj pune derisa nje liste korrekte e madhesive dhe gjatesise jane aprovuar nga Mbikeqyresit e Punimeve.

Mbikeqyresi i Punimeve rezervon te drejten te inspekoje dhe nalizoje tubat mbas dorezimit per punime. Defekte te demshme te zbuluara mbas pranimit te tubave dhe para instalimit te tyre do te behen shkak per refuzim.

➤ Materiali, Rera

Me qellim qe te realizohet nje shtrat solid, rera do te perdoret si mbushje granulare.

Rera e kerkuar do te kete nje kurbe granulare si:

10mm	100%
5mm	60-100%
1mm	40-90%
0.3mm	15-50%
0.075mm	2-15%

10.4 Ndertimi

➤ Germimi

Kanali duhet te germohet ne thellsine dhe graden e dhene nga Mbikeqyresit e Punimeve. Nje shtrat me mbushje granlare prej 100 mm trashesi (rere) do te shperndahet dhe ngjeshet siç kerkohet nga Mbikeqyresit e Punimeve ne jo me pak se 95% Proktor, normal.

➤ Shtresezimi

Tubi duhet te mbeshtet fort ne shtrat me kambanen siper dhe ekstremet te futura plotesisht ne kambanat ngjitur.

Hapja-kambane qe mbetet do te mbyllte me llaç per te mos rrjedhur ujrat dhe per te sigurur centrimin e tubave.

➤ Mbulimi

Mbasi tubi eshte vendosur dhe kontrollar nga Mbikeqyresit e Punimeve, rera do te merret per shtratin ne nivel jo me te ulet se rezja qe formon 30 grade me diametrin horizontal te tubit.

Mbi kete nivel materiale te zakonshme per ndertim rruge mund te perdoren ne perputhje me thellesine aktuale nen siperfaqen perfundimtare.

➤ Betonimi

Betonimi i tombinove rrethore prej betoni do te realizohet per pjesen e ulet te tubit duke perdonur forma te thjeshta. Per pjesen e siperme do te perdoren forma speciale me leshim te shpejte. Gjithashtu mund te perdoren per betonim edhe forma pneumatike. Kur perdoren tuba çeliku per te cilat kerkesat e mesiperme jane aplikuar gjithashtu, ato duhet te jene nga nje fabrike e specializuar me nje diameter uniform dhe me trashesi ne perputhje me udhezimet e Inxhinierit. Ato duhen trajtuar dhe punimi duhet te jete perfekt, pa plasaritje me forme te persosur ne ekstremite, per te siguruar nje lidhje te pakalueshme nga uji. Normalisht tubat do te instalohen ne vije te drejte dhe ne nivelin e percaktuar dhe mbi nje jastek betoni te varfer me trashesine e percaktuar nga Inxhinieri. Ato gjithashtu do te rrethohen me llaç betoni sipas perpjetimeve te kerkuara dhe konfigurimin e paraqitur ne vizatimet e projektit, pas nje ngjiteje perfekte te fugave me llaç çimento.

11 PUNIMET E KANALIZIMEVE TE UJERAVE TE BARDHA

11.1 Te Pergjithshme

Largimi u ujrave siperfaqesor (shiut) nga trupi i rruges do te realizohet nepermjet nje rrjeti tubash dhe pusetash deri ne shkarkime ne kanalet e drenazhit per gjate rruges ose ne kanale kullimi ekzistues. Tubat qe do te perdoren do te jene HDPE te brinjezuar me diametra te ndryshem sipas projektit. Pusetat do te jene puseta betoni me kapak gize te plote ose ne forme zgare. Detajet dhe permasat e tuabacioneve dhe pusetave jepen ne fletet perkatese te vizatimit

11.2 Materiali

Tubat PE-HD me mure dopio te brinjezuar nga ana e jashtme dhe te sheshte nga ana e brendshme jane sipas EN 13476-1, Tubat do te prodhohen me material PE 80/100 ($E > 1000 \text{ N/mm}^2$).

Klasa e fortësise se unazave do te jete minimum SN 8, aplikim i ngarkese te vazhdueshme per 24 ore sipas DIN EN ISO 9969. Megjithate prodhuesi i tubave do te siguroje llogaritjet strukturore qe do ti nenshtrohen aprovimit te Inxhinierit. Tubat qe do te perdoren do te jene me ngjyre te zeze nga jashtë dhe me te verdhe nga brenda.

Prodhimi i tubave do te kontrollohet nga një laboratori. Certifikata e prodhimit duhet te mbulojë testet e kerkuara nga EN 13476-1. Certifikatat e prodhimit te tubave te furnizuara do ti nenshtrohen aprovimit nga Inxhinieri. Zonat ku do te behen bashkimet duhet te jene te pastra dhe te thata. Bashkuesit do te jene sipas EN 13476. Ato do te lejojnë futjen e te pakten 2-3 unazave ne anen tjeter. Bashkuesit do te futen duke perdonur nivelues ose duke i shtyre per gjate aksit te tubit. Perdonimi i cekiceve apo pajisjeve te njejtë nuk lejojet.

11.3 Shtrimi ne kanal i tubacioneve

Ne pergjithesi, tubacionet shtrohen ne kanale, ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt (Ne profilin gjatesor dhe terthor)

Karakteristikat gjeologjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensioned e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi vete.

Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapesire pune te nevojshme (hapesira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te thellesisë h dhe gjeresise b, fundi i gropes duhet te krijoje kushtet optimale, qe linja te mbeshtetet ne te gjithe gjatesine e saj

Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te sheshohet.

Ne zonat shkembore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese granili te ngjeshur ose betoni te varfer.

Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (te ujut te rrjetit Elektrik, telefonik, te ujrate te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 0.7 m mbi kreun e tubit. Ne raste kur kjo shtrese rezulton domosdomosdoshmerisht me e vogel mund te propozohet nje veshje me beton. Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.

Kerkesat e me poshtme jane baze dhe duhen marre parasysh ne shtrimin e tubave PE ne perputhje me standartet;

- perdonimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Keto jane kerkesa baze qe tubacioni i instaluar te funksionoje ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

Duhet te tregohet kujdes gjate dorezimit, transportit dhe shtrimit te tubave dhe aksesoreve te tyre per ti mbrojtur nga thyerjet dhe demtime te tjera te tubave. Tubat do te dorezohen ne menyre te tille qe te mos kene demtime tek fundet e makinave. Tubat e demtuara qe nuk mund te riparohen sipas kenaqesise se Inxhineirit do te zevendesohen me shpenzimet e Kontraktorit. Mjetet e perdonuara per transportin e tubave duhet te jene te pajisura me pjese mbrojtese per levizjen e tubave apo demtimit te tyre apo veshjes se tyre. Tubat duhet te sigurohen shume mire ne mjet per te ndenjur stabel dhe te sigurt. Te gjitha pjeset e mjetit, kabllot, shtenguesit qe jane ne kontakt me tubat do te jene te veshur. Ngarkimi do te behet me vinc apo mjete te tjera te pertatshme duke perdonur rreshqite apo mjete te aprovuara me pare me qellim qete sigurohet ulje e bute dhe me kujdes e cdo tubi. Tubat nuk duhet te jene te gripuara. Tubat nuk duhet te hidhen mbi toke ose mbi tuba te tjere. Kur ngritja apo ulja e tubave behet me vinc apo rreshqites, cdo tub duhet te mbahet nen kontroll kur bie per ta mbrojtur nga goditjet me pajisjet apo objekte te tjera qe demtojne tubin ose veshjen e tij. Tubat nuk duhet te levizen me rrotullim apo rreshqitje mbi toke. Por te ngrihen dhe te vendosen me kujdes ne pozicionin e ri. Cdo tub i vendosur mbi toke duhet te jete i bllokuar per tu mbrojtur nga rrotullimi. Valvolat dhe hidrantet do te mbahen dhe magazinohen perpara instalimit ne nje menyre te aprovar nga Inxhinieri. Tubat do te jene te lidhur nga anet e kanalit kundrejt pilave te materialeve te germuar dhe vendit ne toke per gjate kanalit ne menyre qe te mos interferoje me progresin normal te puneve. Kontraktori do te siguroje qe tubat te mos bllokojnë apo interferojnë trafikun normal dhe aktivitetet normale si dhe te gjelje aprovimin e autoriteteve te rrugeve ne kuptimin qe tubat mund te zene pak vend shume afer per gjate rruget.

11.4 Mjetet shtruese te tubacionit dhe perdonimi i sakte i tyre

Kontraktori duhet te jete i paisur me mjetet e nevojshme per transportin, shtrimin, bashkimin dhe provat e nevojshme.

11.5 Instruksionet e montimit

Hapat qe duhet te aplikohen ne montimin e tubacioneve duhet te jene ne perputhje me instrukcionin qe jep prodhuesi.

Kujdes I vecante duhet treguar ne lidhjen e tubacioneve me konstruksionin e pusetes me ane te vendosjes se nje waterstopi ne forme lente me ekspansion te larte ne kontaktin tub beton. Ky waterstop vendoset me mes te trashesise se murit te pusetes.

11.6 Testi Hidraulik

Ky test kryhet per tubacionet pjese pjese nga puseta ne pusete dhe per vete pusetat. Testi per tubacionet realizohet duke mbyllur me tapa hyrjen dhe daljen e tubit nga puseta ne pusete, mbushet me uje duke ushtruar nje presion prej 0.5 bar. Koha e mbajtjes nen presion minimum 30 minuta, gjate se ciles presioni duhet te mbetet constant me nje ulje te vogel per shkak te fleksibilitetit te tubacionit gje qe kerkon plotesimin me nje sasi te caktuar uji.

Ne rastet kur presioni bie do te thote se tubacioni ka rrjedhje dhe duhet te zbrazet, te identifikohet dhe te riparohet defekti. Me tej prova perseritet.

Testi per pusetat behet duke mbyllur me tapa tubacionin nga jashte ted y pusetave dhe sistemi mbushet me uje. Kjo gjendje mbahet mbi 45 minuta dhe prova konsiderohet e pranuar nese niveli I ujit ne puseta nuk bie mbi 5%.

11.7 .Mbajtja, ruajtja dhe transpormimi i tubave ne kantier

Tubat do te mbahen me kujdes gjate gjithe kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdeshme sipas standardeve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrohen.

Asnjë tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat ne brendesi te tyre perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqsore te bashkimevedo te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

11.8 Germimi dhe mbushja e kanaleve

Germimi dhe mbushja e kanalit do te behen sic jane specifikuar ne seksionin (Punime Dheu) te ketyre specifikimeve teknike konform vizatimeve dhe shenimeve perkatese teknike te dhena ne fletet e vizatimeve.

Kujdes duhet treguar per mbushjet me material para dhe pas vendosjes se tubave. Dherat e parashikuar ne projekt mbi tub duhet te vendosen me shtresa jo me te madha se 30cm dhe te ngjishem me tokmak dore elektrik deri ne arritjen e vleres 95% te proctor.

11.9 Ndertimi i pusetave

Kontraktori do te ndertoje puseten ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates, ose sic udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektimin dhe pastrimin e kanaleve dhe do te jene vendosur ne pika ku ka ndryshim te drejtimeve, ndryshime te madhesise se tubave, ndryshime te pernjehereshme te pjerresise dhe ne pikat ku jane parashikuar zgarat ujembledhese te ujerave te bardha.

Muret e pusetave do te ndertohen me beton dhe beton te armuar te klases sic eshte shkruar ne fletet e vizatimeve.

Gjate gjithe gjatesise se pusetes do te ndertohet nje kanal sipas aksit te tubacionit te kanalizimit per te percjelle ujerat nga nje tubacion kanalizimi tek tjetri pa nderprerje te prurjes.

Pasi hapet gropat e pusetes, toka duhet te pergatitet ne menyre qe te siguroje themele te pershtateshme. Per kete arsyte toka poshte bazamentit te pusetes do te kompaktesohet. N.q.se toka ekzistuese nuk siguron nje bazament te pershatshem atehere do te perdoret zhavorr dhe/ose beton C6/10.

Zona perreth pusetes nuk mund te mbusht menjehere pasi puna per mbushjen duhet te behet kur suvaja te jete perfunduar. Nqs puseta eshte ndertuar ne nje rruge te pambaruar korniza e hekurit dhe kapaku mbullues nuk duhet te vendosen ne pusete, ndersa nje pllake çeliku vendoset siper pusetes derisa rruga te perfundoje.

Zgarat do te vendosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se rruges dhe te kunetes.

Kujdes I vecante duhet treguar ne lidhjen e tubacioneve me konstruksionin e pusetes me ane te vendosjes se nje waterstopi ne forme lente me ekspansion te larte ne kontaktin tub beton. Ky waterstop vendoset me mes te trashesise se murit te pusetes para betonimit te saj.

11.10 Zgarat ujembledhese

Zgara mbi pusete do te kete permasa ne plan 40 me 60cm. Materiali – Gize qe ploteson normen EN 124, hapsirat garantojne minimum 30 % te siperfaqes ne plan dhe duhet te perballojne nje ngarkese prej 250 KN. Gjersia minamale e hapesirave duhet te jete mbi 18mm dhe gjatesia nen 170mm

11.11 Derdhjet e ujerave

Vendndodhja dhe kuota e shkarkimit te ujerave do te jete siç tregohet ne vizatimet perkatese ose siç udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

11.12 Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet

Kostoja e germimit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e çmimeve njesi qe lidhen me keto punime.

Furnizim i tubacioneve te te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia punetore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktiviteteve siç pershkruhen me siper jane perfshire ne çmimin njesi per nje meter tubacion kanalizimesh.

Matja: Linja e qendres se tubave brinjezuar do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusetes pasuese per gjate aksit te tubit.

11.13 Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

Koston e germimeve, mbulimit, dhe transportit te inerteve, cimentos dhe hekurit e armimit, jane mbuluar ne çmimet qe lidhen me keto zera punimesh, prandaj, nuk perfshihen ne çmimin njesi per pusetat. Çmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e cimentos, inerteve, ujit, armimit shtratimit, aramturat, forcimi i bazamentit te pusetes, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, suvatimi i bashkueseve me llaç cimento, perzierja dhe hedhja e betonit, bankinat, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te pusetave dhe sheshimi i siperfaqes perreth, ngritja e materialeve .

12 PUNIMET PER RRJETIN E FURNIZIMIT ME UJE

12.1 Te pergjithshme

Gjate punimeve te zbatimit per ndertimin e rruges do te preket (prishet) rrjeti i furnizimit me uje te zonave te banuara per gjate gjurmese se rruges. Te gjithe tubat dhe lidhjet qe do te demtohen gjate punimeve do te ribehen duke e lene rrjetin e furnizimit me uje ne gjendjen e meparshme. Tubat dhe rakorderite qe do te perdoren do te jene tuba PE sipas standardeve europiane EN12201-1 dhe EN12201-2. Ne baze te planit te rrjetit ekzistues te ujesellesit te vene ne dispozicion nga bashkia Berat jane evidentuar te gjithe tubat qe preken nga ndertimi i rruges. Tipat e tubave qe preken jane HDPE110, HDPE 32 dhe HDPE 20.

Tubat e Polietileni PE qe do te zevendesojne tubat qe do te preken nga punimet e ndertimit te rruges do te jene jane sipas standartit EN12201-2, PE 100, per presion PN10 dhe PN16 dhe SDR 11 dhe SDR 13.6 dhe diameter 20,32 dhe 110 mm.

Tubat do te furnizohen ne komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme.

Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi jane pershkruar ne kapitujt e tjere.

Perveçse modifikuar ose shtuar si ketu, te gjitha tubat Polietilenit do te plotesojne standartet kombetare dhe nderkombetare.

Çdo tub duhet te kete te shnuar ne te ne menyre permanente te dhenat me poshte:

Daten e prodhimit.

Emrin e prodhuesit.

Shenimi duhet te jete i trupezuar ne tub ose i shkruar me boje rezistente ndaj ujit.

12.2 Shtrimi ne kanal

Ne pergjithesi, tubacionet e Polietilenit shtrohen ne kanale, ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt (ne profilin gjatesor dhe terthor).

Karakteristikat gjellogjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensionet e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi.

Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapesire pune te dystuar (hapesira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te gjatesise dhe gjeresise, fundi duhet te krijoje kushtet optimale, qe linja te mbivendoset ne te gjithe gjatesine e saj. Mbishtresezimet duhet te ndahen mundesisht ne menyre te barabarte, duke eliminuar keshtu presionin e ushtruar prej tyre.

Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te dystojet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posaçme. Edhe siperfaqet e shkriftezuara, por jo te forta duhet te ngjeshen.

Neqoftese kemi te bejme me siperfaqe shkembore ose gurore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese pa gure rere (shih Projektin). Kesaj mund ti shtrohet rere, zhavor i imet ose toke e paster dhe masa e krijuar ngjeshet.

Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacionet komunale ekzistuese (te ujit, te rrjetit Elektrik, telefonik, te ujrate te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1.0 m. Ne raste te tilla mund te propozohet nje veshje me beton.

Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jete i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.

Kerkesat e meposhtme jane baze dhe duhen marre parasysh nese duam te shtrijme tubat polieteleni ne perputhje me standartet;

- perdonimi i nje stafi te specializuar
- Pajisja e mjaftueshme me mjete, shtruese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- pranim i rregullt deri ne testin e perfundimtar
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze, tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte, per aq kohe sa eshte parashikuar.

12.3 Mjete preres

Per prerjen e tubave prej Polietileni disqe abrazive preres jane pare si me te pershatshmit.

Preres me gur zmeril dhe flete sharre mund te perdoren

12.4 Instruksionet e montimit

Hapat qe duhen bere perpara montimit:

Futni gominen brenda ne gote ne menyre te tille, qe pjesa e forte e gomines te qendroje e mbeshtetur ne menyre te qendrueshme. Shtypeni gominen mire derisa te bindeni qe eshte pershtatur plotesisht.

Vendosja e gomines mund te lethesohet nepermjet shtypjes se saj ne dy pika dhe duke e shtypur me pas ne te dy anet. Kufiri i brendshem mbrojtës nuk duhet te dale nga pjesa mbrojtëse e gores.

Kujdes ne transportimin dhe levizjen e tubave, sepse mund te shkaktohen plasaritje te padukshme.

Tubat prodhohen ne gjatesi 6.0 m (mund te behen edhe porosi te veçanta). Mund te priten kudo, midis bordurave, me sharra te zakonshme druri (dore ose mekanike, por jo me sharre zinxhir). Buza e prerjes pastrohet me lime druri ose vegla te tjera ferruese.

Shtrimi fillon nga pika me e ulet. Kupa eshte mire te vihet ne drejtimin ngjites (Siper). Buza e tubit dhe kupes duhen pastruar me kujdes. Mbasi kesaj guarnicioni special gome vendoset ne thellimin e dyte midis bordurave (numeruar nga buza e gypit). Duhet kontrolluar qe guarnicioni te kete zene vend mire ne thellimin dhe te mos jete perdredhur.

Mbasi kesaj siperfaqja e brendeshme e kupes lyhet me sapun, ose me lendet e tjera te zakonshme, mandej tubi shtyhet brenda kupes me veglat e zakonshme, derisa te takoje. Nuk duhet terhequr mbrapsht fundi i tubit.

12.4.1 Testi Paraprak

Ky test kryhet para testit kryesor. Qellimi i testit paraprak, eshte te ndaloje ndonje ndryshim ne volumin brenda linjes, qe mund te shkaktohet nga presioni i brendshem, koha dhe temperatura, keshtu qe keto lexime qe do te merren menjehere ne testin kryesor pasues do te jape prova te qarta mbi saktesine e testit te seksionit.

Mbasi uljes se presionit dhe aty ku eshte e nevojshme zbranja e tubacionit, eliminoni rrjedhjet ne lidhjet dhe korrigjoni ndryshimet ne pozicione.

Presioni i proves deri ne 10 Atm: 1.5 x 10

Presioni i proves mbi 10 Atm: 10 + 5 bar

Kohezgjatja e proves se presionit: te pakten 12 ore

Testi (prova) kryesore

Kjo prove ndjek menjehere proven paraprake.

Presioni proves deri: 1.5 x 10

Presioni i proves mbi 10 Atm: 10 + 5 bar

Kohezgjatja e proves: per DN deri 150, 3 ore
nga DN 200, 6 ore

12.5 Mbajtja dhe transportimi i tubave ne zone

Tubat e polietilenit do te mbahen me kujdes gjate gjithe kohes se prodhimit, transportimit ne vendin e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdeshme sipas standarteve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnje tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demtimi i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikeqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jete shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat me brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne pergjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqesore te bashkimeve do te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi. Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

12.6 Germimi dhe mbushja

Germimi dhe mbushja e instalimeve te ujesjellesit do te jene siç jane specifikuar ne Kapitullin 2 (Germimet) dhe Kapitullin 3 (Mbushjet dhe Mbulimet) te ketyre specifikimeve teknike.

12.7 Ndertimi i pusetave

Sipermarresi do te ndertoje pusetat ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates, ose siç udhezohet nga Mbikeqyresi i Punimeve.

Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektimin dhe pastrimin e kanaleve dhe do te jene vodosur ne pika ku ka ndryshim te drejtimeve, ndryshime te madhesise se tubave, ndryshime te pernjehereshme te pjerresise.

Muret e pusetave do te ndertohen me beton te markes M 200, siç tregohet ne vizatimet.

Pasi hapet gropë e pusetes, toka duhet te pergatitet ne menyre qe te siguroje themel te pershtateshme. Per kete arsye toka poshe bazamentit te pusetes do te kompaktesohet. N.q.s toka ekzistuese nuk siguron nje bazament te pershtatshem atehere do te perdoret zhavorr dhe/ose beton M – 100.

N.q.s puesta eshte ndertuar ne nje rruge te pambaruar korniza e hekurit dhe kapaku mbulues nuk vodosen ne pusete, ndersa nje pllake çeliku vodoset siper pusetes derisa rruga te asfaltohet.

Kapaket e pusetave ne rruge do te jene prej gize. Kapaket dhe kornizat do te parashikohen sipas hapesires drite te pusetes siç eshte treguar ne vizatime.

Kapaket do te vodosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se rruges, ne rruget me asfalt, 20 mm me lart ne rruget e shtruara me makadam dhe 50 mm me lart ne rruget e pashtruara. Ne siperfaqet e hapura dhe fushat kapaku do te jete 500 mm mbi zonen rethuese, ose siç percaktohet nga vizatimet ose udhezimet e Mbikeqyresit te Punimeve.

12.8 Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per ujesjellesin

Kosto e germimit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e çmimeve njesi qe lidhen me keto punime.

Furnizimi i tubacioneve te te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia punetore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaqes, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktivitetave siç pershkrohen me siper Jane perfshire ne çmimin njesi per nje meter tubacion.

Matja: Linja e qendres se tubave PE do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusese pasuese per gjate aksit te tubit.

12.9 Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

Koston e germimeve, mbulimit, dhe transportit te inerteve, çimentos dhe hekurit e armimit, jane mbuluar ne çmimet qe lidhen me keto zera punimesh, prandaj, nuk perfshihen ne çmimin njesi per pusetat.

Çmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e çimentos, inerteve, ujit, armimit te shtratit, aramaturat, forcimi i bazamentit te puseteve, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, perzierja dhe hedha e betonit, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te puseteve dhe sheshimi i siperfaqes perreth, ngritja e materialeve duke perfshire, por jo kufizuar furnizimin e te gjitha materialeve, paisjeve, veglave dhe fuqise punetore, si dhe, ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e mbulesave te puseteve.

Matja: Matjet do te bazohen ne numrin e puseteve te ndertuara. Thellesia eshte distanca vertikale ndermjet nivelit te tokes dhe kuotes se projektit.

12.10 Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

12.10.1 Prodhimi

Polietilenet jane prodhuar nga procese te ndryshme dhe jane miksuar (bashkuar) me antloksidante, pigmenta dhe stabilizatore LW per te bere te mundur qe materiali te jetë i qendrueshem per perdonim ne industrine e ujit. Krahas faktoreve te tjere, nivelet dhe sasite e molekulave te perdonura mund te rezultojne ne qendrueshmerine e disa cilesive baze, si p.sh, koefiqenti i ferkimit, densiteti, rezistenca e ferkimit etj,

Perberja e rezultuar, normalisht shperndahet ne prodhim: ne formen e granuliteve dhe tubat PE prodhohen nga një proces shkrides (ekstuziv).

Gjate procesit te prodhimit tubi duhet te markohet (kodohet) me produktin perkates dhe procesin informativ perafersisht ne intervale 1 m per çdo gjatesi te tubit.

Marketimet duhet te shkruhen mbi tub sipas ngjyrave te me poshtme:

PE 80 SDR 1.1 BLU E ERRET

 SDR 17.6 E KUQE

PE 100 SDR 11 I ZI

 SDR 17.6 I KUQ

 SDR 26 I VERDHE

 SDR 33 PORTOKALLI

12.10.2 Kontrolli I Cilesise Se Prodhimit

Prodhimi i tubave PE eshte nje proces i vazhdueshem, nevojat e te cilit kushtezojne dhe perfeksionojne kontrollin, si te materialeve, ashtu edhe te fabrikimit te tyre per te arritur cilesine e kerkuar. Nje shkalle e kontrollit cilesor e testeve te pershkruara sipas standarteve perkatese, duhet te zbatohet brenda qellimit te nje sistemi te sigurimit cilesor ne perputhje me standartet e kerkuara.

12.10.3 Normalisht, Keto Procedura Kontrolli Perfshijne:

Testimin e cilesive te materialeve per prodhim, si p.sh perberja baze,

Kontrollin mbi uniformitetin dhe qendrueshmerine e granuliteve,

Kontrollin e parametrave te prodhimit ne lidhje me Temperaturen, presionin, shkallen e qarkullimit, shpejtjesine e terheqjes dhe kapacitetin e energjisë.

Inspektimi vizual i tubave, per te kontrolluar pamjen e pergjithshme, perputhjen dimesionale dhe ndonje tregues shtese ose gabime te bera gjate prodhimit te tubave dhe lidhjet e tyre tek fundet.

Testime afatshkurtra te prodhimit, per te identifikuar ndonje devijim gjate procesit te fabrikimit gjate prodhimit.

Testimet esenciale afatshkurtra te kontolleve cilesore perfshijne si me poshte:

- Kushtet e pamjes dhe te siperfaqes
- Dimensionet
- Stabilitetin termik
- Gjatesine ne thyerje
- Presionin hidrostatik deri ne 80° C
- Testin e shkurter te trysnise.
- Efektin ne cilesine e ujit
- Rezistencen ndaj motit
- Testim afatgjate te presionit hidrostatik
- Rezistence ndaj çarjeve te kryera nga ushtrimi i forcave
- Fuqia e tensionit, te tubit dhe lidhjeve ne skaje.

12.10.4 Saldimet E Tubave Te Polietilenit

Keto specifikime jepen per te studiuar lidhjet e mundeshme qe perdoren ne tubacionet PE qe perfshijne bashkimin me shkrirje, elektrofuzionin dhe bashkimet mekanike.

12.10.5 Llojet E Bashkimeve

Avantazhet e sistemeve per te integruar dhe rezistente ndaj ngarkesave zakonisht arrihen duke bere bashkime ekonomike duke perdorur teknikat e bashkimit me fuzion. Bashkimin e buzeve aplikohet zakonisht megjithese elektrofuzioni mund te preferohet aty ku bashkimi me shkrirje eshte jopraktik per shkak te mungesës se hapesires.

Procedura e sakte per te bashkuar materiale jo te njejtë per mure me trashesi te njejtë. Vetem materiale te ngjashme dhe me trashesi muri te perafert duhet te bashkohen ne shkrirje. Duhet te shikohen udhezimet para se te provohet bashkimi i materialeve me shkalle te ndryshme trysnie ose me diameter te ndryshem.

12.10.6 Trajnim Per Bashkimin Me Fuzion

Megjithese parimet e bashkimit me fuzion jane relativisht te thjeshta duhet treguar kujdes ne praktike per te ruajtur integritetin e sistemit PE me ane te udhezimeve te duhura dhe duke monitoruar rrjetin.

Rekomandohet fuqishem qe te behet trajnim ne nivelin e punetoreve dhe te supervizoreve te punimeve duke perdorur ose kurset e ofruara nga investitori ose duke bere trajnime nga kompania te ndjekur nga disa praktika ne rrjet nen vezhgimin e specialitetit.

Trajnimi i saldimit me shkrirje dhe eletrofuzion ka tre elemente kryesore:

- Lidhjen e sistemeve te tubacioneve MDPE me metoden e fuzionit
- Bashkimin e sistemeve te tubacioneve MDPE me lidhje fuzioni
- Mbajtjen e nje mjedisi te sigurte pune dhe e higjenes ne sistemet e ujit

12.10.7 Pajisjet Dhe Makinerite E Fuzionit

Pajisjet dhe makinerite e fuzionit mund te blihen ose te merren nga disa agjensi. Zakonisht bihet dakord me pronaret per kontrata periodike te mirembajtjes dhe sherbimet plus qe mund te ofroje kompania duhet te merren parasysh para blerjes. Te gjithe prodhuesit me reputacion ofrojnë literature te kuptueshme dhe te mjaftueshme mbi produktet dhe perdorimin e tyre te cilat duhet te studiohen para se pajisja te vihet ne perdorim.

Disa pika kyce qe duhet te fiksohen per perdorimin dhe mirembajtjen e ketyre pajisjeve pershkruhen si me poshte vijon:

Siperfaqet e nxehta qe do te saldohen duhet te jene te pastra qe te sigurojne nje pershkushmeri te mire te nxehtesise dhe per ti paraprire ndotjes se siperfaqes se saldimit. Çdo papasterti ne siperfaqe duhet te hiqet me kujdes kur pjata eshte e ftohte duke perdorur nje shpatull druri te bute ose/dhe nje pllake etermi i zhytur me pare ne nje solvent te pershtatshme si izo-propanol, teknikat e mbrojtjes dhe rinnovimit jane te gatshme nga furnizuesit. Eshte esenciale kontrolli i pavarrur i nxehtesise ne siperfaqe.

Pajisje lemuase kerkohen per te pergartitur siperfaqet e bashkimit te tubave para nxehjes se tyre dhe keto jane nje pjesë perberese te makinave te bashkimit me shkrirje. Skajet e prera duhet te mbahen te pastra dhe ne gjendje te mprechte.

Shumica e pajisjeve te fuzionit perbehen nga alumini per shkak te karakteristikave te tija te mira te sjelljes ndaj nxehtesise. Sidoqoftë alumini eshte nje material relativisht i bute dhe peson lehte

demtime nga impaktet. Pjatat e nxeha duhet te vendosen ne cilindra te paster kur nuk perdoren. Zhvillimet me te fundit te makinave automatike per bashkim me shkrirje dhe pjata te nxeha qe mund te terhiqen lehte, mund te ulin rrezikun e ndotjes se siperfaqeve te pjatave te nxehta. Makinat e fuzionit duhet te jene te afta per te zbatuar nje presion fuzioni te kontrollueshem ne siperfaqen e bashkimit por njekohesisht te jene te afta per te ushtruar forca te medha terheqese per t'u perballur me instalimin e vargjeve te gjata te tubacioneve. Cilindrat shtytes me perpikmeri te larte dhe kontrollues te energjise bejne te mundur nje pune te paster dhe ndihmese per parandalimin e shtrimit te keq. Nje rul transmetues frekuent mbi vargun e tubave ul forcat per terheqje dhe paraprin zjarrit dhe gervishtje te panevojshme te tubave. Kjo eshte veçanerisht e rendesishme kur perdoren metodat e shkrirjes me trysni te dyfishte.

12.10.8 Bashkimi Me Fuzion

Procedurat e rekomanduara per bashkinin me fuzion si per PE 80 ashtu edhe per PE 100 detajohen ne fuzionin me shkrirjen, elektrofuzionin, bashkinin mekanik, bashkinin me kllapa dhe xokol se bashku me nevojat per trajnim, mirembajtje, sherbim dhe kalibrin.

Ne terma te per gjithshme ne menyre qe te behen bashkime te mira duke perdonur tekniken e akopjimit me fuzion ne rrjet eshte e nevojshme te respektohen kerkesa te procedurave se bashkimit duke pasur parasysh perpunimin e skajit te tubit si edhe kontrollin e temperatures dhe trysnise.

12.10.9 Fuzioni Me Shkrirje

Tubat dhe akopjimet mund te lidhen me fuzion me shkrirje duke perdonur nje pllak qe nxehet me energji elektrike. Fuzioni me shkrirje eshte i pershtatshem per tuba bashkues dhe akopjimet ne permase me te medha se 63 mm. Sidoqoftë per te siguruar saldime te besueshme vetem tubat dhe akopjuesit me permase te njeta ne shkalle SDR dhe te tipit polietilen mund te bashkohen duke perdonur kete teknike per shembull nje tub SDR 250 mm nuk duhet te bashkohet me nje akopjues SDR 17.6.

Kushtet e bashkimit me fuzion me shkrirje te rekomanduara per te bashkuar tubat PE 100 dhe PE 80 jepen ne patenten e aparatit te saldimit.

12.10.10 Elektrofuzioni

Manikotat me elektrofuzion kane disa priza qe permbajne tela nxehes elektrike te cilat kur lidhen me tensionin puthisin manikoten ne tub pa pasur nevojen e pajisjeve te tjera nxehese. Eshte esenciale qe punetoret te kujdesen veçanerisht per te siguruar procedurat e saldimit te respektohen rigorozisht dhe ne veçanti qe:

-Skajet e tubave te jene te lemuar ashtu si duhet.

-Te gjitha pjeset e bashkimit te jene mbajtur paster dhe te thata para bashkimit duke ditur qe ndonje papasterti mund te çoje ne deshtim. Pastrues te lagur me izopropanol mund te perdoren per te zhvendosur papastertite pas lemitit.

- Kllapat jane perdonur saktesisht per te siguruar qe bashkimi mos te levize gjate ciklit te nxehjes dhe ftohjes.

- Mbulesa gjate saldimit perdoren per te siguruar qe pluhuri ose shiu nuk ndotin bashkimin dhe per te minimizuar efektet e lageshtise se eres.

13 PUNIMET E SHTRESAVE

13.1 Nenshtresa me materiale granulare

13.1.1 Qellimi

Ky seksion mbulon ndertimin e shtresave me zhavorr ose çakell mbeturina gurore. Shtresat me zhavorr (çakell mbeturina) 0-31.50mm (d=100 mm) ose zhavorr (çakell mbeturina) 0 – 50 mm (d=150mm), do te quhen me tutje "nenshtrese"(cakelli).

13.1.2 Çakelli mbeturina

Materiali i kesaj shtrese merret nga lumenjte ose guoret ose nga burime te tjera.

Kjo shtrese nuk do te permbaje material qe dimensionet maksimale te te cilit i kalojne 50 mm (trashesia e shtreses perfundimtare 100 mm) ose 100 mm (trashesia e shtreses perfundimtare 150 mm).

Materiali i shtreses duhet te perputhet me kerkesat e meposhtme kur te vendoset perfundimisht ne veper:

Permase e shkallezimit (ne mm)	KLASIFIKIMI A Perzierje Rere – Zhavorr Perqindja sipas Mases	KLASIFIKIMI B Perzierje Rere – Zhavorr Perqindja sipas Mases
75	100	
28	80 – 100	100
20	45 – 100	100
5	30 – 85	60 – 100
2	15 – 65	40 – 90
0.4	5 – 35	15 – 50
0.075	0 - 15	2 - 15

Table 8 - Granulometria

Çakelli mbeturina (ose zhavorri) duhet te plotesoje keto kushte:

- Indeksi i plasticitetit nuk duhet te kaloje 9
- Nuk duhet te permbaje grimca me permasa mbi 2/3 e trashesise se shtreses, ne sasi mbi 5%.
- Nuk duhet te permbaje mbi 10% grimca te dobeta dhe argilore
- CBR (California Bearing Ratio) minimale duhet te jete > 30%.
- Moduli I piastres ≥ 80 Mpa

KERKESAT PER NGJESHJEN

Ne vendet me densitet te matur ne gjendje te thate te shtreses se ngjeshur, vlera minimale duhet te jete 96% e vleres se Proktorit te Modifikuar.

13.1.3Ndertimi

(a) Gjendja

Kjo shtrese duhet te ndertohe vetem me kusht qe shtresa qe shtrihet poshte saj (subgrade ose tabani) te aprovohet nga Mbikeqyresit te Punimeve. Menjehere para vendosjes se materialit, shtresa subgrade (tabani) duhet te kontrollohet per demtime ose mangesi qe duhen riparuar mire.

(b) Shperndarja

Materiali do te grumbullohet ne sasi te mjaftueshme per te siguruar qe mbas ngjeshjes, shtresa e ngjeshur do te plotesoje te gjitha kerkesat per trashesine e shtreses, nivelet, seksionin terthor dhe densitetin. Asnje kurriz nuk duhet te formohet kur shtresa te jete mbaruar perfundimisht.

Shperndarja do te behet me dore.

Trashesia maksimale e nenshtreses (subbase) e ngjeshur me nje kalim (proces) do te jete 150 mm.

(c) Ngjeshja

Materiali i nenshtreses (subbase) do te hidhet me dore deri ne trashesine dhe nivelet e duhura dhe plotesisht i ngjeshur me pajisje te pershtatshme, per te fituar densitetin specifik ne tere shtresen me permbajtje optimale lageshtie te percaktuar (+ / - 2%).

Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk duhet te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis aggregateve fine dhe te ashper, rrudha ose defekte te tjera.

13.1.4Tolerancat ne Ndertim

Shtresa nenbaze e perfunduar do te perputhet me toleancat e dimensioneve te dhena me poshte:

(a) Nivelet

Siperfaqja e perfunduar do te jete brenda kufijve +15mm dhe +25mm nga niveli i caktuar.

(b) Gjereria

Gjereria e nenbazes nuk duhet te jete me e vogel se gjereria e specifikuar.

(c) Trashesia

Trashesia mesatare e materialit per çdo gjatesi te rruges matur para dhe pas niveleve, ose nga çpimet e testimeve, nuk duhet te jete me e vogel se trashesia e specifikuar.

(d) Seksioni Terthor

Ne çdo seksion terthor ndryshimi i nivelit midis çdo dy pikave nuk duhet te ndryshoje me shume se 20 mm nga ai i dhene ne vizatimet.

13.1.5 Kryerja E Provave

(a) **Prova Fushore**

Me qellim qe te percaktojme kerkesat per ngjeshjen, (numrin e kalimeve te pajisjes ngjeshese) provat fushore ne gjithe gjeresine e rruges se specifikuar dhe me gjatesi prej 50m do te behen nga Sipermarresi para fillimit te punimeve.

(b) **Kontrolli i Proçesit**

Frekuencia minimale e kryerjes se proves qe do te duhet per kontrollin e proçesit do te jetë siç eshte paraqitur ne tabelen 2.

PROVA	Shpeshtesia e Provave
	Nje prove çdo:
<u>Materiale</u>	
Dendesia e fushes dhe Perberja e ujit	1500 m ²
	<u>Toleranca e Ndertimeve</u>
Niveli I siperfaqes	25 m (3 pike per prerje terthore)
Trashesia	25 m
Gjereria	200 m
Prerje terthore	25 m

Table 9 – Shpeshtesia e provave fushore

(c) **Inspektimi Rutine dhe Kryerja e Provave te Materialeve**

Kjo do te behet per te bere proven e cilesise se materialeve per tu perputhur me kerkesat e ketij seksioni, ose te riparohet ne menyre qe pas riparimit te jetë ne perputhje me kerkesat e specifikuara.

13.2 Shtresa baze me gure te thyer (çakell makinerie)

(Çakell mina- çakell i thyer- çakell makadam)

13.2.1 Qellimi dhe definicioni

Ky seksion permban pergatitjen e vendosjen e çakellit te minave, çakellit te thyer dhe atij makadam ne pjesen e themelit. Shtresa “çakell mina, i thyer dhe makadam”, me fraksione deri 65mm dhe shtresa deri 150 mm quhen “themel me gure te thyer”

Ndryshimet ndermjet tyre jane:

Çakell mina, jane materiale te produara me mina ne guroret e aprovuara me fraksione nga 0 deri 65mm. Çakell i thyer, jane materiale te produara me makineri me fraksione te kufizuara 0 deri ne 65mm. Makadam eshte nje shtrese e ndertuar nga çakell i thyer dhe ku boshllqet mbushen me fraksione me te imta duke krijuar nje shtrese kompakte.

13.2.2 Materialet

Agregatet (inertet) e perdonura per shtresen baze te perbere prej gureve te thyer do te merren nga burimet e caktuara ne lumenj ose gurore. Kjo shtrese nuk do te permboje material copezues (prishes) si psh. pjese shkembinjsh te dekompozuar ose material argjilor.

Agregati i thyer duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:

- VLEREN E COPEZIMIT TE AGREGATEVE
- INDEKSI I PLASTICITETIT
- INDEKSI I PLASTICITETIT (PI) NUK DUHET TE TEJKALOJE VLEREN 6.
- KERKESAT PER SHPERNDARJEN GRANULOMETRIKE

Shkallezimi do te behet sipas kufijve te dhene ne tabelen meposhte:

Permasat e sites (mm)	Perqindja qe kalon (sipas mases)
50	100

28	84 - 94
20	72 – 94
10	51 – 67
5	36 - 53
1.18	18 – 33
0.3	11.21
0.075	8 - 12

Table 10 - Granulometria

Provat per te percaktuar nese materiali prej guresh te therrmuar i ploteson kerkesat e specifikuara te shkallezimit do te behen para dhe pas perzierjes dhe shperndarjes se materialit.

➤ KERKESAT NE NGJESHJE

Minimumi ne vendin me dadesi te thate te shtreses se ngjeshur duhet te jete 98% e Vleres se Proktorit te Modifikuar.

- CBR (California Bearing Ratio) minimale duhet te jete $> 80\%$.
- Indeksi I plasticitetit ≤ 6
- Moduli I piastrës $\geq 100 \text{ Mpa}$

13.2.3Ndertimi

➤ Gjendja

Para se te ndertohet shtresa baze prej guresh te thyer duhet te plotesohen keto kerkesa:

Shtresa poshte saj duhet te plotesoje kerkesat e shtreses ne fjale.

Asnjë shtrese themeli prej guresh te thyer nuk do te njeshet nese shtresa poshte saj eshte aq e lagur nga shiu ose per arsyte tjetra sa te perbeje rrezik per demtimin e tyre.

➤ (b) Gjereria

Gjereria totale e themelit me çakell (gure te thyer) do te jete sa ajo e dhene ne Vizatimet ose ne udhezimet e Mbikeqyresit te Punimeve.

➤ Shperndarja

Materiali do te grumbullohet ne menyre te mjaftueshme per te siguruar qe pas ndertimit shtresa ngjeshese te plotesoje te gjitha kerkesat e duhura per trashesine, nivelet, seksionin terthor, dhe densitetin e shtreses. Asnje gropezim nuk do te formohet kur shtresa te kete perfunduar teresisht.

Shperndarja do te behet me makineri ose me krahe.

Trashesia maksimale e shtreses te formuar me gure te thermmuar e ngjeshur me nje proces do te jetë sipas vizatimeve.

➤ Ngjeshja

Materiali i shtreses se themelit me çakell do te hidhet me dore deri ne trashesine dhe nivelet e duhura dhe plotesisht i ngjeshur me pajisje te pershtatshme, per te fituar densitetin specifik ne tere shtresen me permbajtje optimale lageshtie te percaktuar.

Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk do te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis aggregateve fine dhe te ashper, rrudha ose difekte te tjera.

13.2.4 Tolerancat ne Ndertim

Shtresa baze e perfunduar do te perputhet me tolerancat e dimensioneve te dhena me poshte:

➤ Nivelet

Siperfaqja e perfunduar do te jetë brenda kufijve +15mm dhe -25mm nga niveli i caktuar, ndryshimi nga shkallezimi i dhene te mos e kaloje 0.1% ne 30 m gjatesi te matur.

➤ Gjereria

Gjereria e shtresave te themelit nuk duhet te jetë me e vogel se gjereria e specifikuar.

➤ Trashesia

Trashesia mesatare e materialit per çdo gjatesi te rruges nuk duhet te jetë me e vogel se trashesia e specifikuar.

13.2.5 Kryerja e Provave Materiale

➤ KONTROLLI I PROÇESIT

Frekuencia minimale e kryerjes se proves qe do te duhet per kontrollin e procesit do te jetë siç eshte paraqitur ne tabelen mepsohte:

PROVAT	Shpeshtesia e provave ne çdo....
<u>Materialet</u> Densiteti ne terren Permbajtja e ujit	2000 m ²
<u>Tolerancat ne Ndertim</u> Nivelet e siperfaqes	25m (3 pikë per çdo seksion)
Trashesia	25m
Gjeresia	200m
Seksoni Terthor	25m

Table 11 – Shpeshtesia e testeve fushore

13.3 Shtresa Mbi Baze Me Stabilizant (Gure Te Thyer Me Makineri Dhe I Fraksionuar)

13.3.1Materialet

Qellimi :

- a) Agregatet (inertet) e perdorura per shtresen e Bazes, te perbere prej gureve te thyer do te merren nga burime te caktuara ne zonat e karrierave. Punimet e dherave nuk do te permbajne material copezues,(prishes), si p.sh. pjese shkembinjs te dekompozuar ose material argilor. Agregati i thyer duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme:

- VLEREN E COPEZIMIT TE AGREGATEVE

- c) INDEKSI I PLASTICITETIT **$I_p < 6$**
- d) TREGUESI I LOS ANGELESIT jo me i madh se **30**
- f) PROVE E NGJESHJES DIREKT NE SHTRESEN E PERFUNDUAR **98% te Proktori**
- g) PROVA E PIASTRES PER PERCAKTIMIN E MODULIT TE DEFORMACIONIT
 $N_d > 1000 \text{ kg/cm}^2$ ose $> 120 \text{ Mpa}$
- h) CBR jo me e vogel se 85

Shkallezimi do te behet sipas kufijve te dhene ne tabelen e meposhtme:

TABELA 1 Shkallezimi per shtresen e Stabilizantit.

Permasat e sites (mm)	Perqindja qe kalon (sipas mases)
63	100
50	100
37.5	95-100
25	70-95
19	55-85
9.5	40-72
4.75	30-60
0.425	10-25
0.075	3-10

Table 12 - Granulometria

Provati per te percaktuar nese materiali prej guresh te thermuar i ploteson kerkesat e specifikuara te shkallezimit do te behen para dhe pas perzierjes dhe shperndarjes se materialit.

a) KERKESAT NE NGJESHJE

Minimumi ne vendin me dendesi te thatë te shtreses se ngjeshur duhet te jetë 98% Vlerës se Proktorit te Modifikuar.

Ndertimi

(a) GJENDJA

Para se te ndertohet shtresa baze prej guresh te thyer duhet te plotesohen keto kerkesa:

Shtresa poshte saj duhet te plotesoje kerkesat e shtreses ne fjale.

Asnje shtrese themeli prej guresh te thyer nuk do te ngjeshet nese shtresa poshte saj eshte aq e lagur nga shiu ose per arsyte tjetra sa te perbeje rrezik per demtimin e tyre.

(b) GJERESIA

Gjeresia totale e bazes me cakell (gure te thyer, stabilizant) do te jetë sa ajo e dhene ne Projekt dhe e miratuar nga Supervizori.

(c) SHPERNDARJA

Materiali do te grumbullohet ne sasi te mjaftueshme per te siguruar qe pas ndertimit shtresa ngjeshese te plotesoje te gjitha kerkesat e duhura per trashesine, nivelet, seksionin terthor dhe densitetin e shtreses. Asnje gropezim nuk do te formohet kur shtresa te kete perfunduar teresisht.

Shperdarja do te behet me dore.

Trashesia maksimale e shtreses se formuar me gure te thermuar e ngjeshur me nje proces te plete do te jetë 100 mm.

Shtresa e Stabilizantit 20 cm do te formohet nga 2 shtresa me 10 cm, ndersa ne rastin kur eshte prashikuar 15 cm do te hidhet vetem me nje shtrese dhe do te ngjeshet me rul te rende.

(d) NGJESHJA

Materiali i shtreses se bazes me stabilizant do te hidhet me dore deri ne trashesine dhe nivelet e duhura dhe plotesisht i ngjeshur me paisje te pershatshme per te fituar densitetin specifik ne tere shtresen me permbajtje optimale lageshtie te percaktuar.

Shtresa e ngjeshur perfundimi nuk do te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis aggregateve fine dhe te ashper, rrudha ose defekte te tjerave.

13.3.2 Sperkatja Me Uje

Uji duhet para se materiali te ngjishet, do ti shtohet ne menyre te njepasnjeshme dhe uniforme, uji duhet te perzihet me materialin qe do te ngjishet, deri sa materiali te permbaje lageshti optimale (+/-2%).

13.3.3 Toleranca Ne Ndertim

Shtresa baze e perfunduar do te perputhet me tolerancat e dimensioneve te dhena me poshte:

(a) Nivelet

(b) Siperfaqja e perfunduar do te jetë brenda kufijve +15 mm dhe -25 mm nga niveli i caktuar, ndryshimi nga shkallezimi i dhene te mos e kaloje 0.1 % ne 30 m gjatesi te matur.

(c) GJERESIA

Gjeresia e shtresave te themelit nuk duhet te jete me i vogel se gjeresia e specifikuar.

(d) TRASHESIA

Trashesia mesatare e materialit per cdo gjatesi te rruges nuk duhet te jete me e vogel se trashesia e specifikuar.

(e) SEKSIONI TERTHOR

Ne cdo seksion terthor ndryshimi i nivelit midis cdo dy pikave nuk duhet te ndryshoje me me shume se 20 mm nga diferenca ne nivele e dhene ne prerje terthore, sic eshte treguar ne vizatime.

13.3.4 Kryerja e provave te materialeve

(KONTROLLI I PROCESIT)

Me qellim qe te percaktojme kerkesat per ngjedhjen (numri i kalimeve te paisjes ngjeshese) provat fushore ne gjite gjeresine e rruges se specifikuar dhe me gjatesi prej 50 m do te behen nga Kontaktori para fillimit te punimeve.

Frekuencia minimale e kryerjes se proves qe do te duhet per kontrollin e procesit do te jete sic eshte paraqitur ne tabelen meposhte:

Provat	Shpeshtesa e provave nje cdo ...
Materialet	
Densiteti ne terren	1500m ²
Permbajtja e Ujit	
Tolerancat ne ndertim	25 m (Prerje terthore)
Nivelet e siperfaqes	
Trashesia	25 m
Gjeresia	200 m
Prerja terthore	25 m
ACV	2000 m ³

Table 13- Shpeshtesa e provave fushore

13.3.5 Inspektimi rutine dhe kryerja e provave te materialeve

Kjo do te behet per te bere proven e cilesise se materialeve per t'u perputhur me kerkesat e ketij seksioni, ose te riparohet ne menyre qe pas riparimit te jete ne perputhje me kerkesat e specifikuara.

13.4 Shtresa asfaltobetoni

13.4.1 Qellimi

Ky standard eshte i vlefshem per shtresat e rruges te shtruara me a/beton.

13.4.2 Ternat

Ky ze do te percaktoje shtresen asfaltike qe konsiston ne pergatitjen e perzierjes se asfaltit ne nyjet e prodhimit te asfaltit. Gjithashtu ky ze punimesh perfshin transportin ne kantier, shtrimin dhe ngjeshjen e duhur te asfaltobetonit te ngrohte te perzieries ne shtresen e percaktuar ne Projekt. Zeri, gjithashtu perfshin parapergatitjen e duhur te gjurmese se rruges ekzistuese me një shtrese emulsioni bituminoz me 0.6 – 0.8 liter per meter katror, perpara shtrimit te asfalto – betonit dhe 1.2 litra per meter katror para shtrimit te binderit. Masa sigurie te pershtatshme duhet te ndermerren gjate processit te punes. Sigurimi dhe menaxhimi i trafikut si dhe mbrojtja e paisjeve te vet Kontraktorit duhet te kene sinjalizimet per te eliminuar cdo aksident te mundshem.

Kontraktori nuk do te ndertoje shtresa, trashesia e te cilave pas ngjeshjes, eshte me pak se sa dyfishi i madhesise maksimale te granileve te perdorura per prodhimin e asfalteve.

13.4.3 Materialet

Materialet e perdorura per pergatitjen e asfalto-betonit jane: bitumi, agregatet e ngurta dhe rere.

- a) Bitumi i aprovuar nga Supervizori. Bitumi qe do te perdoret duhet te jete i pershtatshem per punime rrugore dhe duhet te arrije kerkesat te paraqitura ne tabelen e meposhtme.

Prova	Kerkesa
Penetracioni ne 25 C, 1/10mm	60-80
Pika e zbutjes, C	48-55
Elasticiteti ne 5 C cm	> 4
Elasticiteti ne 25 C cm	> 100

Pika e thyerjes C	< - 13
Shperberja, %	> 99
Permbajtja e parafines %	> 2
Densiteti ne 15 C gr/cm ³	> 0.995
Lidhshmeria me granilet	> 80

Table 14 – Kërkesat e Bitumit

- b) Agregatet e ngurta, (granilet), te perdonura ne perzierjet bituminoze duhet te jene nga një burim apo kariere e aprovar me pare nga Supervizori. Ato duhet te jene te lara mire para se te perdoren per prodhimin e asfalteve, apo per shtresen e Stabilizantit, ne shtresat rrugore. Granilet e trasha dhe te imta duhet te jene te pastra dhe te mos permbajne asnje lloj materiali te dekompozuar, bimor apo substance tjeter shkateruese.

Per perzierjet e shtreses konsumuese, (Asfaltit), dhe binderit nuk do te perdoren granile me vlerë me te madhe konsumimi te Los Angeles respektivisht se 25.

Materiali mbushes mund te jete zhavorr lumi i thyer ose gure kave i thyer ose granile me origjine vullkanike. Si shtese mund te jete e nevojshme te hidhet filer i prodhuar nga gure gelqerore. Llojet e aggregateve te kombinuar mund te permbajne si granulometrine e aggregatit dhe perqindjen e asfaltit sipas tabela se me poshtme.

Masat e sites (mm)	Binder % e kalueshme	Tapet % e kalueshme
0.075	4 -8	6-11
0.18	5-55	7-15
0.4	7-25	12-24
2.0	20-24	25-45

5	30-60	43-67
10	50-80	70-100
15	65-100	100
25	100	-
31.5	-	-
% e Bitumit	5.0-7	6-8

Table 15- Granulometria e materialit mbushes

13.4.4 Klasifikimi i asfaltobetonit.

- Asfaltobetoni per ndertimin e shtresave rrugore perqatitet nga perzierja ne te nxehete e materialeve mbushes (çakell, granil, rere e pluhur mineral) me lende lidhese bitum.

Sipas madhesise ose imtesise te kokrrizave te materialit mbushes, qe perdoret per prodhimin e asfaltobetonit, ai klasifikohet:

- asfaltobeton kokerrmadh me madhesi kokrrize deri 35mm.
- asfaltobeton mesatar me madhesi kokrrize deri 25mm.
- asfaltobeton i imet me madhesi kokrrize deri 15mm.
- asfaltobeton ranor me madhesi kokrrize deri 5mm.

Ne varesi nga poroziteti qe permban masa e asfaltobetonit ne gjendje te ngjeshur ndahet:

- - Asfaltobeton i ngjeshur, i cili perqatitet me çakell te thyer e granil ne mase 35 deri 40%, rere 50% dhe pluhur mineral 5 deri 15% dhe qe mbas ngjeshjes ka porozitet mbetes ne masen 3 deri ne 5% ne volum.
- - Asfaltobetoni poroz (binder) qe perqatitet me 60 deri 75% çakell te thyer, 20 deri ne 35% rere dhe qe mbas ngjeshjes ka porozitet mbetes 5 deri 10% ne vellim.
- Asfaltobetoni i ngjeshur perdoret ne ndertimin e shtreses perdoruese, ndersa asfalto betoni poroz per shtresen lidhese (binder).

Asfaltobetoni i ngjeshur ne varesi nga permbajtja e pluhurit mineral e shprehur ne perqindje ne peshe dhe te cilesive te materialeve perberes te tij, klasifikohen ne dy kategori:

- Kategoria I me permbajtje 15% pluhur mineral(filerit)
- Kategoria II me permbajtje 5% pluhur mineral(filerit)

13.4.5Percaktimi i perberjes te asfaltobetonit

Kategoria, lloji, trashesia e shtreses dhe kerkesat teknike te asfaltobetonit percaktohen nga projektuesi dhe jepen ne projekt zbatimin, ndersa perberja per prodhimin e asfaltobetonit, qe shpreh raportin midis elementeve perberes te tij (çakell ose zall i thyer, granil, rere, pluhur mineral e bitum) si dhe treguesit teknike te mases se asfaltobetonit ne gjendje te ngjeshur, percaktohen me prova laboratorike.

Ne tabelen 3 jane paraqitur kerkesat e STASH 660-87 mbi perberjen granulometrike te mbushesave dhe perqindjen e bitumit per prodhimin e llojeve te ndryshme te asfaltobetonit, mbi te cilat duhet te mbeshtet puna eksperimentale laboratorike per percaktimin e perberjes (recetave) te asfaltobetonit per prodhim

Nr	Lloji I asfaltobetonit	Mbetja ne % e materialit mbushes me ϕ ne mm												Kal on ne 0.0 7	bit um it ne %
		40	25	20	15	10	5	3	1.2 5	0.6 3	0.3 15	0.1 4	0.0 71		
I	Asfaltobeton granulometri te vazhduar														
1	Kokerr mesatar	-	-	0-5	8-14	7-11	13-20	9-10	14-13	11-8	10-5	7-5	8-3	13-6	5-5.6
2	Kokerr imet	-	-	-	0-5	11-18	17-25	7-12	6-13	11-8	8-4	9-6	6-1	15-8	6-8
3	Kokerr imet	-	-	-	-	0-5	20-40	13-15	18-13	11-8	8-4	9-6	6-1	15-8	6-8
4	ranor me rere te thyer	-	-	-	-	-	0-5	12-20	21-30	17-17	15-10	12-7	9-3	14-8	7.5-5
5	ranor me rere natyrale	-	-	-	-	-	0-5	3-12	11-27	14-16	17-10	22-10	17-7	16-10	7-9
II	Asfaltobeton i ngjeshur me granulometri nderprere														

1	Kokerr mesatar	-	-	0-5	9-10	11-15	15-20	0-0	0-0	0-0	25-22	18-14	9-8	13-6	5-7
2	Kokerr imet	-	-	-	0-5	15-20	20-25	0-0	0-0	0-0	25-22	18-14	7-6	15-8	5.5-7
3	Kokerr imet	-	-	-	0-5	0-5	35-40	0-0	0-0	0-0	25-22	18-14	7-6	15-8	5.5-7

Table 16 - Perberja granulometrike dhe perqindja e bitumit ne lloje te ndryshme asfaltobetoni.

- c) Perberja e asfaltobetonit e percaktuar ne rruge eksperimentale ne laborator jepet per prodhim vetem atehere, kur plotesohen kerkesat teknike sipas projektit te zbatimit dhe te STASH 660-87 te pasqyruar ne tabelen 4.

13.4.6 Kerkesat teknike qe duhet te plotesoje asfaltobetoni sipas STASH 660-87

Tabela 4

Nr.	Treguesit teknik	Asfalto beton I ngjeshur		Asfaltobeton poroz (binder)
		Kategoria I	Kategoria II	
1	Rezistenca ne shtypje ne temp. 20° C kg/cm ² jo me pak se	25	20	-
2	Rezistenca ne shtypje ne temp. 50° C kg/cm ² jo me pak se	10	8	6
3	Qendrueshmeria ndaj te nxehtit Knx= R-20/R50	2.5	2.5	-

4	Qendrueshmeria ndaj ujit K-uje jo me pak se	09	08	-
5	Poroziteti perfundimtar (mbas ngjeshjes) ne % ne vellim	3-5	3-5	7-10
6	Ujethithja % ne vellim jo me shume se	1-3	1-5	7-10
7	Mufatja % ne vellim jo me shume se	0.5	1	2

Table 17 - Kerkesat teknike qe duhet te plotesoje asfaltobetoni sipas STASH 660-87

13.4.7 Kerkesat teknike ndaj materialeve perberes te asfaltobetonit.

- a) Bitumi qe perdoret per prodhimin e asfaltobetonit si dhe ne asfaltimet e tjera me depertim ose trajtim siperfaqesor, duhet te plotesoje kerkesat e Stash 660-87 ose te STASH CNR Nr. 1996 "Karakteristika per pranim"
- b) Ne kohe te nxehete (vere) keshillohet perdomimi i bitumit me depertim (penetrim) 80 deri 120 ose me pike zbutje 45 deri 50°C, ndersa ne pranvere e vjeshte bitum me depertim 120 deri 200 ose pike zbutje 40 deri 45°C.

Çakelli, zalli, zalli I thyer dhe granili duhet te plotesojne kerkesat e STASH 539-87 "Perpunime ndertimi".

Rezistencia ne shtypje e shkembinjve nga te cilet prodhohet me copetim mekanik çakelli e granili, duhet te jete jo me pak se 800kg/cm². keshillohet qe

Per shtresen konsumuese(tapetin), rezistenca ne shtypje e shkembinjve te jete mbi 1000kg/cm².

Zalli i thyer duhet te permbate jo me pak se 35% kokrriza te thyera me madhesi mbi 5mm. Sasia e kokrrizave te dobeta (me rezistence me pak se 800 kg/cm²) nuk duhet te jete me shume se 10% ne peshe, per kategorine e pare te asfaltimit dhe jo me shume se 15% ne peshe per kategorine e dyte te asfaltimit. Sasia e kokrrizave ne forme pete dhe gjilpere, te mos jete me shume se 25% ne peshe per shtresen lidhese (binder).

Rera per prodhim asfaltobetoni mund te perfitohet nga copetimi dhe bluarja e shkembinjve me rezistence ne shtypje mbi 800 kg/cm², ose nga lumi dhe ne çdo rast, duhet te plotesoje kerkesat e STASH 506-87 "Rera per punime ndertimi".

Per pergatitjen e asfaltobetonit ranor, ajo duhet te jete e trashe me modul mbi 2.4.

Pluhuri mineral qe perdoret per prodhim asfaltobetoni, mund te perfitohet nga bluarja e shkembinjve gelqerore ose pluhur TCC, cimento, etj. Ne çdo rast pluhuri mineral duhet te plotesoje kerkesat lidhur me imtesine dhe hidrofilitetin. dhe me kerkesat e tableles me poshte.

Imtesia qe kalon ne 0,075mm / me kalim sitje masive	Min 70%
---	---------

Poret ne filerin e ngjeshur e te thate	0.3-0.5%
Permbajtja e ujit	Max 2%

Table 18 – Kerkesat per pluhurin mineral

Imtesia e pluhurit mineral duhet te jete e tille, qe te kaloje 100% ne siten me madhesi te vrimave 1.25 mm dhe te kaloje jo me pak se 70% ne peshe ne siten 0.074 mm.

Koeficienti i hidrofilitetit te pluhurit mineral, i cili shpreh aftesine lidhese me bitumin te jete jo me shume se 1.1

13.4.8 Prodhimi dhe transporti i asfaltobetonit

Asfaltobetoni pregetitet ne fabrika te posaqme, te cilat keshillohet te ngrihen sa me afer depozitave te lendeve te para dhe vendit te perdonimit te tij. Aftesia prodhuese e fabrikes percaktohet ne varesi nga plani i organizimit te punes se firmes, qe zbaton punimet e ndertimit te rruges.

Materialet mbushes te asfaltobetonit siç jane çakelli, zalli, granili e rera duhet te depozitohen prane fabrikes ne bokse te veçanta. Para futjes se tyre ne perzieres ato duhet te thahen dhe nxehen deri ne temperaturen 250°C, pastaj dozohen dhe futen ne perzieres.

Pluhuri mineral duhet te ruhet ne depo te mbuluara dhe pa lageshti. Ne çastin e dozimit dhe futjes ne perzieres, ai duhet te jete i shkrifet (i patopezuar) dhe i thate. Kur permban lageshti duhet te thahet paraprakisht dhe futet ne gjendje te nxehte ne perzieres.

Bitumi, ne prodhimin e asfaltobetonit futet ne gjendje te nxehte, por temperatura e tij nuk duhet te jete mbi 170°C per ta mbrojtur nga djegia.

Ne fillim futen ne perzieres materialet mbushes dhe pluhuri mineral, perzihen sebashku ne gjendje te thate e te nxehte, pastaj i shtohet bitumi po ne gjendje te nxehte dhe vazhdon perzierja derisa te krijohet nje mase e njetrajtshme.

Dozimi i perberesave te asfaltobetonit duhet te behet me saktesi $\pm 1.5\%$ ne peshe per pluhurin mineral dhe bitumin me saktesi $\pm 3\%$ ne peshe per materialet mbushesa te çfaredo lloji, madhesie.

Temperatura e mases se asfaltobetonit mbas shkarkimit nga perzieresi duhet te jete ne kufijte 140 deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit te jashtem eshte 5 deri ne 10°C, kufiri me i ulet i asfaltobetonit do te jete jo me pak se 150°C.

Transporti i asfaltobetonit duhet te behet me njete veteshkarkuese. Karroceria e tyre para ngarkeses duhet te jete e paster, e thate dhe e lyer me perzieres solari te holluar me vajgur, per te menjanuar ngjitet e mases se asfaltobetonit. Keshillohet qe karroceria e mjetit te jete e mbuluar, per te mbrojtur asfaltobetonin nga lageshtia dhe te ngadalesoje shpejtesine e ftohjes se mases gjate transportit.

Automjeti qe transporton asfaltobeton duhet te shoqerohet me dokumentin e ngarkeses, ku duhet te shenohen: targa e automjetit, lloji dhe sasia e asfaltobetonit, temperatura e mases ne nisje dhe koha e nisjes e automjetit me ngarkese nga fabrika.

Kontrolli mbi cilesine e asfaltobetonit behet ne perputhje me kerkesat e STASH 561-87 si dhe ne kerkesat per :

1. Agregatet:

- **Granulometrine** (brenda fuzes se recetes se perqatitur ne laborator, apo te

propozuar **Kontraktori** dhe te Miratuar nga **Supervizori**)

- **Ip** (joplastike)

- **Los Angeles** (< 25)

- **Rezistenca ndaj sulfateve** (<12%)

- **Pluhuri i mbetur pas larjes** (< 1%)

- **Ekuivalenti i reres**

2. Bitumi

Mostrat per kontrollin cilesor te prodhimit, nxirren nga 3 deri 4 perzierje gjate shkarkimit te mases se asfaltobetonit ne automjet, duke veçuar 8 deri ne 10kg nga çdo perzierje. Sasia e veçuar perzihet deri sa ajo te behet e njetrajtshme dhe prej saj merret moster mesatare me sasi 10kg. Mbi kete moster mesatare kryhen provat ne laborator per percaktimin e treguesave fiziko-mekanike, te cilet krahasohen me kerkesat e projektit ose STASH 660-87 per vleresimin cilesor te prodhimit.

Kontrolli mbi cilesine e prodhimit te asfaltobetonit duhet te kryhet sa here dyshohet nga pamja gjate shkarkimit te perzierjes ne automjet dhe ne çdo rast jo me pak se nje here ne turn.

Kontrolli mbi cilesine e prodhimit mund te behet edhe me metoda praktike duke u nisur nga pamja dhe punueshmeria e mases se asfaltobetonit gjate vendosjes ne veper sic, jane rastet e meposhtme:

- m-1) Asfaltobetoni qe permbar bitum brenda kufirit te lejuar eshte i bute, shkelqen dhe ka ngjyre te zeze. Formon mbi karrocerine e mjetit nje kon te rrafshet dhe nuk fraksionohet gjate shkarkimit. Kur permbar me shume bitum, masa shkelqen shume, ngarkesa ne karrocerine e mjetit rrafshohet, gjate shkarkimit bitumi rrjedh nga kokrrizat, bitumi del ne siperfaqe dhe shtresa rrudhoset gjate ngjeshjes me rul. Kur permbar me pak bitum, masa e asfaltobetonit ka ngjyre kafe, fraksionohet gjate shkarkimit dhe kokrrizat e medha jane te pambeshtjella mire me bitum dhe jane te palidhura me njera-tjetren.
- m-2) Asfaltobetoni qe ka temperature brenda kufirit te lejuar (140 - 160°C) leson avull ne ngjyre jeshile dhe mqedisi siper tij ngrohet. Kur temperatura eshte shume e larte, avulli ka ngjyre blu te forte. Kur temperatura eshte shume e ulet, mbi masen e asfaltobetonit te ngarkuar ne automjet formohet kore dhe mbas shkarkimit nuk avullon. Nuk realizohet ngjeshja e kerkuar dhe mbi siperfaqen e shtreses se porsashtruar dallohen kokrrizat te palidhura mire.

- m-3) Asfaltobetoni qe permban granil me shume se kufiri i lejuar, shkelqen shume e fraksionohet gjate ngarkim shkarkimit dhe ne siperfaqen e shtreses se porsashtruar dallohen zona me kokrriza te palidhura mire. Kur permban granil me pak se kufiri i lejuar, masa eshte pa shkelqim, ka ngjyre kafe dhe siperfaqja e shtreses se porsashtruar eshte shume e lemuar.
- m-3) Kur masa e asfaltobetonit leshon avull me ngjyre te bardhe, tregon se tharja ne baraban e materialeve mbushes nuk eshte bere e plote dhe ato permbajne akoma lageshti.
- n) Kur verehen mangesi si ato te pershkruara ne paragrafin m (pika m-1; m-2; m-3; dhe m-4) nuk duhet lejuar vazhdimi i punes per shtrimin e asfaltobetonit dhe te njoftohet menjehere baza e prodhimit per te bere korrigimet e nevojshme ne receten e prodhimit.

13.4.9 Shtrimi dhe ngjeshja e asfaltobetonit

Ndertimi i mbuleses rrugore fillon te kryhet mbasi te kene perfunduar punimet e themelit (nenshtreses) dhe te jene treguesit teknik lidhur me ngjeshmerine ose aftesine mbajtese te tyre ne perputhje me kerkesat e projektit.

Tipi i mbuleses rrugore me nje ose me shume shtresa, lloji i asfaltobetonit dhe trashesia e çdo shtrese ne veçanti, percaktohen nga projektuesi ne projektin e zbatimit.

Ne ndertimin e autostradave dhe rrugeve te Kat. I e te II, themeli (nenshtresa) duhet te jete shtrese asfalti, shtrese makadami ose shtrese çakelli, te cilat ne çdo rast duhet te jene te percaktuara ne projektin e zbatimit.

Themeli (nenshtresa) mbi te cilen vendosen shtresat e asfaltobetonit, duhet te jete e thate dhe e paster. Koha me e pershtatshme per shtrimin e asfaltobetonit eshte stina e pranveres, veres dhe vjeshtes. Megjithate, ne ditet me reshje shiu nuk lejohet.

Shtrimi i asfaltobetonit duhet te filloje nga njera ane e rruges (buzina) e deri ne mesin e saj, duke ecur paralel me aksin gjatesor, per nje segment rruge te caktuar, e cila zakonisht mund te jete deri ne 60m, me pas vazhdohet ne segmentin tjeter e keshtu me rradhe.

Shtrimi i asfaltobetonit, sidomos ne shtrimin e autostradave dhe rruget e Kat. I e te II duhet te behet me makina asfaltoshruese, te cilat sigurojne shperndarje te njetrajtshme te mases se asfaltobetonit. Shpejtesia e levizjes se makines asfaltoshruese duhet te jete 2 deri 2.5 km/orë.

Trashesia e shtreses se asfaltobetonit ne momentin e shtrimit (ne gjendje te shkrifet) duhet te jete 1.20 deri 1.25% me shume nga trashesia e dhene ne projektzbatim ne gjendje te ngjeshur.

Temperatura e mases se asfaltobetonit ne momentin e shtrimit ne rruge duhet te jete ne kufijte 130 deri 150°C. Ne kohe te nxehet jo me pak se 130°C dhe ne kohe te ftohte (kur temperatura e mjedisit te jashtem eshte 5 deri ne 10°C) te jete jo me pak se 140°C.

Ngjeshja e shtreses se asfaltobetonit duhet te kryhet menjehere mbas shtrimit te tij ne rruge. Cilindri ngjeshes mund te ndjeke nga pas makinerine asfaltoshruese duke qendruar ne largesi deri 4m, me qellim qe ngjeshja te kryhet ne gjendje sa me te nxehet.

Ngjeshja e shtreses se asfaltobetonit per gjysmen e pare te rruges fillon nga buzina (bankina), ndersa per gjysmen tjeter nga fuga gjatesore, e cila mund te jete aksi i rruges.

Makinerte qe perdoren per ngjeshjen e shtresave te asfaltobetonit mund te jene rula te zakonshem me pesha te ndryshme nga 5 deri ne 12 ton ose rulo me vibrim.

Kur perdoren per ngjeshje rula te zakonshem, numri i kalimeve luhatet ne kufij 12 deri 17, ndersa kur perdoren rula vibrues, numri i kalimeve ulet ne masen deri 50%.

Ne fillim te ngjeshjes, cilindri ne kalimet e para (deri 4 kalime) duhet t'a beje ne te gjithe siperfaqen e shtreses se asfaltobetonit duke ecur me shpejtesi 2 deri ne 2.5km/ore. Drejtimi i levizjes ne kalimet e para keshillohet te behet ne drejtim te cilindrit te parme, me qellim qe te menjanohet rrudhosja e shtreses.

Ne kohe te nxekte, fillimisht ngjeshja e shtreses se asfaltobetonit behet me rulo me peshe te lehte 5 deri 7 ton dhe me pas vazhdohet me rulo me peshe 10 deri ne 12 ton, ndersa ne kohe te ftohte, ngjeshja fillohet me rulo te rende 10 – 12 ton dhe me pas vazhdohet me rulo te lehte, shpejtesia e levizjes se rulit duhet te jete ne kufijte 2 deri 4km/ore.

Ngjeshja e vendeve qe nuk mund te kryhen me cilinder, ngjeshen me tokmak ose pllaka te nxehtha.

Cilindri ngjeshes ne çdo kalim duhet te shkele ne gjurmen e meparshme jo me pak se 0.25 te gjeresise se tij.

Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e perfunduar atehere kur mbi siperfaqen e asfaltuar cilindri gjate kalimit te tij nuk le me gjurme.

Cilindri i rulit gjate punes per ngjashjen shtreses se asfaltobetonit duhet te lyhet vazhdimisht me solucion solari te holluar me vajgur per te menjanuar ngjitjen e kokrrizave te bituminuara ne te.

Nuk lejohet qe ruli te qendroje ne shtresen e asfaltobetonit te pangjeshur plotesisht ose te beje manovrime te ndryshme mbi te.

Kur shtrimi i asfaltobetonit kryhet pa nderprerje dhe perbehet nga dy shtresa, keshillohet qe shtresa e binderit te kryhet naten, ndersa shtresa perdonuese diten.

Per te menjanuar rrudhosjen e shtresave te asfaltobetonit ne rruget, qe kane pjerresi gjatesore mbi 6% eshte e domosdoshme qe te sigurohet siperfaqe e ashper e shtreses se asfaltobetonit duke perdonor per prodhimin e tij çakell kokerrmadh dhe ngjeshja me cilinder te kryhet duke filluar nga pjesa me e ulet.

Fugat te cilat krijohen gjate shtrimit te asfaltobetonit ne kohe te ndryshme duhet te trajtohen me kujdes te veçante, per te menjanuar boshlleqet qe mund te krijohen ne to. Keshillohet qe te respektohen rregullat qe vijojne:

v-1) Fugat midis shtreses se binderit dhe shtreses perdonuese te asfaltobetonit duhet qe ne çdo rast te jene te larguara nga njera-tjetra ne kufijte 10 deri 20cm (shih fig 2).

v-2) Nderprerjet e shtreses se asfaltobetonit ne plan ne drejtim terthor me aksin e rruges duhet te behet me nje kend 70° (shih fig 1).

v-3) Fugat gjatesore e terthore me aksin e rruges duhet te behen te pjerreta me 45° . Para fillimit te shtreses pasardhese te asfaltobetonit, shtresa e meparshme duhet te pritet me dalte duke e bere fugen te pjerret me kend 45° .

v-4) Para fillimit te shtreses se asfaltobetonit fuga lyhet me bitum dhe ne buze te saj vendoset listele druri, e cila kufizon trashesine e asfaltobetonit te shkrifet dhe nuk lejon asfaltin e fresket mbi shtresen e ngjeshur me pare (shih fig. 3). Kur fillon ngjeshja hiqet listela dhe cilindri duhet te beje ngjeshjen duke shkelur jo me pak se 20cm fugen (shih fig.4). Mbas perfundimit te ngjeshjes, fuga ne te dyja anet e saj ne nje gjeresi prej 6cm duhet te lyhet me bitum.

w) Ne rastet kur shtresa perdoruese e asfaltobetonit shtrohet mbasi shtresa lidhese (binderi) i eshte nenshtruar me pare levizjeve te automjeteve, duhet detyrimisht te pastrohet siperfaqja e saj nga papastertite e pluhuri, te mos permbane lageshti dhe te sperkatet me bitum te lengshem (ne sasi deri 06 kg/m²) para fillimit te vendosjes se shtreses perdoruese te asfaltobetonit.

13.4.10 Kontrolli mbi cilesine e asfaltobetonit te shtruar

a) Siperfaqja e shtreses se asfaltobetonit duhet te jete e lemuar, e rrafshet dhe e njetrajtshme, te mos kete plasaritje, gungezime ose valezime, te mos kete porozitet e ndryshime ne kuota, pjerresi e trashesi te shtreses, nga ato te dhena ne projekt zbatim.

Ndryshimet ne kuotat anesore te rruges nuk duhet te jene me shume se $\pm 20\text{mm}$ ne krahasim me kuotat e percaktuara ne profilin terthor te projektit.

Valezime te matura me late me gjatesi 3 m si ne drejtim terthor, ashtu dhe ne ate gjatesor te rruges nuk duhet te jene me shume se $\pm 5\text{ mm}$.

Ndryshimet ne trashesine e shtreses krahasuar me ato te percaktuara ne projekt nuk duhet te jene me shume se $\pm 10\%$.

Kontrolli qe percakton cilisite kryesore te asfaltobetonit te vendosur e ngjeshur ne veper percaktohen me prova laboratorike. Per kete qellim per çdo segment rruge te perfunduar ose per sasi deri ne 2500m² asfaltobeton te shtruar rruge, nxirren mostra me madhesi 25 x 25 cm mbi te cilat kryhen prova laboratorike per percaktimin e veticë fiziko-mekanike. Vlerat e tyre krahasohen me kerkesat e projektit ose te STASH 660-87. Per te arritur kete, Kontraktori do te propozoje Metoden e ngjeshjes, Mjetet e punes dhe sasine e tyre ne proces, Kapacitetin e makinerive ne perdomim, Tipin e mjetit ngjeshes, Temperaturen e shtrimit. Metoda e propozuar nga Kontraktori do te konsiderohet e kenaqshme, nese densiteti Marshall i perfthuar gjate provave ne terren, eshte me i larte se 98% e densitetit Marshall te perfthuar nga provat e perberjes se perzierjes ne laboratori. e cila duhet te miratohet nga Supervizori. Gjate periudhen ndertimore frekuanca e testeve do te jete nje "karrote" ne cdo 60 – 100ml rruge, ose sipas udhezimeve me shkrim te Supervizorit.

Per cdo segment rruge te shtruar me asfaltobeton duhet te mbahet akt-teknik, ku te pasqyrohen te gjitha te dhenat e kontrollit me pamje, matje e laboratori dhe te miratohet nga perfaquesuesit e investorit dhe firmes zbatuese, kur treguesit cilesore jane brenda kufijve te kerkuar nga projektuesi ose kushtet teknike.

13.5 Shtresa e reres

Shtresa me rere do te perdoret si shtrese absorbuese per shtrimin me pllaka betoni veteshtrenguese te trotuareve. Kjo shtrese absorbuese do kete trashesi maksimale $t=5\text{cm}$ dhe do vendoset para shtreses me pllaka betoni, sipas udhezimeve te Supervizorit. Procesi i punimeve perfshin perqatitjen e kesaj baze, ngarkimin, furnizimin e materialit, transportimin, nivelimin e shtratit me rere, sigurimin e kufizimeve te buzeve ne skajet e trupit te rruges, ngjeshjen dhe largimin e mbetjeve jashte kantierit ne perputhje me Planin e Menaxhimit Mjedisor.

Rera eshte nje perzierje e formuar prej grimcave te gurit natyror dhe/ose te thyer me madhesi deri ne 4 mm.

Gjatesia e bringes se vrimave katrore te sites, ne mm	Rere natyrore dhe/ose e thyer		
	0/1 mm	0/2 mm	0/4 mm
Fraksionet baze qe kalojne ne site, ne %			
0.075*	jo me shume se 10	jo me shume se 10	jo me shume se 10
0.25	30 deri 45	20 deri 35	12 deri 25
0.5	te pakten 75	45 deri 85	33 deri 70
1	te pakten 90	-	-
2	100	te pakten 90	te pakten 65
4	-	100	te pakten 90
8	-	-	100

Table 19 - Granulometria

* Procesi i lagesht i granulometrise

Granulometria e reres natyrore dhe te thyer Kerkesat mbi vetite e perzierjeve te reres jane dhene ne Tabelen meposhte:

Vetite e perzierjeve se grimcave te reres	Njesia e matjes	Zhavorr i thyer natyror		
		Rere	Silikat	Karbonat
		Vlera e kerkuar		
Grimcat deri ne 0.075, jo me shume se	%	5	5	10
Ekuivalenti i reres, te pakten	%	60	60	60
Permbajtja e argjiles, jo me shume se	%	0.5	0.5	0.5
Permbajtja e shtesave organike, jo me shume se	%	0.3	0.3	0.3

Table 20 - Vlerat e kerkuara mbi vetite e perzierjeve te reres

Kokrrizat e çakullit qe perdoret per prodhimin e reres se thyer duhet te kene rezistence te njetrajtshme ndaj thyerjes dhe konsumimit sipas metodes se Los Angeles, ne te njejten menyre siç kerkohet per perzjerjet e kokrrizave te gurit per grupet perkates te ngarkeses se trafikut. Fraksionet baze te reres qe perdoret per ShSLS jane dhene ne tabelen meposhte:

Fraksionet baze	Grupet e ngarkeses se trafikut				
	Shume e rende	E rende	Mesatare	E lehte	Shume e lehte
0/1	+*	+*	+	+	+
0/2	+*	+*	+	+	+
0/4	-	-	+*	+	+

Table 21- Fraksionet baze te reres qe perdoret per ShSLS ne varesi te ngarkeses se trafikut

* vetem rere e thyer

Per ngarkese te trafikut mesatar, te lehte dhe shume te lehte lejohet perdonimi i perzierjeve te pershtatshme te rerave te perziera (mikse).

14 KANALIZIMI I UJERAVE TE BARDHA

14.1 Te pergjithshme

Tubat Per Kanalizimet jane llogaritur per ngarkesa te renda, te brinjuar me SN-8.

Tubat do te furnizohen ne komplet se bashku me bashkuesit dhe shtesa te tjera te nevojshme

Kanalet e tubacioneve, shtratimi dhe mbulimi jane përshtuar ne kapitujt e tjere.

Perveçse modifikuar ose shtruar si ketu, te gjitha tubat brinjezuar do te plotesojne standartet kombetare dhe nderkombetare.

Çdo tub duhet te kete te shenuar ne te njejten menyrze permanente te dhenat me poshte:

Daten e prodhimit

Emrin e prodhuesit

Shenimi duhet te jete i trupezuar ne tub ose i shkruar me boje rezistente ndaj ujit.

14.2 Shtrimi ne kanal

Ne pergjithesi, tubacionet e brinjezuar shtrohen ne kanale, ne varesi te kushteve klimatike dhe te tokes ne nje thellesi e cila jepet ne projekt(Ne profilin gjatesor dhe terhor)

Karakteristikat gjelqjike te tokes dhe ngarkesa e trafikut ndikojne ne dimensionet e kanalit te tubit dhe ndikojne gjithashtu ne kapacitetin e ngarkeses qe mban tubi vete.

Gjeresia e tabanit te kanalit, kushtezohet nga diametri i jashtem i tubacionit si dhe nga domosdoshmeria e krijimit te nje hapesire pune te dystuar (hapesira minimale e punes). Duke ju permbajtur te dhenave te siperpermendura te gjatesise h dhe gjeresise, fundi i gropes duhet te krijoje kushtet optimale, qe linja te mbivendoset ne te gjithe gjatesine e saj. Mbishtrezimet duhet te ndahen mundesisht ne menyre te barabarte, duke eliminuar keshtu presionin e ushtruar prej tyre.

Tabani i kanalit nuk duhet te jete i shkriftezuar. Nese ky taban eshte i shkriftezuar, atehere duhet qe perpara vendosjes, ai te dystohet, shtypet ose te mbulohet me nje shtrese te posaçme. Edhe siperfaqet e shkriftezuara, por jo te forta duhet te ngjeshen.

Neqoftese kemi te bejme me siperfaqe shkembore ose gurore duhet qe fundi i kanalizimit te ngrihet te pakten 0.15 m dhe siperfaqja te mbulohet me nje shtrese pa gure (shih Projektin). Kesaj mund ti shtrohet rere, zhavorr i imet ose toke e paster dhe masa e krijuar ngjeshet.

Thellesia minimale e shtrimit zakonisht diktohet nga intersektimet me tubacioneve komunale ekzistuese (te ujit te rjetit Elektrik, telefonik, te ujrate te shiut etj). Ne rruget me trafik te rende nuk rekomandohet qe tubat te shtrohen me mbulim me te vogel se 1.0 m. Ne raste te tilla mund te propozohet nje veshje me beton.

Thellesia e lejuar e hapjes se seksionit te kanalit jepet ne projekt.

Duhet bere kujdes qe fundi i kanalit ku do te shtrohen tubat te jetë i rrafshet, pa gure dhe mjaft i forte. Ne qofte se ne germimin me eskavator kjo nuk sigurohet, atehere 20 cm-at e fundit duhen germuar me krah.

Kerkesat e meposhtme jane baze dhe duhen marre parasysh nese duam te shtrijme tubat brinjezuar ne perputhje me standartet;

- perdonimi i nje stafi te specializuar
- pajisja e mjaftueshme me mjete adekuate shtresuese
- mbikqyrje e vazhdueshme
- pranim i rregullt deri ne testin e sterilizimit
- perpilimi i dokumentacionit teknik/azhornimi

Vetem nese ka perputhje me keto kerkesa baze tubacioni i instaluar do te funksionoje ne menyre perfekte per aq kohe sa eshte parashikuar.

14.3 Mjetet shtruuese te tubacionit dhe perdonimi i sakte i tyre

Mjetet e permendura me poshte duhet te jene ne nje numer te mjaftueshem ne kantier

Veglat lubrifikante, mjete preres.

Vegla Pastruese perdoret per pastrimin e gotave, dhe kontrollimin per mbeshtetjen si duhet te gomines pas gotes.

Mjete preres.

Per prerjen e tubave te brinjezuar, disqe abrazive preres jane pare si me te pershatshmit.

Preres me gur zmeril dhe flete sharre mund te perdoren

14.4 Instruksionet e montimit

Hapat qe duhen bere perpara montimit:

Futni gominen brenda ne gote ne menyre te tille qe pjesa e forte e gomines te qendroje e mbeshtetur ne menyre te qendrueshme. Shtypeni gominen mire derisa te bindeni qe eshte pershatatur plotesisht.

Vendosja e gomines mund te lethesohet nepermjet shtypjes se saj ne dy pikat dhe duke e shtypur me pas ne te dy anet. Kufiri i brendshem mbrojtës nuk duhet te dale nga pjesa mbrojtëse e gotes.

Kujdes ne transportimin dhe levizjen e tubave, sepse mund te shkaktohen plasaritje te padukshme.

Tubat prodhohen ne gjatesi 6.0m (mund te behen edhe porosi te veçanta). Mund te priten kudo, midis bordurave, me sharra te zakonshme druri (dore ose mekanike, por jo me sharre zinxhir). Buza e prerjes pastrohet me lime druri ose vegla te tjera ferruese.

Shtrimi fillon nga pikë me e ulet. Kupa eshte mire te vihet ne drejtimin ngjites (Siper).Buza e tubit dhe kupes duhen pastruar me kujdes. Mbas kesaj guarnicioni special gome vendoset ne thellimin e dyte midis bordurave (numeruar nga buza e gypit). Duhet kontrolluar qe guarnicioni te kete zene vend mire ne thellim dhe te mos jete perdredhur.

Mbas kesaj siperfaqja e brendeshme e kuples lyhet me sapun ose me lendet e tjera te zakonshme, mandej tubi shtyhet brenda kuples me veglat e zakonshme, derisa te takoje. Nuk duhet terhequr mbrapsht fundi i tubit..

14.5 Testi Paraprak

Ky test kryhet para testit kryesor. Qellimi i testit paraprak eshte te ndaloje ndonje ndryshim ne volumin brenda linjes qe mund te shkaktohet nga presioni i brendshem, koha dhe temperatura, keshtu qe keto lexime qe do te merren menjehere ne testin kryesor pasues do te jape prova te qarta mbi saktesine e testit te seksjonit.

Mbas uljes se presionit dhe aty ku eshte e nevojshme zbrazje se tubacionit, eliminoni rrjedhjet ne lidhjet dhe korrigjoni ndryshimet ne pozicione.

Presioni i proves deri ne 10 Atm: 1.5×10

Presioni i proves mbi 10 Atm:

Kohezgjatja e proves se presionit: te pakten 12 ore

Testi (prova) kryesore

Kjo prove ndiek menjehere proven paraprake.

Presioni prove deri: 1.5×10^6

Presioni i proves mbi 10Atm: 10 + 5 bar

Kohezgjatia e proves: per DN de

ngā DN 200 6

© 2010 McGraw-Hill Ryerson Limited. All Rights Reserved.

Tubat e brinjëzit të do te mbanin me kujdes gjata gjithë kohës se prodhimit, transportimit ne vendim e punes dhe instalimit. Çdo tub do te inspektohet ne menyre te kujdeshshme sipas standardeve te kerkesave te specifikimit gjate dorezimit dhe perpara se te shtrihen. Asnjë tub i krisur, i thyer apo me difekt nuk do te perdoret ne veper. Demitim i pjeses fundore te tubave qe sipas Mbikqyresit te Punimeve mund te shkaktoje lidhje difektoze, do te jetë shkak i mjaftueshem per te hequr tubat e demtuar.

Tubat do te pastrohen plotesisht nga mbeturinat ne brendesi perpara se te instalohen dhe do te mbahen te paster ne perjegjesine e Sipermarresit deri ne marrjen ne dorezim te punimeve. Te gjitha kontaktet siperfaqesore te bashkimevedo te mbahen te pastra deri sa te kete perfunduar bashkimi, Do te merren masa per ndalimin e futjes se materialeve te huaja ne brendesi te tubave gjate instalimit. Ne tuba nuk do te vendosen, mbetje, vegla pune, rroba ose materiale te tjera.

14.7 Germimi dhe mbushja ne shkemb

Germimi dhe mbushja e instalimeve te kanalizimeve do te jene siç jane specifikuar ne Seksionin 2 (Germime dhe Punime Dheu) dhe seksionin 3 (Mbushjet dhe Mbulimet) te ketyre specifikimeve teknike.

14.8 Ndertimi i pusetave

Sipermarresi do te ndertoje puseten ne pozicionet dhe dimensionet e treguara ne projektin e Kontrates, ose siç udhezohet nga Mbikqyresi i Punimeve.

Pusetat do te lejojne hyrje per te bere inspektimin dhe pastrimin e kanaleve dhe do te jene vendosur ne pikë ku ka ndryshim te drejtimeve, ndryshime te madhesise se tubave, ndryshime te pernjehereshme te pjerresise.

Muret e pusetave do te ndertohen me beton te markes M 200, siç tregohet ne vizatimet.

Gjate gjithe gjatesise se pusetes do te ndertohet një kanal sipas aksit te tubacionit te kanalizimit per te percjelle ujerat bardha e te zeza nga një tubacion kanalizimi tek tjetri pa nderprerje te prurjes.

Gjate ndertimit te pusetes do te fiksohen ne muret e saj shkalle prej hekuri te galvanizuar me gjeresi vertikale dhe horizontale prej 300 mm. Hapja e vrimave ne mure mbas ndertimit nuk do te lejohet.

Pasi hapet gropë e pusetes, tokë duhet te perqatitet ne menyre qe te siguroje themelë te pershtateshme. Per kete arsyë tokë poshtë bazamentit te pusetes do te kompaktezohet. N.q.s tokë ekzistuese nuk siguron një bazament te pershtatshem atehere do te perdoret zhavorr dhe/ose beton M-200.

Pjesa e poshteme e pusetes eshte zakonisht prej betoni, me pjerresi drejt një kanali te hapur qe eshte zgjatje e kanalizimit me te ulet. Ky kanal duhet te jete i percaktuar shume mire dhe me thellesi te mjaftueshme ne menyre qe te parandalloje derdhjet e kanalizimeve te perhapen mbi fundin e pusetes.

N.q.s pusa eshte ndertuar ne një rrugë te pambaruar korniza e saj dhe kapaku mbulues (tip kompozit per KUB) nuk vendosen ne pusete, ndersa një pllake çeliku vendoset siper pusetes derisa rruga te asfaltohet.

Kapaket e pusetave dhe te puseve ne rrugë do te jene prej beton arme. Kapaket dhe kornizat do te parashikohen sipas hapesires drite te pusetes siç eshte treguar ne vizatime.

Kapaket do te vendosen ne nivelin dhe pjerresine perfundimtare te siperfaqes se rruges, ne rruget me asfalt, 20 mm me lart ne rruget e shtruara me makadam dhe 50 mm me lart ne rruget e pashtuara. Ne siperfaqet e hapura dhe fushat kapaku do te jete 500 mm mbi zonen rrethuese, ose siç percaktohet nga vizatimet ose udhezimet e Mbikqyresit te Punimeve.

Per linjen e Kanalizimit te Ujerave te Ndotura pusetat do te ndertohen ne trotuare. Ne rastet kur kemi mure majtes te tipit gravitar keto pusa do te ndertohen pas perfundimit te murit dhe skaji me i jashtem i tyre do te zevendesoj borduren e rruges sipas detajit perkates (kjo per shkak te dhembit te murit mbajtes i vendosur poshtë trotuarit).

14.9 Derdhjet e ujerave te bardha

Vendndodhja dhe kuota e shkarkimit te ujerave te ndotura do te jete siç tregohet ne vizatimet perkatese ose siç udhezohet nga Mbikeqyresi i Punimeve.

14.10 Pershkrimi i çmimit njesi te tubave per kanalizimet

Kostoja e germimit, mbulimit dhe transportit te tubave jane perfshire ne pershkrimin e çmimeve njesi qe lidhen me keto punime.

Furnizim i tubacioneve te te gjitha diametrave, mbajtja, shtrirja, furnizimi i te gjitha materialeve te nevojshme, veglave, paisjeve te kerkuara per shtrimin e tubave, fuqia punetore, pershtatesit, bashkuesit, izoluesit, prova e tubave, sigurimi dhe instalimi i shiritave me ngjyre, sheshimi i siperfaques, hekuri dhe armimi i tubave dhe te gjitha aktiviteteve siç pershkruhen me siper jane perfshire ne çmimin njesi per një meter tubacion kanalizimesh.

Matja: Linja e qendres se tubave brinjezuar do te matet ne meter linear nga faqja e brendeshme e pusetes ne faqen e brendeshme te pusetes pasuese pergjate aksit te tubit.

14.11 Pershkrimi i çmimit njesi per pusetat

Koston e germimeve, mbulimit, dhe transportit te inerteve, çimentos dhe hekurit e armimit, jane mbuluar ne çmimet qe lidhen me keto zera punimesh, prandaj, nuk perfshihen ne çmimin njesi per pusetat. Çmimi njesi per pusetat perfshin furnizimin e çimentos, inerteve, ujit, armimit shtratimit, aramturat, forcimi i bazamentit te pusetes, lidhja e tubacionit pjeset lidhese per lidhjen me hyrjet ne rruge, suvatimi i bashkueseve me llaç çimento, perzierja dhe hedhja e betonit, bankinat, furnizimi dhe instalimi i mbulesave te pusetave dhe sheshimi i siperfaques perreth, ngritja e materialeve .

15 VESHJET MBROJTESE (RIP RAP)

15.1 Te Pergjithshme

Keto punime perfshijne furnizimin dhe vendosjen e veshjeve mbrojtese sipas llojit dhe ne vendndodhjet e percaktuara, ne perputhje me kuotat dhe permasat e paraqitura ne projekt ose te dhena nga Inxhinjeri Mbikqyres.

Keto punime perfshijne vendosjen e veshje mbrojtese me thase rere-çimento ose me gure.

Kur eshte e nevojshme, keto punime perfshijne vendosjen e nje materiali filtrues prej guri te thyer ose te nje shtrese prej rrjete poshte gureve te veshjes mbrojtese tek elementet e meposhtem:

- Skarpatat e mbushjes
- Kanalet

15.2 Pershkrimi

Ne veshjet mbrojtese perfshihen shtresat filtruese, rimbushjet me zhavorr te drenazheve, veshjet me gure te rende te palidhur, veshjet me gure te lehte te palidhur, veshjet e realizuara me dore dhe veshjet me thase.

Materialet qe perdoren kryesisht per punimet e veshjeve mbrojtese jane, si me poshte:

- Skarpatat e mbushjes;
- Shtrojet prej jute ose pambuku;
- Agregatet e imet per veshjet mbrojtese me rere-çimento;
- Rrjetat filtruese plastike;
- Çimento Portland.

15.3 Materialet Baze

15.3.1 Germimet per Veshjet Mbroytese

Themeli per veshjet mbrojtese duhet germuar poshte kuotes se gerryerjeve te mundshme ose deri ne kuoten e treguar ne planimetrite (e projektit). Vendosja e gureve ose betonit nuk duhet te filloje para miratimit te themelit nga Inxhinjeri Mbikqyres. Germimet qe kryhen poshte kuotes se nderprerjes ndermjet skarpates qe duhet mbrojtur me tokes natyrore qe ndodhet prane ose dyshemeja apo faqet e pjerrta te kanalit duhet te klasifikohet, maten dhe paguhen si germim kanali. Gjithe germimi ose rimbushja mbi kuoten e vijes se nderprerjes se pershkruar me part si dhe gjithe faqja e skarpates qe ka nevoje per mbrojtje duhet te perfshihet ne çmimin e kontrates per llojin apo klasen e veshjes mbrojtese te parashikuara. Para vendosjes se shtreses mbrojtese, faqet e skarpates duhet te perbatiten ne perputhje me vijat dhe pjerresite e percaktuara.

15.3.2 Veshjet Mbroytese te Palidhura

Veshjet mbrojtese te palidhura duhet te vendosen ne ate menyre qe siguron kontakt ndermjet gjithe gureve me permaza relativisht te medha si dhe mbushjen e te gjitha boshlleqeve me material me te imet, duke siguruar ne kete menyre nje mase kompakte me granulometri te pershtatshme. Guret duhen

derdhur mbi skarpate ne ate menyre qe siguron arritjen me nje veprim te vetem te trashesise se caktuar te veshjes mbrojtese. Gjate derdhjes apo vendosjes (se gureve) duhet treguar kujdes per te mos demtuar materialin e shtreses se poshtme. Nuk lejohet vendosja e materialit ne shtresa paralele me faqen e skarpates. Per siperfaqet e perfunduara te veshjeve mbrojtese te palidhura lejohet nje tolerance prej 30 cm ndermjet faqes se skarpates dhe vijes se pjerresise.

15.3.3 Veshjet Mbroytese te Vendosura me Dore

Vendosja e gureve me dore behet mbi siperfaqet e perqatitura te skarpatare dhe ne trashesine e percaktuar nga Inxhinjeri Mbikqyres. Vendosja e veshjes mbrojtese duhet te filloje ne pjesen e poshtme te mbushjes me ane te germimit te nje transheje per vendosjen e nje shtrese te formuar prej gureve me te medhenj. Secili gur duhet te vendoset ne ate menyre qe te mbeshtetet mbi faqen e skarpates se mbushjes, dhe jo te mbeshtetet teresisht mbi guret e tjere qe ndodhen poshte, si dhe duhet te ngjeshet apo shtyhet plotesisht ne pozicion. Tek veshjet mbrojtese prej guret te vendosur me dore, faqja e ekspozuar e gureve duhet te kete ne varesi te formes dhe madhesise se gurit nje siperfaqe sa me te rrafshet, e cila nuk duhet te jete me teper se 10 cm prej siperfaqes se planit me pjerresi te percaktuar.

15.3.4 Cilesia e Materialit

Veshjet mbrojtese seleksionohen mbi bazen e permasave. Per nje diameter te dhene, permasat e gureve te tjere duhet te jene 50 % me te medhenj (ne peshe) dhe 50 % me te vegjel. Shpejtasia e rrjedhjes se ujit eshte zakonisht faktori percaktues per permasat e gurit. Veshjet mbrojtese ndryshojne ne permasa - nga disa centimetra deri tek trajtat e betonit te derdhur ne vend me permasa prej disa metrash. Shpesh veshjet mbrojtese perdoren se bashku me nje shtrese gjotekstili ose me rrjeta gabioni.

15.4 Metoda e Zbatimit

15.4.1 Te Pergjithshme

Para fillimit te punimeve, Kontraktori duhet te perqatise nje Plan te veçante mbi Shendetin dhe Sigurine e punimeve ne kantjer. Permbajtja e ketij plani duhet te marre ne konsiderate kerkesat e detyrueshme qe theksohen ne seksionin 3.5 "Metoda e Zbatimit" te ketij volumi.

15.4.2 Sigurimi i Materialit

Para fillimit te zbatimit te punimeve eshte e nevojshme qe Kontraktori te informoje Inxhinjerin Mbikqyres per llojet e te gjitha materialeve qe do te perdoren per kryerjen e ketyre punimeve dhe te paraqese deshmite e duhura mbi cilesine e tyre. Keto deshmi nuk duhet te jene me te vjetra se nje vit. Materiali qe nuk u perqigjet kerkesave te nevojshme duhet te eleminohet nga Kontraktori dhe shenohet veçazi.

15.4.3 Depozitimi i Materialeve

Nese para fillimit te punimeve nevojitet qe Kontraktorit te depozitoje perkohesisht materialet e kerkuara per kryerjen e tyre, atehere eshte e nevojshme qe per to te sigurohet nje hapesire e pershtatshme (depozitimi). Ne kete drejtim duhet te merren ne konsiderate udhezimet e shkruara te Prodhuesit te materialit perkates si dhe udhezimet e dhena nga Inxhinjeri Mbikqyres. Sasia e depozituar e materialeve duhet te jete e tille qe te siguroje nje zbatim te vazhdueshem (pa nderprerje) te punimeve.

15.4.4 Pergatitja e Bazes

Para fillimit te vendosjes se veshjes mbrojtese eshte e nevojshme qe siperfaqja perkatese e tokes te pergatitet ashtu siç duhet per t'u perputhur me kuotat dhe vijat e peraktuara. Gjate mbushjes se zonave ne depresion, materiali i ri qe vendoset aty duhet te ngjeshet me dore ose me ngjeshes mekanike.

Materiali i tepert duhet te vendoset brenda hapesires se shpronesimit dhe te shperndahet uniformisht ne kuadrin e punimeve te rastesishme.

Nese me poshte nuk shpjegohet apo kerkohet ndryshe, veshja mbrojtese duhet te vendoset tek shputa e kanalit te ndertuar mbi dheun natyror qe ndodhet perreth skajit te skarpates ne mbushje ose germim. Kontraktori duhet te sigurohet se shputa e kanalit ndodhet 600 mm ne brendesi te tokes natyrore dhe faqja e saj qe ndodhet prane me skarpaten ne mbushje ose germim eshte me te njejtën pjerresi. Mbas vendosjes se veshjes mbrojtese eshte e nevojshme qe Kontraktori te rimbushe shputen e kanalit dhe shperndaje uniformisht materialin e tepert brenda hapesires se shpronesimit ne kuadrin e punimeve te rastesishme.

15.4.5 Ndertimi

Vendosja e veshjeve mbrojtese me gure

Veshjet mbrojtese duhen vendosur brenda kufinjve te peraktuar ne planimetri ose sipas udhezimeve te Inxhinjerit Mbikqyres. Veshjet mbrojtese jane te klasifikuara, si me poshte:

- Veshjet mbrojtese te rrufshta (me gure);
- Veshjet mbrojtese me gure te hedhur;
- Veshjet mbrojtese me gure te lidhur (me llaç).

Veshjet mbrojtese te rrufshta (me gure)

Guret per veshjet mbrojtese te rrufshta duhet te vendosen ne vendin e tyre te peraktuar derisa te formoje nje shtrese kompakte me trashesi sipas projektit.

Toleranca e trashesise se shtreses duhet te jete deri ne plus 300 mm. Tolerancat poshte trashesise se shtreses nuk lejohen. Nese planimetrite nuk tregojne trashesine e shtreses, atehere trashesia e veshjes mbrojtese me gure duhet te jete te pakten 300 mm e trashe, por jo me teper se 600 mm e trashe.

Veshjet mbrojtese me gure te hedhur

Veshjet mbrojtese me gure te hedhur duhet te vendosen ne vendin e peraktuar, dhe duhet te formojne nje siperfaqe uniforme dhe me trashesine e specifikuar ne planimetri. Toleranca e trashesise se shtreses duhet te jete nga -150 mm deri ne +300 mm. Nese planimetrite ose propozimi i bere nuk specifikojne trashesine e shtreses, atehere kjo shtrese duhet te jete te pakten 600 mm e trashe.

Betoni i ricikluar mund te perdoret ne vend te gureve kur kjo gjë eshte treguar ne planimetri ose kur miratohet nga Inxhinjeri Mbikqyres. Betoni i ricikluar do te perdoret vetem ne rastin kur ai mbas perpunimit nuk permban çelik.

15.5 Projektimi i Filtrit

Filti eshte nje shtrese e perkoheshme zhavorri, guresh te vegjel, ose tekstili, e vendosur midis struktura dhe dheut nen te. Filtri parandalon largimin e grimcave te vogla te tokes permes boshlleqeve ne strukture, shperndan peshen e elementeve te koraces per te siguruar nje bazament me

uniform dhe lejon shkarkimin e tryrsnise hidrostatike ne brendesi te tokes. Filtri duhet perdorur ne te gjitha rastet kur veshjet me gure, tipi riprapi vendoset ne material jokoheziv, te prirur ndaj kullimit te konsiderueshem te nensiperfaqes (si per shembull, ne zonat ku nivelet e siperfaqes se ujtit luhaten ne menyre frekuente dhe ne zonat me nivele te larta uji tokesor).

15.6 Filtrat Kokrrizore

Instalimet tipike te veshjeve me gure, tipi riprapit perdorin filtra kokrrizore si shtrese te perkohshme midis veshje me gure, tipi riprapit dhe tokes nen te. Kjo shtrese duhet te perfshihet ne zerin “Mbushje Kokrrizore” qe gjendet ne kushtet specifike te standardeve. Gjereria e kerkuar e shtreses kokrrizore te mbushjes, e bazuar ne llojin e veshje me gure, tipi riprapit te caktuar nga MPPTT, eshte paraqitur ne tabelen meposhte:

Lloji i Veshje me gure, tipi riprapit	Trashesia e Filtrit me Mbushje Granulare (mm)
I modifikuar	150
Mesatar	150
Standart	300

Table 22 - Trashesia e Filtrit me Mbushje Granulare

15.7 Cilesia e Zbatimit

Para fillimit te punimeve, Kontraktori duhet t'i dorezoje Inxhinjerit Mbikqyres te gjitha deshmite mbi cilesine e materialeve baze qe do te perdoren per kryerjen e punimeve, ne perputhje me kerkesat e seksionit “Cilesia e Materialit” te ketij volumi.

Nese nuk ekziston ndonje marreveshje tjeter, atehere vetite e kerkuara mbi cilesine e materialeve baze duhet te mbeten brenda kufinjve te pranuar te kurbes granulometrike. Persa i perket veticne te pjeseve te veçanta, vlerat kufitare ekstreme te tyre duhet te specifikohen nga Inxhinjeri Mbikqyres.

15.8 Kontrolli i Cilesise se Zbatimit

Numri i testeve rutine per punimet duhet te percaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyres mbi bazen e dokumenacionit te paraqitur sipas kerkesave te dhena ne seksionin 10.6 “Cilesia e Zbatimit” te ketij volumi si dhe ne baze te progresit te punimeve.

Testet rutine minimale, qe duhen kryer nga Kontraktori duhet te perfshijne, si me poshte:

Testet per gurin e veshjes mbrojtese, çdo 100 m³;

Testet per rrjeten filtruese plastike, çdo 1,000 m²;

Testet per veshjen mbrojtese me thase rere-çimento, çdo 20 m³;

Testet per ujin, per çdo zone kantjeri.

Ne rast se gjate kryerjes se testeve rutine Inxhinjeri Mbikqyres do te vereje shhangje me te medha te rezultateve sesa ato qe jepen ne dokumenta, ose shhangje me te medha se ato te nxjerra prej testeve teknologjike paraprake, atehere ai mund te rrise numrin minimal te testeve rutine. Nga ana tjeter, ne rast te shhangjeve te njejtave, ai mund te zvogeloje numrin e testeve rutine.

Ne marreveshje me Inxhinjerin Mbikqyres, cilesia e punimeve mund te percaktohet gjithashtu edhe me anen e procedurave te miratuar. Ne kete rast, Inxhinjeri Mbikqyres duhet gjithashtu te percaktoje edhe numrin e testeve te kontrollit.

15.8.1 Testet e Kontrollit

Qellimi i kryerjes se testeve te kontrollit eshte garantimi i besueshmerise se procesit te pranimit te mostrave si dhe testimit te tyre, qe realizohet me anen e marrjes se mostrave dhe kryerjen e testimeve te pavarura nga punonjes, te cilet nuk jane zakonisht persegjegjes gjate procesit te kontrollit ose pranimit.

Numri i testeve te kontrollit, qe kryhen nga Punedhenesi, eshte zakonisht ne rapporti 1:4 me testet rutine. Vendndodhjet per marrjen e mostrave per testet rutine dhe ato te kontrollit duhet te percaktohet nga Inxhinjeri Mbikqyres me anen e metodes se perzgjedhjes se rastesishme. Ai gjithashtu mund te vendose mbi ndryshimin e numrit te testeve te kontrollit.

15.9 Matja dhe Marrja ne Dorezim e Punimeve

15.9.1 Matja e Punimeve

Keto punime duhet te maten per pagese ne meter kator te materialit te pranuar me trashesine e specifikuar. Matja e siperfaqes behet paralel me siperfaqen mbi te cilin eshte vendsur materiali. Rrjeta filtruese plastike duhet te matet mbi bazen e siperfaqes se veshjes mbrojtese, te vendsur (ne veper) dhe te pranuar. Nuk lejohet kryerja e matjeve te veçanta per rrjeten e mbivendosur tek vendbashkimet, fugat, ose seksionet vertikale tek shputa e skarpates. Gjithashtu, nuk lejohet kryerja e matjeve te veçanta per llaçin ose reren qe perdoret si jastek.

Kur thaset e mbushur jane me pak se dimensionet ne plan ose jane me gjatesi ose gjeresi te ndryshueshme, per te percaktuar sasite e pagueshme te tyre do te perdoren metera kator, nese permasat e per gjithshme jane me te madha se ato qe tregohen ne planimetri .

15.9.2 Marrja ne Dorezim e Punimeve

Punimet e kryera duhet te merren ne dorezim nga Inxhinjeri Mbikqyres ne perputhje me kerkesat e cilesise qe jepen ne keto rregulla teknike. Te gjitha mangesite e verejtura ne lidhje me keto kerkesa duhet te riparohen nga Kontraktori para vazhdimit te metejshem te punimeve. Kontraktori nuk ka te drejte te kerkoste asnjë lloj pagese per punimet qe nuk i persegjigjen kerkesave te cilesise se ketyre rregullave teknike (tejkalojne vlerat kuftare) dhe qe Kontraktori nuk i ka riparuar sipas udhezimeve te Inxhinjerit Mbikqyres. Punedhenesi ka te drejte ne keto raste te zgjase per te pakten pese vjet periudhen e garancise per te gjitha punimet qe varen prej punimeve te pariparuara.

16 PUNIMET ELEKTRIKE

16.1 Qellimi

Ky seksion mbulon dhenien e te gjitha specifikimeve per punimet elektrike qe perfshihen ne report. Cdo lloj ndryshimi i kerkuar nga Kontraktori ne lidhje me keto punime do te duhet te paraqitet per miratim tek Supervizori duke prezantuar te gjithe materialin e nevojshem si vizatime, specifikime etj. Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

16.2 Standartet dhe Normat Europiane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 14281	Sistemet e tubacioneve plastike per kanalet nentokesore (PVCu)
EN 61000	Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)
EN 61238	Kompresimi dhe lidhjet mekanike per kabllot e fuqise

Keto jane Norma dhe ligje te aplikueshme edhe ne Shqiperi

KERKESAT E PERGJITHSHME: normat ne reference do te zbatohen per kete seksion me shtesat dhe ndryshimet e specifikuara ketu.

Verifikimi i diemensioneve: Kontraktori do te behet i njojur me detaje mbi punen, verifikon dimensionet ne fushe dhe do te keshilloje mbikeqyresit apo perfaquesuesin e tij te ndonje mosperputhjeje para se te kryeje çdo pune.

16.3 Miratimet

Zerat ne listat e meposhtme do te miratohen nga Mbikeqyresi ose perfaquesuesi i tij.

Katalogu i te dheneve te prodhuesit:

- a. Kanalet e kabllove ne polietilen
- b. Shirit izolues
- c. Xhuntot e kabllove ne tension te larte
- d. Shirit rezistent ndaj zjarrit
- e. Strukturat elektrike
- f. Kornizat e pusetave dhe kapaket
- g. Lubrifikante kabllosh
- h. Kabllo te tensionit te ulet

- i. Kuti me bashkues per tension te ulet
- j. Kuti me kapikorda per tension te ulet
- k. Pllake tokezimi

Raportet e testeve:

- a Testi i rezistences se izolimit per kabllo te tensionit te larte dhe tension te ulet
- b Testi i vazhdueshmerise
- c Testi i potencialit i larte

Certifikatat:

Materialet dhe pajisjet: Sigurimi i nje deklarate te prodhuesit qe verteton se produkti i furnizuar perm bush ose te jekalon kerkesat e kontrates.

Kompetencat e punetorit: Per te kryer punen elektrike ne vend duhet te jete nje punetor profesional.

16.4 Produktet

Miratimi i nje produkti te ofruar jepet nga Mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij pas paraqitjes se nje mostre te pranueshme te secilit lloj.

MATERIALET DHE PAJISJET:

Materialet dhe pajisjet duhet te perputhen me specifikimet dhe standaret perkatese dhe te specifikimeve ketu. Te dhenat elektrike duhet te jene sic tregohet ne etiketen bashkangjitur. Materialet dhe pajisjet do te jene nje produkt standard i nje prodhuesi te angazhuar rregullisht ne prodhimin e e artikullit dhe ne thelb do te kopjoje artikuj qe kane qene ne perdonim te kenaqshem per te pakten 2 vitet e meparshme para hapjes se tenderit.

Tubat: Madhesia e tubave e treguar ne vizatim tregon diametrin e brendshem te tubit. Duhet te perputhen me sa vijon me poshte:

Tubat plastike dhe aksesoret duhet te jene polietilen dhe te perm bushin standartet DIN ose CEI.

Kabllot:

Madhesia e kabllove percjelles: Madhesia e kabllove percaktohet nga seksioni i tyre nominal dhe diametri i jashtem, i dhene ne mm^2 . Madhesite e tyre jane te dhena per percues bakri.

Sonda elektrike: Duhet te jete plastike dhe nje force terheqese minimumi 90 kg.

Sistemi i shperndarjes se kabllove ne tension te ulet do te jete ne perputhje me normat CEI. Percjellesit per instalime ne tuba polietileni duhet te kene izolim me gome ne perputhje me normat e aplikuara.

Lloji i izolimit duhet te jete kunder lageshtires dhe nxehtesise, i afte te duroje nje temperature 90 grade celsius gjate punes.

Kodi i ngjyrave: Sigurimi i kodit te ngjyrave per te gjitha kabllot e tensionit te ulet si ne vijim:

Faza 1	- e zeze
Faza 2	- e zeze
Faza 3	- ngjyre kafe
Neutri N	- blu e lehte
PE Mbrojtës(Toka)	- te verdhe / te gjelber

Kabllot e tokezimit: Kabllot e izoluar duhet te jene te veshur me perberes elektrometrik me termoplastik poshte veshjes, verdhe/jeshil dhe do te izolohet per ti ngjare percjellesve te fazes, pervec mese kabllot vleresohen jo me shume se 750 volt. Alumini nuk eshte i pranueshem.

Bashkimet dhe kapikordat e kabllove sekondare 600 volt duhet te sigurohen mekanikisht. Bashkimet do te mbulohen. Te vidhosen ose te kompresohen me aliazh metalik sipas miratimeve per perdorimin e percusit te bakrit..

Bashkimet: Te behen bashkime kabllosh ne vende qe jane te aksesueshme me vone. Ne cdo vend tjeter nuk lejohet.

Elektrodat e tokes: Shufra eshte tip kryq e galvanizuar dhe ka nje prifil 50x50x5mm dhe nje gjatesi 1,5m.

Etiketa kabllosh ne puseta: Te vendosen etiketa kabllosh per te identifikuar tensioni ne qark, burimin dhe rrugen.

16.5 Zbatimi

INSTALIMI:

Demi i kontraktorit: Kontraktuesi do riparoje menjehere te gjitha linjat e sherbimeve (elektrike, kabllo telefoni, tuba uji, tuba kanalizim etj) ose sisteme te demtuara nga veprimet e tij. Demtimet e linjave apo sistemeve nuk te patreguara, te cilat jane te shkaktuara nga operacionet e tij do te riparohen me shpenzimet e tij.

Tubat e kabllove:

Tubat do jene polietileni dhe te drejte

Lidhjet ne puseta: Gropa e inspektimit do te kete 3 vrima rrethore ne muret anesore te parashikuara per futjen e fundit te kanalit kabllor.

Mbishkrimi i punimeve te fshehura dhe shiriti identifikues: Siguroni nje kasete alumini te detektueshme me shirit mbeshtetes plastik ose kasete plastike magnetike te detektueshme te prodhuan posacerisht per punimet e fshehura. Siguroni shirita rrumbullake, me gjeresi 5 cm, me ngjyre te dallueshme per te qene me te dobishme.

Terheqja e kabllove: Kabllot do te terhiqen avash avash per ne piken e furnizimit ne pusete ose struktura te nje niveli me larte. Do te perdoren kabllo fleksibel per ti fututr ne vrimat e pusetes dhe ne rruget e kabllove.

Kabllot do te jete ne nje dell pa bashkime midis lidhjeve me perjashtim ku distanca kalon gjatesise ne te cilat kabllo eshte i lirshem.

Kthesat e kabllove duhet te jene jo me pak se ato te specifikuara nga prodhuesi per llojin e kabllit te specifikuar.

Aty ku kablli eshte nxerre te lihet nje shtese e konsiderueshme per te bere nje lidhje te mevonshme.

Lubrifikantet: Per te ndihmuar ne terheqjen e kabllove te veshur prej gome duhet te perdoren keto lubrifikante nga prodhuesi i kabllove.

Tensioni i kabllove te terhequr nuk duhet te kaloje maksimumin e percaktuar nga fabrika.

Instalimi i kabllot ne pusetave: Kabllot nuk do te instalohen duke shfrytezuar rrugen me te shkurter, por duhet te kalojne ne keto mure per te siguruar rrugen me te gjate dhe te gjatesine rezereve maksimale te kabllove. Çdo kabell duhet te identifikohet nga tabela metalike rezistente ndaj gerryerjes dhe e bashkangjitur ne secilen strukture nentokesore te miratuar nga mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij.

Pusetat:

Te pergjithshme: Pusetat do te jene te llojit te treguar vizatime dhe ne perputhje me detajet e aplikuara sic tregojet. Ne zonat e pashtuara, pjesa e siperme e kapakut te pusetes do te jete ne nje hapesire te caktuar me larte klasen e perfunduar (ne varesi te lartesise se siperfaqes).

Kapikordat e kabllove: Mbroni kapikordat e perçellesace te kabllove te fuqise se izoluar nga kontaktet aksidentale, perkeqesimi i mbuleses, dhe lageshtira. Vendosni kapikorda duke perdonur materialet dhe metodat e treguara ose specifikuara ketu apo siç percaktohet me udhezim me shkrim te prodhuesit te kabllove dhe prodhuesit te kapikordave.

Tokezimi: Pjeset metalike se bashku me te gjitha pjeset elektrike duhet te tokezohen.

Tokezimi i shtyllave te ndricimit: Bazat e shtyllave te ndricimit duhet te lidhen te nje pjese metalike me sekzion 16 mm^2 .

16.6 Testet:

Si perjashtim nga kerkesat, qe mund te jene deklaruar diku tjeter ne kontrate, mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij do tu jepen me 5 dite kohe te pune paraprake per çdo test. Kontraktori duhet te siguroje te gjithe punen, pajisjet dhe materialet e kerkuara per testet.

Shufrat e tokezimit: Testoni shufrat e tokezimit per vleren e rezistences nese jane te aplikueshme para se ndonje tel te jete i lidhur. Matjet e rezistences se tokezimit do te behet ne mot zakonisht te thatë, jo me pak se 48 ore pas reshjeve.

Raporti i testeve: Elektrodat e tokezimit: Identifikimi i elektrodave per çdo prove, si dhe rezistencen dhe kushtet e tokes ne kohen qe matjet jane bere.

16.7 Shperndarja e brendshme dhe instalimi i fuqise

16.7.1 Te per gjithshme

REFERENCAT:

Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

Normat dhe ligjet e aplikueshme ne Shqiperi

Standartet dhe Normat Europejane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 50085	Sistemi i kanalit te kabllove dhe sistemi i kanalinave te kabllove per instalimet elektrike
EN 50086	Sistemi i tubave per menaxhimin e kabllove
EN 50102	Shkallet e mbrojtjes te dhena nga mbylljet per pajisjet elektrike kunder ndikimit te jashtem mekanik
EN 50298	Mbyllja e rrethimeve per automatet e tensionit te ulet dhe te kontrollit te shpejtesise
EN 50310	Aplikimi i lidhjes ekvipotenciale dhe tokezimit ne ndertesa me pajisje te teknologise se informacionit
EN 50334	Shenim me mbishkrim per identifikimin e berthamave te kabllove
EN 60309	Tapa, priza dhe kapake per qellime industriale
EN 60.423	Tuba per qellime elektrike
EN 60529	Shkallet e mbrojtjes nga rrethimet (kodi IP)
EN 60.669	Celesat per perdom te brendshem dhe instalimeve elektrike te ngashme fiks
EN 60865	Llogaritja e efekteve te rrymes ne qark te shkurter
EN 60947	Automatet e tensionit te ulet dhe kontrolli i shpejtesise
EN 61537	Sistemet e kanalinave te kabllove dhe sistemet e kanalinave lider per menaxhimin e kabllove
EN 61543	Pajisja mbrojtese e rrymes vepruese te mbetur (RCD)
EN 61000	Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)

16.7.2 Produktet

Karakteristikat teknike

Tela dhe kabllo duhet te plotesojne kerkesat e aplikueshme per llojin e izolimit, veshjes, dhe specifikat e perçuesve ose te shnuara. Telat dhe kabllot prodhuar me shume se 12 muaj para dates te dorezimit ne vend nuk duhet te perdoren.

Perçesit: Perçesit duhet te jene solid ose komponimi sipas seksionit kryq. Te gjithe perçesit do te jene prej bakri. Nese nuk tregohet ne menyre specifike ose te jete kerkuar nga prodhuesit e pajisjeve.

Madhesia minimale e percjellesit : Madhesia minimale per qarqe te deges do te jete $1,5\text{mm}^2$ per ndriçim dhe $2,5\text{ mm}^2$ per qarqet e tjera te tensionit te ulet dhe $0,8\text{ mm}^2$ per telekomunikacion.

Kodi i ngjyres: Sigurimi per sherbimin, ushqyes, dege dhe percjellesit e telekomunikacionit. Ngjyra per kabllot e tensionit te ulet do te jete:

- Faza 1 - zeze
- Faza 2 - zeze
- Faza 3 - kafe
- Neutri N - blu e lehte
- PE mbrojtes - verdhe / gjelber

Izolimi

Neqoftese nuk specifikohet ose te shenohet perndryshe kabllot e fuqise ndhe ndricimit do te jene 1/0,6kV perveç qarqeve te sinjaleve dhe elektronike.

Bashkuesit dhe kapikordat

Bashkuesit per kablo me sektion 6mm² dhe me te vegjel do te izolohen, te tipit te presuar ne perputhje me kthesat lidhese te gershetimit.

Kapaket

Te behet sigurimi i nje-cope pajisjeje kapak per deget qe i pershtaten nje pajisjeje te instaluar. Per kutite-priza metalike, kapaket ne mure te paperfunduara do te jene flete prej çeliku te veshura me zink apo metali te hedhura qe kane pjerresi te rrumbullaket. Per kuti jo-metalike dhe pajisje, kapake te tjera te pershtatshme mund te ofrohen. Vida do te jete te tipit makine me kokat qe ne ngjyre te perputhen me ate te kapakut. Kapaket e pajisjeve te tipit seksional nuk do te lejohen. Kapaket e instaluar ne vende me lageshti, do te jene te kene rondele dhe do te shenohen per "vende me lageshti."

16.8 Ndrizimi i Jashtem

16.8.1 Te pergjithshme

REFERENCAT:

Publikimet e listuara me poshte formojne nje pjese te ketij specifikimi ne formatin e zgjatur te referencave. Publikimet jane referuar ne tekst vetem si perkufizime.

Normat dhe ligjet e aplikueshme ne Shqiperi

Standartet dhe Normat Europiane:

IEC 60364	Zhvillimi i instalimeve ne tension te ulet
EN 12464	Drita dhe Ndrizimi ne hapesira pune
EN 12665	Light an lighting-basic terms and criteria for specifying lighting requirements
EN 60598	Ndrizuesit
EN 61000	Perputhshmeria elektromagnetike (EMC)
DIN VDE 0710	Ndrizuesit me tension pune me poshte se 1000 V
Siguria EU: EN 60598-1, EN 60598-2-1, IEC/EN 60825-1	
EU EMC: EN 55103-1, EN 55103-2, EN 61000-3-2, EN 61000-3-3	
Siguria US (Modeli US): UL 1598	
Siguria Kanadeze (Modeli US): CAN/CSA C.22.2 No. 250	

KERKESAT E PERGJITHSHME: normat ne reference te zbatohen per kete sektion, me shtesat dhe ndryshimet e specifikuara ketu.

MIRATIMET:

Te dhenat, vizatimet dhe raportet do te punesojne terminologjine, klasifikimet, dhe metodat e pershkruara nga normat CEI si te zbatueshme, per sistemin e ndriçimit te specifikuar.

Katalogu i te dhenave te Prodhesit: Kur te dhenat qe pershkruajne me shume se nje lloj, madhesi, model apo ze jane miratuar, shenoni se cili lloj, madhesi , model apo ze eshte ofruar.

Te dhenat do te jene te mjaftueshme per te treguar konformitetin me kerkesat e specifikuara.

- a. Ndricuesit
- b. Shtyllat

Vizatimet:

- a. *Ndricuesit:* Perfshirja e dimensioneve, pajisjeve, dhe detajet e ndertimit te instalimeve. Vizatimet do te shoqerohen me te dhenat fotometrike, duke perfshire te dhenat ne Lumen per cdo zone, rapporti mesatar dhe minimal, duke perfshire diagrama dhe te dhena te shperndarjes te kompjuterizuara.
- b. *Shtyllat:* Perfshirja e dimensioneve, devijimi i shtylles nga era, klasa e shtylles dhe informacione te tjera.

Raporti i testeve:

- a. Ndricuesit:
 - (1) Niveli i ndricimit horizontal i konpjuterizuar in luxne nivelin e tokes, i percaktuar cdo 15m. Duke perfshire dhe nivelin mesatar te ruajtur te reportin maksimal/minimal.
 - (2) Te dhenat ne shperndarje sipas klasifikimi CEI

Raporti i Testeve: Miratoni rezultatet e testeve sic thuhet ne paragrafin e titulluar "TESTET".

16.8.2Produktet

Miratimi i nje produkti te ofruar jepet nga mbikeqyresi ose perfaqesuesi i tij pas paraqitjes se nje mostre te pranueshme te secilit lloj.

TELAT DHE KABLLOT: Telat dhe kabllot do te plotesojne kerkesat e aplikueshme per llojin e izolimit, veshjes, dhe percjellshmerine e specifikuar ose treguar. Telat dhe kabllot e prodhuar me shume se 12 muaj para dates se dorezimit te saj ne vend nuk do te perdoren.

Kodi i ngjyrave: Sigurimi i kodit te ngjyrave per te gjitha kabllot e tensionit te ulet si ne vijim:

Faza 1	- e zeze
Faza 2	- e zeze
Faza 3	- kafe
Neutral N	- blu e lehte
PE mbrojtës(Toak)	- te verdhe / te gjelber

BASHKIMET DHE KAPIKORDAT E KOMPONENTEVE:

Bashkuesit per kabllo me seksion 6mm² dhe me te vegjel do te izolohen, te tipit te presuar ne perputhje me kthesat lidhese te gershetimit. Te gjithe terminalet e percuesve do te pajisen me kapikorda.

Celesat me shkeputje: Te sigurohen celesa deviat dhe inverter aty ku duhet. Celesat e siguresave duhet te perdonin mbajtese siguresash te pershtathme, vetem neqoftese tregohet ndryshe.

PANELET:

Panelet perdoren per te shkeputur tensionin ne pajisje. Panelet do te jene te pajisur me automate perveç nese tregohet ndonje menyre tjeter. Dizajni duhet te jete i tillë që automatet individuale mund te hiqen pa shqetesuar njesite ngjitur ose pa humbur ose hequr izolimin shtese furnizues si mjet per te marre aprovimet siç kerkohet nga UL. "Vendosja specifike e automateve" ne panele eshte e nevojshme per ta krahasuar me vizatimin dhe per te gjetur secilen zone qe ai i perkjt. Perdonimi te "automateve ushqyes" nuk eshte i pranueshem nese nuk tregohet ndryshe ne menyre specifike. Çelesi kryesor do te jete "me vete" i montuar mbi ose nen automatet e tjere. Panet do te mbyllen me celesa. Ne skema mund te shikohet ngarkesa per cdo zone. Gjithashtu aty mund te shikohet edhe sesi shperndahet ngarkesa nga paneli. Keto skema duhet te jene afer kuadrit i cili duhet te kete kapak transparent. Automatet do te jene te gjithe te etiketuar dhe te shenuar.

Llampat sinjalizuese: Do te perdoren llampa LED per sinjalizim ne panel

16.8.3Zbatimi

INSTALIMI: Instalimet elektrike ne kerkesat e specifikuara ketu.

Sherbimi nentokesor: Perçesit e sherbimit nentokesor dhe tubat do te jene te vazhdueshem nga pajisjet hyrese te pajisjet e sistemit te energjise.

Vendet e rrezikshme: Puna ne vende te rrezikshme, do te kryhen ne pajtim te plote me "Klasen", "Divisionin", dhe "Grupin" e vendeve te rrezikshme te perfshira.

Identifikimi i sherbimit te hyrjes: Pajisjet e shkeputjes se sherbimit hyres, celesat, dhe rrëthimet do te etiketohen te identifikohen si te tillë.

Etiketat: Kudo ku ka me shume se nje pajisje shkeputese ne rrëthime te ndryshme, secila mbyllje, e re dhe ekzistuese, do te etiketojet si nje nga disa rrëthimet qe permajne sherbimin e pajisjeve qe shkeputin hyrjet. Etiketa, minimumi, duhet te tregoje numrin e pajisjeve shkeputese te sherbimeve te strehuara me mbyllje dhe do te tregoje numrin e pergjithshem te rrëthimit qe permajne pajisje shkeputje te sherbimit.

Tubat e instaluar ne pllaka betoni: Gjeni menyren qe te mos ndikoje negativisht ne fuqine strukturore te pllakave. Instalon tuba brenda mesit te nje te tretes se pllakes se betonit. Hapesira e tubave horizontalisht jo me afer se 3mm, perveçse se ne panelet. Pjeset e lakuara nuk do te jene te dukshme siper pllakave.

Kutite shperndarese: Te ndertohen minimalisht ne madhesine e kerkuar, pervecse aty kur kutite jane metalike dhe ka kerkese te vecante ne funksion te vendit ku instalohen. Mbulesa e ketyre kutive te fiksohet me vida. Kur disa linja kalojne ne te njejtën kuti ato duhet te jene te etiketuara me numrin e qarkut perkates, karakteristikat elektrike dhe panelin ku shkon.

Identifikimi i percjellesave: Siguroni identifikim e percjellesave kudo ku eshte bere bashkim ose eshte vene kapikorde. Per percjellesat do te perdoret kodi i ngjyres se fabrikes, neqoftese nuk eshte me ngjyre do te kete veshje plastike, shenim bashkangjitur, ngjyre najloni dhe me pllake. Identifikimi i fundit te kabllove.

Bashkimet: Beni bashkime ne vende te aksesueshme. Bejini ato me metodat e duhura dhe izolojini me materialet e duhura.

Nderhyrjet elektrike: Nderhyrjet elektrike ne zonat e instalimeve qe jane te mbrojtura kunder zjarrit sic jane nderhyrjet ne dysheme, tavane do te behen me material qe ndalojne kalimin e zjarrit nga njeri vend ne tjetrin sipas zones ku aplikohet.

Tokezimi dhe lidhjet e tokezimit: Duhet te tokezohen te gjithe suportet metalike qe mbajne kanalinat metalike, panelet, cdo pjese metalike, sistemi telefonik si dhe sistemi i tokezimit te rrjetit elektrik. Kur kemi veprim te mbrojtjes elektrike, duhet te sigurohem qe lidhja e tokes dhe neutrit nuk eshte shkeputur, por vazhdon te jete ne gjendje pune.

Pajisjet lidhese: Siguroni instalime elektrike per lidhjen e pajisjeve te kontrollit sipas standarteve.

16.9 Produktet e Ndricimit

Ndricuesit e perdonor:

Tipi 3_Ndricues rrugor LED

- Ndricues i montuar ne shtylle (8.8 m) qe mund te aplikohet ne rruge urbane dhe rezidenciale, ne rruge bicikletash dhe kembesoresh, ne rruge te vogla te ndryshme
- Instalim i lehte
- Kosto te ulet fillestare
- LED
- Shkalle mbrojtje IP 67 IK08
- 3000K
- 100000 h
- Fuqia 71W
- 220-240 V / 50-60 Hz

Rezistent ndaj rrezeve UV

- Shtylla e perdonor per montimin e ndricuesve shtylllore.

Shtylle celiku 100, ne ngjyre argjendi. Me dritare inspektimi alumini (191x55mm), e pajisur me 2 mbajtese siguresash mbrojtese, 2 siguresa, 16A, bllok terminal e levizshem 4 polar. Me vreme per kalimin e kabllit furnizues. Pershtates kablli Ø60 mm. Per versionin me baze, 4 prizhoniera te gjate te ngulen ne toke, duhet te blihen bulona dhe kapake ose ne rastin e fiksimit te saj ne beton duhet te parapergatitet bazamenti dhe hyrja e kabllove ne shtylle.

Shenim: Para se te zgjidhni shtyllen e pershatshme, do behen te gjitha testet e rezistences nga era, bazuar ne ligjet dhe rregullat e vendit ku do te instalohet shtylla ne baze edhe te standarteve EN 40-03-1. Nje mbrojtje ose izolim sa me i pershatshem dhe sa me i sakte te

siperfaqes se perfshire eshte e rekomanduar per te shmangur cdo kontakt direkt me ndertimet e reja ose betonet e vjetra. Lartesia e shtylles 4.5m.

Aksesoret e montuar ne shtylle:

- Kasa mbrojtese: 6 mm. Lesh xhami i perforuar me poliester.
- Supori : Alumin i derdhur me pole lidhese te perbera gjithashtu nga alumin i derdhur.
- Shtylla e dizenuar per ndricues te jashtem: Celik Ø100 me ngjyre argjendi. I kompletuar me dritare inspektimi me shirit fundor te levizshem. Versioni me baze vjen i kompletuar me plinta, e shtiza tokezimi per tu groposur, dado bulona dhe kapese.
- Plake ndricimi qe montohet direkt ne mur.

16.9.1Zbatimi

INSTALIMI: Duhet te permbojti kerkesat e specifikimeve. Shtyllat e celikut: Siguronit beton per perforuar ne bazen e shtylles. Beton per bazen, tuba polietileni, dhe shufra tokezimi duhet te jene sipas specifikimit me seksion "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE".

TOKEZIMI: Te tokezohen te gjitha pajisjet metalike sic permendet ne seksionin e "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE" aty ku percjellesi i tokes eshte lidhur me nje metal tjeter pervec bakrit, te sigurohet nje lidhje e pershtatshme e trajtuar vetem per kete qellim.

TESTET: Kontraktori duhet te siguroje energjine e nevojshme qe te behen testet.

Testet ne pune: Pasi te mbaroje instalimi, vendosni pajisjet ne pune per te treguar qe pajisjet punojne ne perputhje me standartet.

Testi i izolimit te rezistences: Te behet si ne specifikimet e "PUNET ELEKTRIKE NENTOKE" , ne te dyja rastet edhe para edhe pas lidhjes dhe fiksimit te pajisjeve.

17 SINJALISTIKA RRUGORE DHE ELEMENTET E SIGURISE SE TRAFIKUT

Zhvillimet bashkekohore ne rrjetin rrugor urban dhe interurban si dhe fenomenet e dukshme qe jane konstatuar, e bejne te domosdoshem realizimin e nje manuali per aplikimin konkret te sinjalizimit rrugor ne tere gamen e tij.

Hartimi i manualit te sinjalizimit rrugor, eshte mbeshtetur ne legjislatacionin ne fuqi :

- Ligjin Nr. 8378, date 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise”
- Vendimin Nr. 153, date 07.04.2000 te Keshillit te Ministrave, “Rregullore per Zbatimin e Kodit Rrugor”
- Konventa “Mbi shenjat dhe simalet e rruges“ e dates 8 Nentor 1968.

Manuali i Sinjalizimit Rrugor do te sherbeje :

- Si akt normativ i detyrueshem per te gjithe entet pronare te rrugeve si dhe per subjektet projektuese e zbatuese te sinjalizimit rrugor.
- Per studimin dhe hartimin e projekteve te sinjalizimit rrugor si dhe per mireadministrimin e sinjaleve rrugore;
- Per zbatimin ne praktike te kerkesave te sinjalizimit rrugor;

Duke ju referuar numrit te madh te aksidenteve te cilat kane ardhur si rezultat i mos respektimit te rregullave te sinjalizimit rrugor te perkohshem gjate punimeve ne rruge apo dhe mos vendosja e ketij sinjalizimi ne rastin e aksidenteve rrugore ne rruget urbane dhe interurbane edhe per shkakun e mosnjohjes se ketij sinjalizimi rrugor si dhe skemave shoqeruese per miremenaxhimin e trafikut rrugor gjate punimeve ne rruge, u konsiderua e nevojshme perfshirja ne kete manual dhe i rregullave te sinjalizimit te perkohshem rrugor, per te ndihmuar entet pronare te rrugeve te menaxhojne integralisht trafikun rrugor duke shmangur aksidentet rrugore gjate punimeve ne rruge si dhe efektivat e policise rrugore ne vendndodhjen e aksidentit.

17.1 Sinjalizimi vertikal

17.1.1 Te pergjithshme

Sinjalet vertikale, si ato te rrezikut, urdheruese ose treguese duhet te kene ne pjesen e perparme te dallueshme nga perdoruesit e rruges, formen, permasat, ngjyren dhe karakteristikat, ne perputje me normat e rregullores se zbatimit te Kodit Rrugor dhe sipas figurave e tabelave qe jane pjese plotesuese e saj.

17.1.2 Rregullimi

Ndalohet perdorimi i sinjaleve te ndryshem nga ata qe percakton rregullorja, me perjashtim te rasteve te autorizuara nga Ministria qe mbulon Transportin, Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurise Rrugore.

Mund te mbeten ne perdorim sinjale te vendosur qe paraqesin vetem shhangje te vogla nga ato te parashikuara, me kusht qe te garantohet dukshmeria (si diten e naten) dhe instalimi i pershtatshem (neni 75/5).

Çdo zevendesim duhet, sigurisht, te kryhet ne sinjale krejt te rregullt

Ne anen e mbrapme te sinjalit, me ngjyre te mbyllur duhet, ne menyre te qarte, te tregohet:

- Enti ose administrata pronare e rruges;
- Marka e firmes qe ka prodhuar sinjalin;
- Viti i prodhimit;
- Numri i autorizimit te Ministrise qe mbulon Transportin, per prodhuesin e sinjaleve rrugore.

Keto te dhena nuk duhet te zene me shume se 200 cm².

Per sinjalet e perershme duhet shenuar edhe ekstremet e renditjes gjate vendosjes

17.1.3 Vendosja

Sinjalet vertikale vendosen, si rregull ne anen e djathje te rruges

Gjithashtu mund te vendosen edhe

- ne ishujt trafikndares;
- siper karrekhates;
- te perseritura ne anen e majte te rruges;

Per motive te sigurise ose ne rast se eshte parashikuar ne menyre te veçante nga rregullat per sinjalin.

Sinjalet, qe vendosen ne buze te rruges (sinjalet anesore) distancen midis buzes vertikale nga ana e rruges dhe buzes se trotuarit ose anes se jashtme te bankines, duhet t'a kene :

- Minimumi 30 cm;
- Maksimumi 100 cm.

Pranohen distanca me te vogla, kur kjo kushtezohet nga hapsirat, me kusht qe sinjali te mos dale mbi karrekhate

Mbajteset e sinjaleve duhet te fiksohen ne distance jo me te vogel se 50 cm nga buza e trotuarit ose nga ana e jashtme e bankines

Ne prani te barrierave metalike, mbajteset mund te vendosen tek ato, me kusht qe sinjali te mos dale me shume se vete barrierat

Lartesia nga toka, duke kuptuar lartesine e fundit te sinjalit ose panelit plotesues me te ulet duhet te jetë, me perjashtim te sinjaleve te levizshem :

- minimumi 60 cm;
- maksimumi 220 cm.

Ne rruget urbane, per kushte ambienti te veçanta, sinjalet mund te vendosen edhe ne lartesi me te medha, sidoqoftë jo me shume se 450 cm

Ne rruget urbane, ne trotuare ose rruge te rezervuara per kembesore, duhet te kene nje lartesi min.220cm, me perjashtim te paneleve semaforike

Ne pjese uniforme te rruges sinjalet duhet te vendosen, sa te jetë e mundur, ne lartesi te njejtë

- Vendosja ne variantin e levizshem ose me karakter te perkohshem, mund te lejohet ne rast te :-motiveve te vertetuara te punimeve;
- situatave emergjente te ambientit;
- situatave te veçanta te trafikut;
- kantjereve rrugore;
- paisjeve te punimit, fikse ose te levizshme.

17.1.4 Guardrails (barrierat metalike)

Te gjitha materialet e perdorura per guard rail (shinat mbrojtese) duhet te gezojne karakteristikat e projektura mekanike ose karakteristikat sipas vizatimeve perkatese.

Gjithashtu nese Kontraktori propozon materiale apo tipe te tjera Guard Raili keto mund te vihen ne zbatim vecse pas paraqitjes prane Supervisionit te te gjitha materialeve te nevojshme dhe pas marrjes se aprovimit te tij.

Cilesia e materialeve

Per te gjithe materialet duhet te kryhet mbrojtja e duhur kunder korrozionit.

Aksesoret per fiksimin e shinave mbrojtese duhet te permbushin me perpikmeri funksionin e tyre sipas projektit gjate gjithe periudhes se perdorimit duke bere te mundur edhe zevendesim ekonomik te tyre.

Materialet baze

Guard rail (Shinat mbrojtese) konsistojne si me poshte

- shinat dhe pjeset skajore;
- shtyllat mbajtese dhe distancatoret;

- aksesoret per montim (Shufrat, dadot, rondelat, pllakezat lidhese)

Shinat dhe pjeset skajore mund te prodhohen nga:

- metali (llamarina çeliku ose alumini);
- betoni;
- materiale te pershtatshme plastike te perfokuara sipas kerkeses.

Per binaret dhe pjeset skajore kryesisht perdoret llamarina metalike te profiluara.

Ne parim mbajtesit dhe ruajtesit e distancave duhet te prodhohen sipas nje profili te caktuar metalike(I, U, C). Aksesoret per fiksim duhet te realizohen nga materiale te tilla te cilet jane ne pajtueshmeri me te dy materialet qe bashkohen.

Ne varesi te rrethanave, guard rails (shinat mbrojtese) mund te jene:

- shina njeaneshe (ne njeran ane te shtylles mbajtese);
- shina te dyaneshe (ne te dy anet e shtylles mbajtese).

Shinat mund te montohen ne:

- direkt tek shtyllat mbajtese;
- indirekt nepermjet distancatoreve.

Shinat mund te jene te vetem ose ne raste te veçante te dyfishte (njeri mbi tjetrin ne te njejtin mbajtes).

Metoda e realizimit te punimeve

Shinat mbrojtese duhet te vendosen ne menyre qe:

- skaji i siperm i shines te jete 0.75 m mbi nivelin e trasese se rruges;
- pjesa ballore e shines duhet larguar nga skaji i trasese se rruges jo me pak se 0.5 m;
- hapesira midis mbajtesve eshte:
- jo me pak se 4 m ne nje prerje te hapur;
- jo me pak se 2 m ne nje strukture

17.1.5 Dukshmeria e sinjaleve

Per nje dukshmeri sa me te mire te sinjaleve duhet te garantohet hapesire pa pengesa midis drejtuesit dhe sinjalit.

Proçesi logjik qe kalon drejtuesi, duhet te jete :

- perceptimi i pranise se nje sinjali;
- lidhja logjike me sinjalizimin rrugor;

- njohja e formes dhe e ngjyres;
- leximi;
- zbatimi i sjelljes se kerkuar ose te zgjedhur.

Ne rastet kur nuk eshte e mundur te garantohet dukshmeria e kerkuar ne kapitujt respektive (sinjale treziku, urdheruese ose treguese), distancat mund te ndryshojne, me kusht qe sinjali te paraprihet nga nje sinjal i ngashem, i plotesuar me panel plotesues model II 1

Dukshmeria, e per pasoje pamja e sinjalit (forma, ngjyra dhe simbolet), duhet te jene te njejtë, si diten ashtu edhe naten Naten dukshmeria mund te sigurohet me ndriçim ose reflektim

Shenim: Ne te njejten mbajtese nuk mund te vendosen sinjale me karakteristika ndriçimi ose reflektimi te ndryshme midis tyre.

17.1.6 Publiciteti

Ndalohet nderthurja ose bashkevendosja me çdo lloj publiciteti

Gjithsesi enti pronar i rruges mund te lejoje publicitetin e sherbimeve kryesore, se bashku me sinjalet rrugore ne rastet e parashikuara nga rregullorja

17.1.7 Permasat e tabelave sinjalizuese

Permasat e sakta te tabelave jepen ne Rregulloren e Kodir Rrugor te Shqiperise .

Kontraktori duhet te zbatoje permasat e pershkruara hollesisht ne projekt.

Pergjithesisht lejohen tre lloje te ndryshme permasash per çdo shenje.

Kjo mund te permblidhet si me poshte:

Forma e tabelës	Gjeresia e tabelleve (cm)		
	E vogël	E mesëm	E madhë
Octagonale	60	90	120
Trekëndore	60	90	120
Rrethore	40	60	90

Tabelat e mesme perdoren zakonisht kur tabelat e anes se majte perseritin ato qe jane vendosur ne anen e djathte.

17.1.8 Shikueshmeria e qarte e tabelave

Tabelat duhet te jene qartesisht te dukshme ne perputhje me nivelin e kerkuar te dukshmerise.

Distanca duhet te jete e qarte per te gjitha pjeset e fasades se shenjes, kur shikohet nga qendra e korsise ne anen e afert. Per tabelat e montuara jashte rruges, distanca e dukshmerise duhet te matet nga qendra e korsise me te afert ne drejtimin e shikimit.

Pemeve qe erresojne tabelat duhet tu priten majat dhe bimet e tjera qe mund te erresojne shenjen duhet te hiqen me rrenje.

Prerja e majave te bimeve ne prona private duhet te behet pas keshillimit me pronarin e tokes ku ndodhet bimesia.

17.2 Sinjalet e rrezikut

17.2.1 Te pergjithshme

Sinjalet e rrezikut duhet te vendosen kur egziston nje situate reale rreziku ne rruge, qe nuk perceptohet shpejt nga nje drejtues mjeti ne kushte normale dhe qe zbaton rregullat e qarkullimit

Keto sinjale kane forme trekendeshi barabrinjes me kulm te drejtuar lart

17.2.2 Vendosja

Sinjalet e rrezikut duhet te vendosen ne anen e djathte te rruges. Ne rruget me dy ose me shume korsi per çdo sens levizje, duhet te merren masa, ne lidhje me kushtet vendore, me qellim qe sinjalet te dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve qe kalojne ne korsite e brendeshme. Kjo behet duke i perseritur ne anen e majte ose siper karrekhates

Ne kete rast, ne qoftese tregimi i rrezikut vlen per te gjithe karrehaten, sinjali vendoset me qender ne perputhje me aksin e saj. Neqoftese i referohet vetem nje korsie, duhet te vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe te plotesohet nga nje shigjete te vendosur nen te (modeli II 6/n), me majen e drejtuar poshte.

17.2.3 Kombinime

Ne rast vendosje ne te njejten mbajtese te nje sinjali rreziku dhe nje sinjali urdherues, sinjali i rrezikut duhet te jete gjithmone me lart atij urdherues.

17.3 Sinjalet pershkruese

17.3.1 Te pergjithshme

Sinjalet qe japin pershkrimet te vendosura nga autoritetet kompetente te rruges per perdoruesit e saj, ndahen ne tre lloje:

- sinjale perparesie;
- sinjale ndalimi;
- sinjale detyruese

Sinjalet pershkruese duhet te vendosen ne piken ku fillon detyrimi ose sa me afer tij

Te pajisur me panelin plotesues model II 1 mund te jepen me perpara me qellim paralajmerimi

Gjate pjeses se rruges te sinjalizuar me sinjal pershkrues sinjalet duhet te perdoren pas çdo kryqezimi Perseritja mund te behet duke perdonur sinjale me format te reduktuar, te plotesuar me panele plotesues model II 5/a2 ose II 5/b2. Termi pershkrues tregohet duke perdonur te njejtin sinjal te pajisur me panel model II 5/a3 ose II 5/b3 , me perjashtim te rasteve kur eshte parashikuar një sinjal i veçante i fundit te pershkrimit (detyrimit).

Sinjalet e FUNDIT (mbarimit) te detyrimit ose ndalimit, duhet te vendosen sa me afer te jete e mundur, ose pikerisht ne piken ku perfundon ndalimi ose detyrimi.

17.3.2 Vendosja

Sinjalet pershkruese vendosen ne anen e djathte te rruges.

Ne rruget me dy ose me shume korsi per çdo drejtim levizje, duhet te merren masa, ne lidhje me kushtet vendore, me qellim qe sinjalet te dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve qe kalojne ne korsite e brendeshme. Kjo behet duke i perseritur ne anen e majte ose siper karrekhates. Ne kete rast, ne qoftese urdheri vlen per te gjithe karrexfaten, sinjali vendoset ne qender ne perputhje me aksin e saj; Neqoftese i referohet vetem një korsie, duhet te vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe duhet te plotesohet nga një shigjete e vendosur poshte (modeli II 6/n), me majen te drejtuar poshte.

17.4 Sinjalet e ndalimit

17.4.1 Te pergjithshme

Sinjalet e ndalimit ju ndalojne pedoruesve te rruges qarkullimin ose drejtime tçanta te levizjes, një manover te veçante, ose vendosin kufizime.

Sinjalet e ndalimit ndahen ne te pergjithshem dhe te veçante:

- quhen te pergjithshem ato qe u drejtohen te gjitha mjeteve;
- quhen te veçante ato qe u drejtohen vetem një kategorie mjetesh ose kategorie te veçante perdonuesish .

Sinjalet e ndalimit kane forme rrethore.

Tek sinjalet e ndalimit perdoren kryesisht ngjyrat: e bardhe, blu, e kuqe, dhe e zeze perveç rasteve te parashikuara ndryshe.

17.5 Sinjalet e detyrimit

17.5.1 Te pergjithshme

Sinjalet e detyrimit vendosin per perdoruesit nje sjellje te vecante, ose nje kusht te vecante qarkullimi i cili duhet te respektohet. Ndahen ne te pergjithshme dhe te vecanta.

Sinjalet e detyrimit jane ne forme rrethore.

17.6 Sinjalet treguese

17.6.1 Te pergjithshme

U jalin perdoruesve te rruges informacionin e nevojshem per:

- te qarkulluar me rregullsi dhe te sigurte;
- te thjeshtuar dallimin e:
 - itinerareve;
 - qendrave administrative;
 - sherbimet dhe impiantet rrugore te nevojshme

17.6.2 Vendosja

Sinjalet e paralajmerimit dhe te drejimit mund te vendoset mbi karrehat, dhe ne vecanti mund te marrin karakteristikat e sinjaleve se korsise, kur ekzistojne nje ose me shume nga kushtet e meposhteme:

- dy ose me shume korsi per cdo sens te levizjes;
- kryqezime te kanalizuara ose planimetrisht komplekse;
- vellim i madh trafiku me perqindje te larte te makinave me lartesi gabarite te madhe;
- mbizoterm i shpejtjesise se larte;
- itinerare autostradale (Tipi A), unaza (Tipi A dhe B), drejtime kryesore te vendkalimeve ose itinerare te hyrjes ose daljes nga qendrat urbane;
- pamundesi e realizimit te nje sinjalizimi anesor efikas.

Per instalim te sinjaleve, vlejne normat e pergjithshme te dhena ne kapitullin Sinjalet Vertikale; mund te perdoren ura, mbikalime ose vendndodhje te tjera dhe pozicione te pershatshme.

Ne lidhje me piken e vendosjes qe i perket kryqezimit te cilit i referohet, sinjalet e korsise marrin funksionet e meposhtme:

- | | |
|------------------------------------|-----------------|
| ➤ shume me perpara | : paralajmeruse |
| ➤ me perpara | : perzgjedhje |
| ➤ prag kryqezimi | : drejtim |
| ➤ fillim i korsive te ngadalesimit | : drejtim |

- korsi te ktheses : drejtim
- te perpjeta, etj., : drejtim
- paskryqezime : konfirmim
- pas hyrjeve : konfirmim

Forma dhe permasat e sinjaleve te korsise jane përshtuar ne Skemen 20. Permbajtja e secilit panel duhet t'i referohet korsise perkatese, mbi te cilen ajo eshte pozicionuar.

17.6.3 Simbolet

Lidhen me llojin e rruges te ciles i referohet tregimi, sipas perkatesise se me poshteme, te vlefshme ne per gjithesi :

- sfond i bardhe : simbole te zeza;
- sfond i bardhe : simbole blu;
- sfond i bardhe : simbole gri;
- sfond jeshil : simbole te bardha;
- sfond blu : simbole te bardha;
- sfond kaf : simbole te bardha;
- sfond i zi : simbole te verdha;
- sfond portokalli : simbole te zeza;
- sfond kuq : simbole te bardha;
- sfond i verdhe : simbole te zeza.

17.7 Sinjalizimi horizontal

17.7.1 Te per gjithshme

Sinjalet horizontale, te shenuara ne rruge, sherbejne per te rregulluar qarkullimin, per te drejtuar per doruesit dhe per te dhene udhezime dhe tregues te dobishem per sjellje te vecanta per t'u mbajtur. Vijezi i rruge konsiston ne aplikimin e vijezimeve rrugore ne siperfaqen e asfaltuar dhe te pastruar paraprakisht nga papastertite dhe pluhurat, ne perputhje me vendndodhjen dhe dimensionet e paraqitura ne vizatim ose nen drejtimin e inxhinierit te ngarkuar.

- Materialet
 - a) Lenda e pare qe do te perdoret ne vijezimin e rrugeve duhet te jete posaçerisht per te, te kete sasine e nevojshme te reflektivitetit dhe qendrueshmeri te gjitha karakteristikat e mesiperme te jene ne perputhje me Standardin Evropian. Furnitura e bojes se vijezimit duhet te kete Certifikate aprosimi, ne te cilen te jene testet e laboratorike.
 - b) Bojerat reflektese te tipit me sfereza xhami te perzier paraprakisht me boje normale, jo reflektive duhet te kene permbajtje te bioksidit te titanit per bojen e bardhe dhe te verdhe.
 - c) Lengu perberes duhet te jete me baze rreshire sintetike.
 - d) Sferezat e xhamit ne permbajtje te bojes duhet te jene pa ngjyre dhe te kene nje diameter nga 0.006 mm e deri ne 0.30 mm kurse sasia perberese e peshes se tyre ne boje duhet te jete jo me pak se 33%.

- e) Kontraktori duhet te dorezoje nje sasi prej 1 kg boje nga e cila do te perdore se bashku me specifikimet teknike te fabrikes.
- f) Punedhenesi rezervon te drejten per te provuar nje kampion nga partia e bojes qe eshte ne perdom ne çdo moment.

17.7.2 Bojerat e vijezimit reflektare

Boja e vijezimit reflektare qe aplikohet me sprucim duhet te kete karakteristikat e meposhtme:

Karakteristika te per gjithshme - Boja reflektuese duhet te jete e tipit te paraperzier d.m.th. te permbane sferat e xhami te perziera qysh ne fabrikim, te jete homogjene. Sferezat e xhamit duhet te jene reflektuese ndaj fenereve te automjeteve

Ngjyra - Duhet te jete ngjyre e bardhe (ose e verdhe) puro. Ngjyra pas aplikimit duhet ti rezistoje kohes.

Pigmenti - Per bojen e bardhe pigmenti duhet te jete i formuar nga bioksidi i titanit. Kurse per bojen e verdhe pigmenti duhet te jete formuar nga kromati i plumbit.

Stabiliteti dhe pesha specifike - Boja e perdonur nuk duhet te absorboje graso, vajra, njolla te asnje tipi dhe te kete nje perberje kimike te pershtatshme qe edhe ne periudhen e

mepasme nuk duhet te kete shenja te depertimit te substancave bituminoze te shtresave asfaltike te rruges. Pesha specifike nuk duhet te jete me pak se 1.50 kg per liter ne 25°C.

Koha e tharjes - Koha e tharjes nuk duhet te jete me e vogel se 30 min ne kushtet e nje temperature 30°C, ne kushtet e nje lageshtire relative 65% per nje spesor 200 mikron. Vijezi gjate kohes se tharjes nuk duhet te shkelet nga automjetet.

Viskoziteti duhet te jete i perfshire ne kufijte nga 70 deri 90 krebs.

Perberesit avullues nuk duhet te jene me shume se 65% deri 75% te peshes.

Sferezat e xhamit - Duhet te jene transparente e per rreth 90% me forme sferike te rregullt dhe jo ovale si dhe nuk duhet te jene te ngjitura me njera tjetren. Treguesi reflektiv nuk duhet te jete me pak se 1.5 provuar me metoden e emetimit me llambe tungsteni. Nuk duhet te kete permbajtje te elementeve acide me ph 5 deri ne 5.3 dhe elemente normale te klorurit te kalciumit dhe te sodes.

Ashpersia e siperaqes - Koeficienti i ashpersise (sipas R. R. R Anglez) nuk duhet te jete me pak se 60% e siperaqes se pa vijezuar.

Drejtuesi i punimeve rezervon te drejten te beje ne menyre fakultative prova te lendes se pare ne institute te specializuara per qellim zbulimin e komponenteve perberes se saj, kualitetin rezistencen e materialeve etj. Shpenzimet e provave i ngarkohen firmes zbatuese te punimeve.

17.7.3 Karakteristikat fiziko-kimike

Masa volumetrike	kg/l	1,7
Elementet jo fluturues	75%	te peshes
Viskoziteti	89/90	KU
Permbajtja e pigmentit	35%	te peshes
Permbajtja e bioksidit te titanit	16%	te peshes
Koha e tharjes	minimumi	30min
Permbajtja e sferave	20%	te peshes
Norma e harxhimit	1,3 m ²	per kg
Reshqitshmeria	S. R. T.	44

Table 23- Karakteristikat fiziko-kimike

a) Procedura

- Pjesa e rruges ku do te behet vijezimi duhet te pastrohet nga papastertite. Menyra e pastrimit percaktohet ne bashkepunim me inxhinierin e ngarkuar.
- Gjeresia e vijezimit horizontal te behet 12-15 cm
- Te respektohet menyra e vijezimit sipas vizatimit kombinuar kjo edhe me tabelat paralajmeruese te rrezikut dhe te ndalimit te parakalimit. Per çdo rast te bashkepunohet me Inxhinierin e ngarkuar.
- Gjeresia e pjeses se vijezuar te jete:

Per ndarjen e korsive ku lejohet parakalimi Rruga 3 meter-Intervali 4.5 meter ne pjesen e nderprerjeve te rruges kryesore me hyrje anesore Rruga 1 meter-Intervali 1 meter.

b) Aplikimi

Aplikimi duhet te behet me nje makine vijezimi e cila aprovohet nga Inxhinieri. Makina duhet te jete e pajisur me dy sprucatore te cilet sprucojne boje te lengshme perzier me ajer te ngjeshur. Sprucatoret te jene te pajisur me nje mekanizem komandimi per leshimin dhe nderprerjen e sprucimit sipas kerkesave.

Boja perpara perdorimit duhet te perzihet mire dhe kushtet atmosferike te jene ne nje temperature mbi 5° C. Minimumi i normatives se bojes se perdorur per vijezim duhet te jete 0.5 liter per çdo meter kator te vijezuar. Trashesia e vijezimit duhet te jete rreth 0.5 mm (trashesi boje e thare).

17.7.4 Boje reflektuese Termoplastike me Sprucim

TH SP BR 30 eshte nje boje termoplastike, e formuluar me baze resin hidrokarboni alifatike e plastifikuar ne kombinim me pigmente, mbushes, aggregate dhe xham ne menyre qe te perftohet nje produkt homogen, me rezistence te shkelqyer ndaj abrazionit dhe me vlore retroreflektuesherie RL te larte (me pak se 100 mcd/m²). **Per te arritur nje vlore te larte fillestare RL (me shume se 100mcd/m²) eshte e nevojshme te sperkatet me pas produkti me mikrosfera xhami jo me pak se 300gr/m², ne nje sasi jo me te vogel se 1kg/m².** Produkti mund te ngrohet disa here pa alteruar karakteristikat e tija kimike dhe fizike. Ky kombinim i veçante i bashkuesit lejon qe produkti te perdoret ne nje game te gjere lartesish.

Të dhëna teknike

Tipi I Bashkuesit	Resinë
Mbetje E Ngurtë në 105°C	98±2%
Përmbajtja e hirit në 900(°C)	68±3%
Masa voluminoze	1.9±0.05 (g/cm ³)
Viskoziteti në 180 (°C)	1000±200 (cps)
Pika e zbutjes	102±5(°C)
Pika e ndezjes	>250 (°C)
Temperatura e aplikimit	180 - 200 (°C)
Mikrosfera xhami	30%

Instruksione:

Vendos produktim ne nje parangrohes dhe sille ne temperature ndermjet 190-200°C. Zhvendos produktin ne pajisjen e perdonur per ngrohje, duke mbajtur gjithmone temperaturen ndermjet 190°C -200°C. Ne rast paketimi te vogel eshte e detyrueshme te vendoset produkti siç eshte i paketuar ne boljeren parangrohese.

Rekomandohet te aplikohet produkti ne siperfaqe teresisht te thara, pa prani pluhuri ose grasoje dhe me temperaturu ajri jo me te vogla se 10°C.

Mbaje produktin te paketuar ne paketimin original, larg nxehtesise, diellit dhe ngrices

17.7.5 Ndarja e sinjaleve horizontale

Sinjalet horizontale ndahan ne :

- shirita gjatesore;
- shirita terthore;
- vendkalime kembesoresh ose biçikletash;
- shigjeta drejtuese;
- shkrime dhe simbole;
- shirita kufizuese te vendeve te qendrimit ose per vendqendrimet e rezervuara;
- ishuj trafiku ose sinjalizimi paraprak per pengesa brenda karexhates;
- shirita kufizuese te stacioneve te qendrimit te mjeteve te transportit publik te linjes;

- sinjale retroreflektuese integrative te sinjalizimit horizontal;
- sinjale te tjera te parashikuara nga aktet ne zbatim;
- sinjale horizontale te ndaluar.

Nuk lejohet:

- Ndalimi ne rruget, anet e te ciles dallohen nga nje shirit i vazhduar ;
- qarkullimi mbi shiritat gjatesore, perveçse kur nderrohet korsi;
- qarkullimi i mjeteve te paautorizuara ne korsite e rezervuara.
- Ne vendkalimet e kembesoreve drejtuesit e mjeteve duhet t'u japin perparezi kembesoreve qe kane filluar kalimin. Vendkalimet e kembesoreve duhet te jene gjithmone te kalueshme dhe per karrocat me rrota te invalideve .

17.7.6 Materialet

Te gjitha sinjalet horizontale duhet te realizohen me materiale te tilla qe te jene te dukshme si diten edhe naten , si kur bie shi edhe kur shtrati i rruges eshte i lagur.

Perdorimi i nje boje te cilesise se larte garanton jetegjatesine e sinjalit dhe siguron mjetin ne cdo moment te dites.Ne kete projekt duhet te perdoret boje bikomponente me gjeresi 15 cm.

Sinjalet horizontale duhet te jene te realizuara me materiale te pa thermueshme dhe nuk duhet te dalin me shume se 3 mm mbi siperaqen e shtruar te rruges.

17.7.7 Kalimet per kembesoret ose per biçikletat

Sinjalet horizontale te VENDKALIMEVE PER KEMBESORET jane dhene ne kapitullin Vendkalime kembesoresh ne “Situata te veçanta”, ndersa sinjalet horizontale te vendkalimeve te biçikletave jane dhene ne kapitullin Zona te biçikletave ne “Situata te veçanta”.

18 SPECIFIKIME TEKNIKE PER PUNIME GJELBERIMI

18.1 PRERJE SISTEMIM PEMESH

Ne keto zera pune eshte parashikuar te kryhen punimet e meposhtme:

Ne kete ze pune eshte parashikuar prerja e degeve anesore e kryesore, trupezimi i trungut, shkuljen e sistemit rrenjesor, grumbullimin dhe trasportin mbi 5 km nga objekti.

Matja do te jete ne cope.

18.2 F.V FIDANE DEKORATIV

Bazuar ne analizen An 164, Manuali 3 botuar ne fletoren zyrtare.

MBJELLJA E DRUREVE DEKORATIVE

Proceset e punes jane parashikuar ne zera dhe do te kryhen punimet e meposhteme:

-Piketim, hapje grope 1x1x1 m, blerje fidani, furnizim dhe vendosje fidani, mbushje me pleh organik dhe me dhe biologjik si dhe vendosja e drurit mbeshtetes ne lartesine $h=2$ m.

- Distanca e mbjelljes do te jete sipas parashikimeve te percaktuara ne projekt.

Karakteristikat e drurit dekorativ te llojeve:

Te dhenat teknike qe duhet te zbatohen ne perzgjedhjen e llojeve.

- Panje e kuqe (Acer).
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Kumbulla e kuqe (Prunus),
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.

- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Plep (Populus),
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.
- LLoji Ulli (Olea europaea),⁴⁷
- Lartesia e drurit 160-180 cm.
- Perimetri i trungut 14-16 cm.
- Amballazhi me kosha plastike.
- Certifikata e origjines dhe ajo fitosanitare.

Matja do te jete ne cope.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT**

RIKUALIFIKIMI URBAN I UNAZES SE RE BERAT

**METODOLOGJIA E NDERTIMIT DHE
ORGANIZIMI I PUNIMEVE**

FAZA : PROJEKT ZBATIMI

GUSHT 2020



PERMBAJTJA

1	ORGANIZIMI I PUNIMEVE.....	4
1.1	<i>Te per gjithshme</i>	4
1.2	<i>Punimet per gatitore per zbatimin e projektit.....</i>	5
1.3	<i>Organizimi i kantierit</i>	6
1.4	<i>Punimet ne rruge</i>	7
1.5	<i>Detyrimet e Kontraktorit gjate Punimeve ne rruge</i>	8
2	METODOLOGJIA E NDERTIMIT.....	9
2.1	<i>Te per gjithshme</i>	9
2.2	<i>Ndertimi i Rruseve.....</i>	9
2.3	<i>Siguria dhe Shendeteti ne pune</i>	12
2.4	<i>Te dhena per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik.</i>	13
2.5	<i>Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin.</i>	14
2.6	<i>Karrierat e zones</i>	15

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 – Plani i Pergjithshem (Horografia)	4
Figura 2 – Seksion Terthor Tip.....	4
Figure 3 - Grafiku i Punimeve	7

1 ORGANIZIMI I PUNIMEVE

1.1 Te per gjithshme

Qellimi i per gjithshem i ketij projekti eshte vazhdimi i unazes se Beratit. Do te ndertohet nje rruga e re nga kryqezimi me rrugen “Santa Lucia” deri te bashkimi rrugen “Antipatre” ne dalje te Uznoves. Lidhja e rruges se re (Unaza e re) me shetitoren “Osumi” do te filloje rrreth 150m nga kryqezimi me rrugen “Santa Lucia” dhe pjesa prej 150m deri te kthesa vetem do te rivishet (riasfaltohet) me nje shtrese asfaltike te re 4cm dhe do te pajiset me sinjalistike te re. Parametrat gjeometrike te rruges jane ne perputhje me PPV (Plani i Pergjithshem Vendor) dhe kerkesat e bashkise Berat. Rruga do te jete me nje karrekhate me dy sense levizjeje. Rruga do te jete rruge urbane me trotuar nga te dy anet dhe korsi bicikletash nga njera ane. Pjese e projektit do te jete dhe ndertimi i nje rruge lidhese me lagjen “Uznove” me gjatesi 600m, e cila do te kryezohet me unazen me anen e nje nyjeje ne nivel. Gjithashtu dhe ndertimi i dy rrugeve te aksesit (rruge bujqesore) per zonat midis rruges se re dhe lumbit Berat. Vepra kryesore do te jene ndertimi i nje ure me gjatesi 18m dhe nje nenkalimi me permasa $3.50 \times 6.00\text{m}$. Gjithashtu pjese e projektit do te jete dhe ndertimi i nje argjinature me gjatesi 750m ne fillim te rruges per arsyte te prishjes se argjinatureve ekzistuese mbi te cilen do te ndertohet gjurma e re e rruges.



Figura 1 – Plani i Pergjithshem (Horografsia)




Figura 2 – Seksion Terthor Tip

1.2 Punimet pergatitore per zbatimin e projektit

1.2.1 Te pergjithshme

Fazat e punimeve pergatitore jane si me poshte:

1. Keto punime fillojne me studimin e hollesishem te projektit si me percaktimin e sakte te vendeve per ngritjen e kantierit .
2. Percaktimi i vendeve te karierave te materialeve dhe marjen e lejeve perkatese.
3. Para fillimit te punimeve kontraktori ne bashkepunim me investitorin dhe autoritetet e pushtetit lokal, te pajiset me azhornimin e rrjeteve inxhinierike ekzistuese mbi dhe nentokesore, mbi baze e te cilave do te marrin lejet perkatese.
4. Para fillimi te punimeve Kontraktori duhet te pajiset me lejen mjedisore perkatese
5. Gjithashtu Kontraktori per punimet ne rruge ekzistuese duhet te beje nje plan te menaxhimit te trafikut te cilin duhet ta coje per miratim prane institucioneve perjegjese.

1.2.2 Njohja me Projektin

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te njihet hollesisht me projektin ne cdo detaj te tij. Paralelisht me njojen e projektit Kontraktori duhet te bej shume vizita ne terren per tu njojur me situaten ekzistuese te rruges dhe per ta krahasuar me ate te paraqitur ne projekt.

Kjo analize do ti mundesoje qe te verifikoj ndryshime e dukshme qe mund te jene bere me kalimin e kohes qe nga periudha e perqatjes se Projekt Zbatimit.

1.2.3 Perzgjedhja e vendit per ngritjen e kantierit.

Perzgjedhja e vendit te kantierit duhet te behet ne bashkepunime me Mbikqyresin e puimeve si dhe me autoritetet e pushtetit lokal. Vendi i perzgjedhur duhet te jete mundesisht larg banesave dhe te mos kete impakt negativ ne mjedisin e zones . Pozicioni i kantierit duhet te kete parasysh zonat urbane dhe te vendosen ne nje pike ku nuk nderhyn ne jeten dhe aktivitetin e perditshem normal te zonave. Gjithsesi pozicionimi i kantiereve duhet te jete efikas dhe i shpejte ne cdo pike te objektit.

Duke mare parasysh karakteristikat e meposhtme te rrugeve :

1. Unaza e Re me nje gjatesi totale rreth 4100m
2. Rruga Sekondare me nje gjatesi totale rreth 600m
3. Rruget Bujqesore me nje gjatesi totale rreth 1200m

Projektuesi kosideron te mjaftueshem ndertimi e vetem nje kantieri .

Ky kantier do te kete ne perberje sektoret ne funksion te punimeve, si me poshte:

- Sektori i ndertimit te trupit te rruges dhe shtresave
- Sektoret e ndertimit te veprave te artit sipas pozicionit te tyre
- Sektori i sherbimeve shtese

Si rruge e emertuar e “kantierit” qe do te sherbejne per levizjen dhe ngritjen e sektoreve eshte parashikuar te jete vete trupi i rrugeve ekzistuese, me perjashtim te rasteve ku nuk ka mundesi ose nuk eshte e nevojshme.

Pozicioni i vendit te ngritjes se kantierit te studiohet dhe dakortesohet me autoritetet lokale dhe mbikqyresin e punimeve.

1.2.4 Sigurimi i azhornimeve te rrjeteve ekzistuese dhe i lejeve nga institucionet perkatese

Para fillimit te punimeve kontraktori ne bashkepunim me investitorin dhe autoritetet e pushtetit lokal, te pajiset me azhornimin e rrjeteve inxhinierike ekzistuese mbi dhe nentokesore, mbi baze e te cilave do te marrin lejet perkatese.

Para fillimi te punimeve Kontraktori duhet te pajiset me lejen mjedisore perkatese.

1.3 Organizimi i kantierit

Ne kete plan organizimi projektimi ka marre parasysh disa kritere te rendesishme te cilat jane:

- Evidencimi i pikave ku rruget lidhen me rruget ekzistuese si dhe menaxhimi i trafikut ne keto nyje.
- Minimizimi ne maksimum i zhurmave dhe i ndotjes ne te gjitha zonat e banuar ne zonen e projektit.
- Te minimizoje nderhyrjet qe behen ne terren jashte atyre te parashikuara ne projekt.
- Ndarja e kantierit ne sektor, duke realizuar ato ne nje distance sipas pozicionit te veprave te medha.
- Kantieri duhet te kete rruge te pershatshme dhe nga mjete te ndihmes se shpejte per raste te emergjencave.

Pothuajse e gjithe gjurma e projektit kalon ne zone te banuar dhe rruge ekzistuese, çka e veshtireson pjesen e organizimit te punes dhe marrjen e masave per ndertimin e kantierit. Kantieri do te jete i vendosur ne nje zone sa me te sheshte dhe nje nje pozicion te tille qe te aksesohen sa me shpejte te gjitha rruget qe do te ndertohen.

Krahas kushteve teknike te zbatimit per ngritjen e kantierit, te cilat kontraktori duhet ti respektoje me rigorozitet, nuk eshte per tu anashkaluar dhe evidentimi dhe pozicionimi i pikave te furnizimit me materiale ndertimi, uje dhe energji elektrike.

Kantieri i ngritur duhet te jene i pajisur me:

- Rruge lidhese me rrugen ekzistuese
- Te kete energji elektrike 24ore/dite
- Te kete uje te pijshem 24ore/dite
- Te kete qendren e ndihmes se shpejte
- Te jete i rrrethuar, dhe te pajisur me tabelat informuese.

Ne perfundim te punimeve siperfaqja dhe zona perreth kantierit duhet te rikthehen ne gjendjen e meparsheme.

Brenda zone se rrrethimit duhet te jene te organizuar zyrat e kontraktorit, mbikqyresit te punimeve, parkimet, vendet e depozitimet te materialeve, fjetoret, mensa, ambientet e tjera ndihmese, gjeneratori, etj.

1.4 Punimet ne rrule

Punimet ne rrule fillojne me rilevimet topografike te zones se projektit dhe verifikimet me projektin e rruleve.

Per te proceduar me hapat e metejshem te ketyre punimeve Kontraktori mund te perzgjedhe te formoje disa grupe pune dhe te delegoj punimet ne dy apo disa fronte njekohesisht. Gjithsesi cdo lloj vendimarje duhet te behet ne bashkepunim me Mbikqyresin e Punimeve.

Projektuesi e keshillon Kontraktorin qe per te mundesuar nje mbarvajtje te mire te punimeve ne rrule te ndjekje grafikun e punimeve qe ai ka hartuar. Ky grafik eshte pjese e ketij projekti dhe paraqitet si me poshte:




Figure 3 - Grafiku i Punimeve

Ky grafik paraqet radheen e zhvillimit te punimeve ku nder me kryesoret jane:

- Punimet e germimit dhe hapjen e trasese. Gjate hapjes se trasës materiali i germuar duhet te largohet ne vendet e percaktuara ne bashkepunim me Mbikqyresin e Punimeve dhe autoritetet lokale.

- Punimet per ndertimin e veprave te artit, mure mbajtes, tombino, etj.
- Punimet e mbushjes
- Punime shtresash.
- Punime te mobilimit rrugor, ndricimi, sinjalistika, etj.

1.5 Detyrimet e Kontraktorit gjate Punimeve ne rruge

1.5.1 Te pergjithshme

Gjate zbatimit te punimeve kontraktori duhet te kete parasysh si me poshte:

- Duhet te punoje ne menyre te organizuar dhe te koordinuar (ne baze te planit te menaxhimit te trafikut) me institucionet perqejese per te mos penguar levizjen e automjeteve gjate nderhyrjes ne rruget ekzistuese.
- Asnje nga pjeset e rruges nuk do te hapet per t'u shfrytezuar, pa perfunduar me pare shtresen asfaltike.
- Gjate kryerjes se punimeve per ndertimin e rrugave kontraktori duhet te respekoje me rigorozitet kerkesat lidhur me sinjalistiken e sigurine rrugore provizore, per devijimin e rruges mbeshtetur ne :

"MANUALI SINJALIZIMIT RRUGOR", veçanerisht ato te Aneksit B

- Duhet te siguroj akses ne degezimet qe lidhen me rruget duke mos i blokuar totalisht ato
- Duhet te tregoj kujdes maksimal per te mos demtuar rrjetet ekzistuese nentoksore te cilat nuk preken ne rruget ekzistuese te cilat vetem riasfaltohen dhe ne te cilat nuk eshte parashikuar te nderhyet.
- Duhet bere kujdes dhe duhen marre te gjitha masat per te siguruar qe rruget te cilat perdoren qofte per punime ose per transportin e makinerive, punetoreve dhe materialeve, te mos ndoten si rezultat i ndertimeve te tilla ose transportit dhe ne fillimet e ndotjes duhen bere te gjitha hapat e nevojshme per ti pastruar ato.
- Kontraktori duhet te kryeje vete mirembajtjen dhe mbrojtjen e objektit gjate ndertimit por edhe mirembajtjen rutine derisa te merret ne dorezim ne perputhje me kushtet e kontrates.
- Nese Kontraktori do te punoje naten, ai duhet te paraqese hollesi te plota te metodave te punes dhe ndriçimit dhe ndonje informacion tjeter te nevojshem.
- Gjate gjithe fazes se zbatimit te punimeve kontrolli topografik duhet te jetë shume rigoroz per te bere lidhjen e sakte te rrugave te reja me ato ekzistuese.

2 METODOLOGJIA E NDERTIMIT

2.1 Te pergjithshme

Metodologjia e paraqitur me poshtë, jep ne menyre orientuese metodologjine e ndertimit. Eshte pergjegjesi e Kontraktorit qe perpara fillimit te punimeve te perqatise dhe te paraqese per miratim tek Mbikqyresi i Punimeve - Metodologjine e detajuar si dhe Plan-Organizimin per kryerjen e punimeve te ndertimit te objektit te mesiperm.

2.2 Ndertimi i Rrugeve

2.2.1 Pastrimi i vendit te punimeve

Perpara fillimit te punimeve Kontraktori duhet te beje ne bashkepunim dhe me aprovin e Mbikqyresit te Punimeve pastrimin e rrugeve nga objektet fizike te cmontueshme dhe te panevojshme, bimesia e ulet, etj. Kontraktori ne prezencen e Mbikqyresit te punimeve dhe perfaquesuesve te institucioneve pergjegjese duhe te beje prishjen e objekteve te parashikuar ne projekt zbatimin e miratuar. Prishja e objekteve duhet te jete e kontrolluar dhe e organizuar ne menyre te tille qe te mos shkaktoje demtime te objekteve te tjere ne afersi, ndotje akustike, ndotje te ajrit, etj. Gjate fazes se pastrimeve Kontraktori duhet te shoh mundesine e largimit te pemeve te larta qe preken nga gjurma e rruges pa i demtuar ato dhe ne bashkepunime me autoritetet lokale te shihet mundesia e rimbjelljes se tyre.

2.2.2 Piketimi i aksit te rruges

Piketimi i aksit dhe elementeve te tjere te trupit te rruges do te kryhet me shume kujdes duke ju permbytur raportit te hartuar dhe te dhenave te vendosura ne vizatimet perkatese.

2.2.3 Punimet e germimit

Punimet e germimit do te fillojne pasi te jete bere piketimi ne perputhje me planet e germimeve si dhe azhornimi perkatese. Gjithashtu perpara fillimit te germimeve duhet te verifikohen ne vend rrjetet inxhinierike ekzistuese dhe spostimi i tyre nese eshte e nevojshme.

Germimet do te kryhen sipas vizatimeve te miratuara duke respektuar permasat ne plan dhe kuotat.

Kontraktori duhet te kete kujdes te vecante gjate punimeve te germimit qe te mos cenoj stabilitetin e mureve rethues apo mbajtes te cilet nuk preken nga gjurma e rrugeve. Perpara fillimit te punimeve keshillohet qe zona te vecanta te monitorohen dhe qe punimet e germimit te kryen me sektione me te shkurtra se zakonisht.

Argjinatura ekzistuese mbi te cilet eshte ndertuar rruga ekzistuese sot do te germonhet duke e ulur kuoten e rruges se re me poshte nga rruga ekzistuese per te patur një akses te mire te hyrje-daljeve nga banesat. Rreth 1000m e pare te rruges se re ndodhen mbi argjinaturen ekzistuese.

Ne rrugen Sekondare dhe rruget buqesore do te kemi germim per realizimin e paketes se plotë te shtresave.

Per germimin do te perdoren makineri te pershtatshme (ekskavatore, buldozere, kamione). Makinerite do te perdoren vetem nga personel i specializuar dhe i pajisur me lejet perkatese te drejtimit.

Materiali i dale nga germimet i cili nuk do te perdoret si material per mbushje do te depozitohet ne vendet e miratuara nga Autoritetet perkatese, ndersa materiali i cili do te konsiderohet i pershtatshem per te bere mbushje (jo ne trupin e rruge) do te depozitohet ne vendin e caktuar ne kantier per tu riperdorur sipas udhezimeve te projektit.

Ne perfundim te procesit te germimit do te behet kontrolli topografik per te verifikuar perputhshmerine me projektin.

Ne rast se thellesia e germimit shkon me poshte se ajo e projektit atehere lartesia e tejkaluar do te mbushet me material te pershtatshem dhe do te ngjishet ne perputhje me specifikimet teknike.

2.2.4 Punimet e Mbushjeve

Punimet e mbushjeve do te fillojne pasi te jete kontrolluar dhe miratuar germimi. Mbushjet do te behen me material ne perputhje me specifikimet teknike i cili do te zgjidhet nga germimi ose do te importohet nga burime te miratuara.

Gjate mbushjeve tabani do te mbahet i drenazhuar. Materiali mbushes do te nivelohet dhe ngjishet me shtresa sipas specifikimeve teknike. Per ngjeshjen do te perdoren rrula ose pajisje/makineri te tjera te pershtatshme dhe te miratuara me pare te cilat sigurojne ngjeshjen e nevojshme sipas projektit dhe specifikimeve teknike

2.2.5 Punimet e shtresave

Perpara fillimit te punimeve te shtresave rrugore duhet te:

- Sigurohet qe germimi i profilit terhor te rruges eshte ne perputhje me projektin,
- Te ngjishet tabani natyror i trupit te rruges,
- Jene perfunduar punimet e strukturave te ndryshme (si puseta, mure,tombino, etj.) qe jane nen siperfaqen e rruges .

Shtresat e rruges nga tabani deri tek shtresat e asfaltobetonit perbehen nga nenshtresa dhe shtresa baze. Materialet e shtresave merren nga lumenjte, guroret ose burime te tjera te miratuara. Trashesia dhe ngjeshja e shtresave duhet te jete ne perputhje me projektin dhe specifikimet teknike. Perhapja dhe ngjeshja e shtresave duhet te realizohet me makineri te pershtatshme dhe te miratuara me pare. Asnjë kurri nuk duhet te formohet kur shtresa te jete mbaruar perfundimisht. Shtresa e ngjeshur perfundimisht nuk duhet te kete siperfaqe jo te njetrajtshme, ndarje midis aggregateve te imta dhe te trasha, rrudha ose defekte te tjera.

Ne perfundim te çdo shtrese duhet te behet kontrolli topografik dhe provat e ngjeshjes.

Shtresa asfaltobetoni (Binder, Asfaltobeton)

Perpara se te fillojne shtresat e asfaltobetonit duhet te sigurohet qe:

- Permasat ne plan dhe kuote e trupit te rruges te jene brenda tolerancave te dhena ne projekt dhe specifikimet teknike,
- ngjeshja e shtresave eshte ne perputhje me specifikimet,
- cilesia e asfaltobetonit eshte ne perputhje me projektin dhe specifikimet.

Lloji, trashesia dhe kerkesat teknike te asfaltobetonit do te jene ne perputhje me projektin e zbatimit. Perhapja e shtresave asfaltike do te behet me mjetet specifike dhe puniti sipas specifikimeve teknike.

Perhapja e shtresave te asfaltobetonit do te kryhet me makineri asfaltoshtruese te pershatshme te cilat sigurojne shperndarje te njetrajtshme.

Makinerite qe perdoren per ngjeshjen e shtresave te asfaltobetonit mund te jene rula te zakonshem me pesha te ndryshme nga 5 deri 12 Ton ose rulo me vibrim. Kur perdoren per ngjeshje rula te zakonshem, numri i kalimeve luhatet ne kufij 12 deri 17, ndersa kur perdoren rulo vibrues, numri i kalimeve ulet ne masen deri 50%.

Ngjeshja e asfaltobetonit quhet e perfunduar atehere kur mbi siperfaqen e perfunduar cilindri gjate kalimit te tij nuk le me gjurme. Nuk lejohet qe ruli te qendroje mbi shtresen e asfaltobetonit te pangjeshur plotesisht ose te beje manovrime te ndryshme mbi te.

Nderprerjet te cilat krijohen gjate shtrimit te asfaltobetonit ne kohe te ndryshme duhet te trajtohen me kujdes te veçante, per te menjanuar boshllaqet qe mund te krijohen ne to. Nderprerjet midis shtresave te asfaltobetonit me nenshtresat duhet qe ne çdo rast te jene te larguara nga njera-tjetra sipas specifikimeve teknike. Nderprerjet e shtreses te asfaltobetonit ne plan ne drejtim terthor me aksin e rruges duhet te behet me nje kend 70° . Nderprerjet gjatesore e terthore me aksin e rruges duhet te behen te pjerreta me 45° . Para fillimit te shtreses pasardhese, shtresa e meparshme duhet te pritet me sharre duke e bere fugen te pjerret me kend 45° . Pjesa mbas nderprerjes duhet te hiqet.

Ne perfundim te shtresave te asfaltobetonit duhet te behet kontrolli per kuotat dhe cilesine e shtresave. Siperfaqja e shtreses duhet te jete brenda tolerancave te dhena ne projekt dhe specifikimet teknike. Kontrolli qe percakton cilesite kryesore asfaltobetonit te vendosur e ngjeshur ne veper percaktohen me prova laboratorike.

Per çdo segment rruge te shtruar me asfaltobeton duhet te mbahet akt – teknik, ku te pasqyrohen te gjitha te dhenat e kontrollit me pamje, matje e laboratori, ku te pasqyrohet qe treguesit cilesore jane brenda kufive te kerkuar nga projektuesi ose kushtet teknike.

2.2.1 Punimet per ndertimin e ures dhe nenkalimit

Ndertimi i ures dhe nenkalimit do te filloje me punimet e germimit per te arrritur ne kuotat e percaktuara ne projekt. Ndertimi I pilotave qe do te shperbejne si themele (themele te thella) per shpatullat e ures do te behet me metodat standarte te ndertimit te pilotave te derdhura b/a. Punimet e betonit per ndertimin e shpatullave dhe themeleve e mureve ne rastin e nenkalimit do te behen ne perputhje me specifikimet dhe vizatimet e projektit dhe do te piketohen ne vend nen mbikqyrjen e nje inxhinieri topograf. Traret e ures do te jene trare b/a te paranderur dhe do te realizohen ne poligone te specializuar per ndertimin e trareve b/a te paranderur dhe me pas do te vendosen ne veper me anen e vincave. Soletat e ures dhe e nenkalimit do te jene soleta monolite b/a te cilat do te ndertohen ne vend duke respektuar kushtet teknike te ndertimit si per gjithe elementet e tjere. Duhet patjeter te realizohet hidroizolimi I soletave te ures dhe nenkalimit per te mos lejuar degradimin e betonit dhe korodimin e armatures. Piketimi dhe ndertimi i ketyre dy strukturave duhet te behet nen mbikqyrjen e nje inxhinieri topograf per percaktimin e sakte ne plan te vendosjes se tyre.

2.2.2 Nertimi i mureve mbajtes b/a, gravitar, me dhe te armuar, argjinature dhe mbrojtjes lumore me riprap

Perpara fillimit te punimeve kontraktori duhet te pervesoje ne menyre te hollesishme te gjitha vizatimet, raportet dhe detajet e dhena per muret mbajtes.

Muret mbajtes duhet te realizohen me permasa fikse sipas vizatimeve perkates dhe te sigurohet mbeshtetja e plote e themelit te tyre ne terren te qendrueshem te dale nga germimi qe do te kryhet. Germimet mund te realizohen me skarpata 1:3 dhe fillimi i punimeve duhet te behet menjehere duke mos e lene vendin e germimit shume kohe te zbuluar.

Ne menyre qe realizimi i mureve te garantoje jetegjatesine projektuese dhe kerkesat teknike Kontraktori duhet qe te ndjekti te gjitha udhezimet e dhena ne Raportin e Pergjithshem ne sektorin e Mureve Mbajtes si dhe per materialet tju referohet ne cdo hap Specifikimeve Teknike.

Mbushja pas mureve duhet te behet me cakell $\phi=35^\circ$.

Mbrojtja lumore me gjatesi L=150m do te ndertoohen me dopio shtrese me gure me trashesi 50cm. Guret duhet te kene diameter 20-30cm. Shtresa filtruese poshte shtreses se gureve do te ndertoher me zhavorr dhe do te kete nje trashesi 20cm.

2.2.3 Sistemi i drenazhimit te ujrave atmosferike

Drenazhmi i ujrave atmosferike perfshin sistemin e kanaleve, kunetave, pusetave dhe tombinove.

Punimet e ketyre sistemeve do te fillojne me piketimin e tyre sipas projektit. Me pas do te ndertoohen strukturat e tyre si puseta, tombino, kuneta, etj. Ne rast se keto struktura ndodhen nen trupin e rruges (tombino) atehere per keto do te kryhen germime per ti vodosur ne kuotat e kerkuara ne projekt duke u siguruar lidhja e mire e tubave me njeri-tjetrin ne nje taban te rrafshet te kuotuar sakte. Behet mbushja mbi dhe anash tombinos sipas vizatimeve perkatese dhe nje cdo rast duhet te sigurohet qe tombino te jete me shume se 30cm larg shtresave asfaltike. Kanalet e rinj do te lidhen me ate ekzistuese.

2.3 Siguria dhe Shendetin ne pune

2.3.1 Siguria ne pune

Gjate zbatimit te punimeve duhet te respektohen me rigorozitet te gjitha kerkesat per Sigurine dhe Shendetin ne Pune ne perputhje me legjisacionin ne fuqi, kushtet teknike si dhe praktikat me te mira.

I gjithe personeli duhet te jete i trajnuar ne lidhje me sigurine dhe shendetin ne pune perpara se te hyje ne kantier. Drejtuesit e makinerive te ndertimit duhet te jene pajisur me certifikatat dhe lejet perkatese te drejtimit. Duhet te behet rrethimi dhe mbrojtja e kantierit ku do te kryhen punimet.

2.3.2 Sherbimet

Nese jane dhene standarde te vecanta sipas te cilave duhet te zbatohen materialet e percaktuara dhe Kontraktori deshiron te perdore materiale sipas standardeve te tjera, keto standarde duhet te jene me cilesi te njejtë ose me te larte se standardi i permendor. Materiale te tilla do te pranohen vetem pasi te jete bere nje marreveshje me pare me punedhenesin.

2.3.3 Kujdesi per punimet

Kujdesi per punimet konsiston ne:

- a) Mbushja dhe germimi i skarpateve duhet te riparohet menjehere nese demtohen nga prania e ujit ne siperfaqe. Ne ato zona ne mbushje ku ndodh erozion, pjerresite duhet te rregullohen duke hequr dheun dhe duke e ngjeshur perseri mekanikisht deri ne densitetet e caktuara te kontrolluara, me ane te pajisjeve te duhura.
- b) Germimet per kanalet e kullimit , kanalet e ujerave te zeza, tubacionet kryesore te ujit, pusetat, kanalet funksionale dhe struktura te ngjashme duhet te mbrohen mire kundrejt kthimit te mundshem te ujit gjate reshjeve.
- c) Duhet te ushtrohet kujdes per te mos lejuar materialin ne gurore te laget ne shkalle te madhe per te ruajtur te gjitha shtresat e perfunduara ne gjendjen e duhur, per te mos shkaktuar grumbuj materialesh mbi to, te cilat pengojne drenazhimin siperfaqesor ose formojne vende me lageshi nen dhe mbi grumbujt e materialeve dhe per t'i mbrojtur nga erozioni vershimet e ujerave dhe shirave.
Materiali nuk duhet te perhapet mbi shtresen qe eshte shume e lagur per shkak se kjo mund te sjell demtimin e saj ose te shtresave te tjera pasuese gjate ngjeshjes ose kalimit te trafikut.
Kur materiali shperndahet ne rruge, gjate periudhes me lageshti, duhet qe te jepet nje pjerresi e konsiderueshme dhe nje ngjeshje e lehte e siperfaqes me rul çeliku me qellim qe te lehtesoje largimin e ujit ne kohe me shi.
- d) E gjithe puna per perfundimin e shtreses duhet te ruhet dhe mirembahet deri sa te vendoset shtresa tjeter. Mirembajtja duhet te perfshije riparimet imediate te demeve ose defekteve qe mund te ndodhin dhe duhet te perseriten sa here eshte e nevojshme per ta mbajtur shtresen ne gjendje te mire.
- e) Para se te perqatitet shtresa perfundimtare ose para se te ndertohet shtresa pasuese, duhet te riparohet ndonje demtim ne shtresen ekzistuese, ne menyre qe pas riparimit ose ndertimit ajo te plotesoje te gjitha kerkesat e specifikuara per ate shtrese. E gjithe puna riparuese perveç riparimeve te demtimeve te vogla siperfaqesor duhet te kontrollohet para se te mbulohet shtresa.
Shtresa e ndertuar me pare duhet te jete komplet e pastruar nga te gjitha materialet e padobishme para se te ndertohet shtresa pasuese ose te vendoset mbulesa kryesore.

Ne veçanti ne rastin e punimeve me bitum shtresa ekzistuese duhet te fshihet plotesisht me qellim qe te largohet çdo lloj papastertie, argjile, balte ose mbeturina te tjera materialesh. Kur eshte e nevojshme siperfaqja duhet te sperkatet me uje para, gjate dhe pas fshirjes me qellim qe te largohet çdo material i huaj.

2.4 Te dhena per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik.

Te dhena per infrastrukturen e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja duhet te jene pjese e planit te mirefunksionimit te punimeve.

Projekti zhvillohet ne nje zone lethesisht te aksesueshme per te gjithe infrastrukturen e nevojshme per realizimin e tij.E gjithe gjurma e projektit do te duhet te rethohet ,

Energjia elektrike do te sigurohen nga kabina elektrike ne afersi te objektit. Per kete nuk ka nevoje per asnjë lloj investimi si vendosja e shtyllave te perkohshme apo shtrirje kabelli ne distanca.

Uji qe do te perdoret gjate punimve te ndertimit do te sigurohet nga ndermarrje e ujeselles kanalizimeve Berat.

Per punonjesit qe do operojne ne projekt do vendosen tualete portative, pastrimi dhe shkarkimi i te cileve do behet me ane te nenkontraktoreve te licensuar per pastrimin e minitualeteve dhe shkarkimin e ujrate te zesa ne impiante trajtimi.

2.5 Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin.

Per realizimin e proceseve teknologjike te lart-permendura do te linde e nevojshme perdonimi i lendeve para; kryesish material ndertimi. Lendet e para qe do nevojiten do te jene: rere e lare, cakell,zhavorr ,cimento,asfalto beton, struktura monolite betoni, hekur betoni i zakonshem ,energji elektrike, uje, stabilizant ,gjeotekstil etj.

Materialet dhe lendet e para te cilat do te blihen do te jene te cilesise me te larte dhe do te merren nga prodhues apo tregtare te licensuar, shumica e te cileve ndodhen ne nje distance prej pak kilometrash nga sheshi i objekti

Materialet e ndertimit do te sigurohen :

- Aluvionet e tarracave te lumenjve ne afersi
- Shfrytezim i mundesive te perdonimit te materialeve te gjeneruara (dhera).
- Shfrytezimi i inerteve nga vendburimet te perkatuara (karrierat e lumenjeve ,gurore)nga kompanite e licensuara dhe prane zones se projektit
- Seleksionimi dhe fraksionimi i dherave qe do gjenerohen nga punimet e germimit per ndertimin e projektit.Keto dhera do ruhen perkohesisht brenda sheshit te kantierit dhe do te riperdoren si dhe material mbushes.

Ne lidhje me vetite e materialeve te ndertimit, nga studimet dhe nga literatura e perdonur per kete qellim jane vleresuar disa vendburime qe jane te perfaqesuar nga materiale ndertimi te tipit zhavore dhe materiale ndertimi te tipit gelqeror.

- Vetite e materialeve te ndertimit te perdonur per objekte inxhinierike te trasese.
- Vetite e materialeve te ndertimit te perdonur per objekte inxhinierike te shtresave te rruges, asfaltit dhe betoneve.
- Nga studimet qe ne kemi kryer dhe nga literatura e perdonur per kete qellim jane vleresuar:
- Lokalizimi i vendburime te materialevet te ndertimit qe jane me te aferta ne lidhje me gjurmen e projektit
- Vleresimi i vendburime egzistuese te materialeve te ndertimit qe jane me te aferta ne lidhje me gjurmen e projektit .
- Mbrojtja e gjeomjedisit si resultat i shfrytezimit te vendburimeve te materialeve te ndertimit.
- Materialet e ndertimit duhet te kenaqin kushtet teknike si material ndertimi per ndertim rrugesh te ketij niveli

2.6 Karrierat e zones

Per ndertimin e ketij objekti duhet te perdoren materiale te cilat jane nga karrierat qe ndodhen ne afersi te zone se projektit.

Per proceset e ndertimi te rruges apo veprave te ndryshme qe jane parashikuar ne rrugen e re te projektuar, mund te perdoren dhe materialet inerte te marra ne zonat me te aferta, kjo duhet te behet ne bashkepunim me Mbikqyresin e Punimeve. Gjithashtu kontraktori ne rast se do te marre inerte nga lumi, duhet te marre me pare lejet perkatese, ku do te percaktohen qarte per vandin ku duhet te merret materiali.

Karrierat ne zone ku nderhyhet me projektin sipas te dhenave duke marre parasysh dhe projektet e realizuara ne zone nder vite, kane materiale te pershtatshme per objektin e projektuar.